

Ismail
KADARE

DENIS FERNANDEZ - RÉCATA LA

**Kohë
barbare**

NGA SHQIPERIA NE KOSOVE

EIBLIOT

8SH -
KAF

Biseda

Onufri

8 SH.
K 14


ISMAIL KADARE

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA

KOHË BARBARE

Nga Shqipëria
në Kosovë

Biseda



Onufri

PARATHENIE

Bisedat e mëposhtme kanë si temë kryesisht luftën. Janë regjistruar gjatë një periudhe prej tre vjetësh.

Çdo takim me Ismail Kadarenë fillonte dhe mbaronte me arsyetime politike që, siç do ta vini re, shfaqen herë pas here në bisedat tona.

Objektivi ynë ishte të shpalosnim ekzistencën e përfolur të një shkrimtari që vjen nga një tjetër botë, nga një botë që tanimë i përket së kaluarës e nga e cila kanë mbetur vetëm disa drithma të një bishe në agoni të zgjatur artificialisht.

Me fjalë të tjera, qëllimi ynë ishte të ndërtonim së brendshmi mozaikun e një totalitarizmi komunist. Për disa arsye të miat kam qenë, si të thuash, një kushëri i largët me totalitarizmin, por pa e praktikuar apo pësuar prej tij. Dhe në njëfarë mënyre kjo karakteristikë e lehtësoi takimin tonë.

Gjuha e përdorur nga Ismail Kadare nuk ishte e huaj për mua.

Dëshmitë e Ismail Kadaresë janë tepër të rëndësishme: ato përshkojnë një zonë të panjohur, një despotizëm ballkanas, saktësojnë detajet e një diktature dhe hedhin dritë mbi mizorinë e një tiranie, parë me syrin e një njeriu që e ka vuajtur këtë tirani.

Fillimisht u befasova nga distanca, përpikëria dhe hollësitë e tepërta me të cilat Ismail Kadare fliste duke e dënuar këtë tirani edhe pse, herëherës, e rrëmbente zemërimi — që më pas ia linte vendin hidhërimit shkaktuar nga shpresa e tradhëtuar e një populli të çliruar menjëherë pas rënies së regjimit të Enver Hoxhës (regjim që vazhdoi edhe pas vdekjes së këtij të fundit).

Në Çekosllovakia, Vaclav Havel kishte dhënë mendime të njëjta, të cilat u bënë publike nga Anton Liehm (në mos gaboj) në Parlamentin e Strasbourg-ut me rastin e një simpoziumi ndërkombëtar ku merrnin pjesë filozofë, sociologë e shkrimtarë.

Nuk e di pse nganjëherë i kemi shkurtuar këto thënie apo i kemi lëvdur kronikat tona për luftën, ndërkohë që e ndiqnim ecurinë e saj me një zell gjithnjë e më këmbëngulës. Kishim turp? Nuk donim të hiqnim dorë nga dekori që kishim ndërtuar primitivisht? Apo i bindeshim një logjike të dramaturgjisë, logjikë që merrte formë pa

dijeninë tonë? Për momentin nuk jam në gjendje t'u përgjigjem pyetjeve të tilla. Nuk e kam transkriptuar tërësinë e bisedave tona. Lufta ishte e pranishme në shumicën e këtyre bisedave dhe ne nuk e anashkaluam atë, madje ajo ishte dhe fillimi i bisedave më pak të rëndësishme.

Duke e hedhur vështrimin pas, shoh se kjo luftë na u imponua pak nga pak "në libër". Aktualiteti i saj e devijoi projektin tonë dhe, përfundimisht, pamë se i kishim lënë vendin që meritonte derisa më datë 5 maj 1999 regjistruam një bisedë të gjatë, në pamje të parë pa lidhje, nën një atmosferë të rënduar. Por pikërisht nën këtë këndvështrim "vrasës" duhet lexuar dhe ky libër. Sikurse dhe ne, për asnjë moment, nuk hoqëm dorë nga qëllimi i këtij këndvështrimi.

Duhet të nënvizoj këtu se shumë qëndrime të Ismail Kadaresë gjatë bisedave tona mbështeteshin në fakte. Si rrjedhim, fjala e tij ka shumë vlerë. Ajo del kundër verbërisë ku janë zhytur shumë vëzhgues, zyrtarë e jozyrtarë. Sigurisht, nuk të vjen keq që kjo luftë ngjalli heshtjen e elitës (në kundërshtim me intelektualët dhe artistët), por që ajo tregoi caqet e diplomacisë e cila, për të arritur një marrëveshje për rastin e Bosnjës, harroi të përfshinte në këtë marrëveshje dhe disa nene që do të vlenin për zgjidhjen e problemit të Kosovës. Dhe nëse pati një fundosje, kjo ndodhi për shkak të një frenimi të politikës. Edhe tani, në

këto momente, duket se ka pak njerëz që janë gati të vdesin për Kosovën. Sipas zonjës Roland para togës së ekzekutimit, në emër të Lirisë kryhen shumë krime, por po kryhen dhe shumë të tjerë në emër të moderimit (mosndërhyrjet që stolisin historinë evropiane), që më së shumti provokohen nga paaftësia, nga një paaftësi e maskuar nga tigri prej letre i të ashtuquajturit kujdes.

Në fillim, pra, ishte Kroacia, më pas Bosnja dhe krimet e saj të shumta, lëshimet e saj ndaj një barbarie që kujtonim se kishte marrë fund njëherë e përgjithmonë në kontinentin që kishte parë luftën e Spanjës, Shoah-un (genocidin mbi hebretë) dhe krimet masive staliniane...

Ashtu siç e dëshmojnë dhe këto faqe, Shqipëria rizgjohet në kaos dhe po ushtrohet spastrim etnik në Kosovë ku Krimi — si një negativ i tablosë së Prud'hon-it — përndjek Drejtësinë dhe Pafajësinë.

Në të vërtetë, duke u nisur nga një fëmijëri shqiptare dhe nga përkufizimi i totalitarizmit në Shqipëri, ne nuk kemi bërë veçse, po ta shikosh më nga afër, përmbushjen (apo ofrimin) e programit tonë, duke vëzhguar lëkundjet dhe tronditjet që shkaktoi gjaku i derdhur diku në jugun e largët në kufijtë e Evropës.

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA,
9 MAJ 1999

BISEDA E PARE

(qershor 1996)

Takim në Saint-Claude, Paris, pranë statujës së Diderot.

Atmosferë e zhurmshme. Jemi ulur në një kthinë, zhytur në gjysmëhije, me nga një kafe përpara.

Ismail Kadare qëndron pak i tërhequr.

Pas përshëndetjeve të zakonshme dolëm tek thelbi i bisedës sonë: totalitarizmat.

Prova magnetofoni. Rregullim. Ismail Kadare zbavitet. Teknika na la në baltë. Aparati rebelohet. Ismail Kadare ironizon: "Gjithnjë kështu ndodh..." Më në fund ia dalim ta zbutim.

Fillon biseda e parë. Ismail Kadare flet me zë të matur.

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Para se të trajtojmë çështjet e përgjithshme të totalitarizmit, do të doja të rikujtoni pozicionin tuaj të veçantë si shkrimtar nën regjimin e Enver Hoxhës. Për shembull, a kishte tema të propozuara nga instancat drejtuese të Partisë, siç ka ndodhur në BRSS dhe në vendet e tjera të ashtuquajtura socialiste?*

ISMAIL KADARE: Kjo tregon ekzagjerimet ose më saktë ekzagjerimet e shkrimtarëve konformistë që duan të shfajësohen sot për nënshtrimin e tyre ndaj regjimit.

— *Domethënë?*

— Ata duan të tregojnë se nuk janë përgjegjës për veprat e tyre, por është regjimi ai që i ka detyruar të shkruajnë ato që kanë botuar. E, për çudi, kjo nuk është e vërtetë. Regjimi nuk i ka detyruar. Ata i janë nënshtruar një dëshire të udhëheqësve të Partisë dhe shtetit që, tek e fundit, nuk kërkonin dhe kaq shumë. Këta udhëheqës nuk kanë shprehur qartë ndonjë dëshirë të përcaktuar në këtë fushë.

— *Si i interpretoni shfajësimet e tyre të*

sotshme?

— Atyre u vjen turp që kanë vepruar kësisoj. Të turpëroresh është diçka e mirë, por pak si vonë, apo jo? Nga ana tjetër, nuk është mirë të biesh në falsifikim për të përligjur atë që ka ndodhur.

— *Doni të thoni që ky regjim i bindej disa parametrave të veçantë, që nuk i kishte marrë parasysh disa elementë që organizonin jetën letrare në shtetet e ngjashme?...*

— Nuk jam i sigurt nëse ka ekzistuar diçka e tillë në Bashkimin Sovjetik, të paktën në periudhën që njoh unë. Subjektet që iu imponoheshin shkrimtarëve...

— *Në mbarim të disa mbledhjeve të Komitetit Qendror, shkrimtarëve iu drejtohej dhe propozohej një listë me subjekte për t'u trajtuar.*

— Le të themi propozohej. Por kjo gjithsesi ngre probleme të ndryshme. Le ta zemë se një shkrimtar ka zgjedhur një subjekt, një temë: e ka zgjedhur lirisht apo duke u frymëzuar nga këto të ashtuquajtura direktiva të Partisë e shtetit? Marrim rastin e një shkrimtari mesatar si Paustovski, për shembull. Me gjasë nuk është një shkrimtar i madh. Duke qenë anëtar i lëvizjes disidente, ai shkroi gjëra “normale” nën regjimin sovjetik. Ai

nuk u nënshtrua, atëherë pse të tjerët u nënshtruan? Jam kundër këtij shfajësimi që më duket i ulët. Mendoj se është më mirë të heshtësh dhe të pranosh këto qëndrime lajkatare nga të cilat këta shkrimtarë kanë përfituar.

— *Mendoni se këta shkrimtarë ndihen sot fajtorë?*

— Po, do të bënin mirë sikur të shpjegonin idolatrinë dhe veprimet e tyre, me qëllim që të arrinin një nivel të kënaqshëm mirëkuptimi... Nga ana tjetër, nuk mendoj se poezitë që i kushtoheshin Partisë duhen marrë seriozisht. Më tepër bëhet fjalë për një rregull, diçka formale në një kontekst të caktuar, një lloj formule mirësjelljeje, besoj e kuptoni se ç' dua të them; një formulë qesharake, e pranoj, por jo dhe kaq tragjike... Kishte shkrimtarë gjithfarësh e si rrjedhim qëndrime të ndryshme. Kurrsesi nuk duhet menduar që totalitarizmi unifikonte krijimtarinë apo ia nënshtronte atë një filtri të vetëm. Disa shkrimtarë mbanin qëndrim të ndershëm dhe krijonin një vepër që do ta klasifikojë normale. Të tjerë, dhe ky është fakt, iu përulën kritereve estetike mbizotëruese...

— *Trajtonin subjekte që mbështetnin regjimin?*

— Jo të gjithë. Kjo ndodhte qoftë për bindje, qoftë për oportunizëm. Më shpesh të qortonin për librin që nuk kishe shkruar, nëse bëje pjesë në kategorinë e angazhuar të letërsisë së mirëfilltë. Kështu, pasi kishe botuar romane të karakterit historik apo thjesht fikSIONAL, të pyetej përse nuk ishe ballafaquar me realitetin, përse e kishe shpërfillur ndërtimin e socializmit, etj. Do të ishte e tepërt të besojë që gjithë shkrimtarët i përkisnin një tipi, që punonin në të njëjtin drejtim. Pa i vënë në lojë, them se pozicioni i tyre ishte mjaft i sforcuar...

— *Ju thoni se nuk mund të futen gjithë shkrimtarët në një thes. Atëherë si ushtrohej ky presion?*

— Do të përpiqem t'jua them: si kudo, megjithëse e vërteta është ndryshe. Shtypja ishte reale, konkrete. Në mungesë të nënshtrimit të letërsisë në tërësi, ishin shkrimtarët ata që nënshtroheshin vullnetarisht.

— *Një formulë e mirë...*

— Një formulë që i përgjigjet realitetit, dhe nuk mund të them se shkrimtarët, sidoqë në rrethana absurde, nuk ishin përgjegjës për shkrimet e tyre. T'i japim Qezarit atë që i takon

Qezarit dhe të bëjmë njëfarë ndarjeje, megjithëse të pabarabartë.

— *Që do të thotë?*

— Që duhen dalluar ata që ngulmonin në ruajtjen e Tempullit të letërsisë, pavarësisht nga pasojat, nga ata që e kanë tradhtuar këtë tempull. Shumë shkrimtarë ngulin këmbë se ishte regjimi ai që i detyronte të shkruanin ato çka kanë botuar. Ata kapen pas një alibie për të justifikuar poshtërsitë e tyre. Ekzistonte një presion, nuk mund të mohohet, por ky presion nuk ishte një shtrëngim apo detyrim i kulluar.

— *Më qartë...*

— Shpresoj të mos ju humbasë durimi. Ju doni të dini se si ushtroheshin presionet më të drejtpërdrejta? Po zgjedh një shembull mes shumë të tjerëve. E zëmë se një shkrimtar trajton subjekte “përjetësie” apo subjekte historike; një ditë një funksionar i afrohej duke luajtur rolin e të habiturit: “Zotëri” ose “Shok, përse refuzoni të shkruani për realitetin socialist? E bëni me qëllim apo është ndonjë keqkuptim?” Në këtë rast ai kalonte në kompromis.

— *Ku konsistonte ky kompromis?*


— Askush nuk donte të ishte i dyshuar. Mekanizmi ishte i shpejtë: agjent i Perëndimit, veprimtari kundërrevolucionare... Dhe ju pranoni të shkruanit për problemet e ditës. Një kompromis i pranueshëm, apo jo?

— *A mund të arrihej kjo?*

— Nëse ju përgjigjeshit: “Po shok, e kam tepruar, por nuk kam pasur si qëllim të injoroj jetën e përditshme...” Mund të shkruhen shumë gjëra për jetën e përditshme pa u fëlliqur. Nuk të kërkohej t’i thurje lavde luftës së klasave, të përshkruaje me ëndje njëmijë e një mënyrat e torturimit të armikut të proletariatit apo të ngrije në qiell spiunimin!

— *Disa shkrimtarë e kanë mbështetur regjimin...*

— Nuk e mohoj. Ata kanë përhapur sloganët e Partisë. Kanë bashkëpunuar në fushatat kundër liberalëve, Perëndimit dhe dekadencës kapitaliste. Madje kanë përgëzuar krimet e kryera nga shteti. I shndërruan në heronj policët dhe shefat e policisë sekrete. Spiunët i paraqitën në poza romaneske, pse jo dhe romantike. Me një fjalë, diçka jo dhe aq e këndshme. Ata u sollën pa diskutim si qen roje të regjimit. Por askush nuk i detyroi ta bënin



këtë.

— *Megjithatë, vendet socialiste vuanin nga kjo lloj prodhimitarë, apo jo?*

— Në fakt, gjysma e filmave të vendeve ish-socialiste i thurte lavde spiunëve dhe denoncuesve. E pastaj? Ministri i brendshëm financonte romanet? Sigurisht! Megjithatë nuk vihej ndonjë revolver në tëmthin e atyre që iu bindeshin kërkesave.

— *Ku doni të dilni? Në faktin që shkrimtarët gëzonin njëfarë pavarësie?*

— Në faktin që, para së gjithash, një shkrimtar sot nuk ka shkak për t'u shfajësuar. Gama e veprimeve apo aktiviteteve të tij ishte mjaft e gjerë. Lënda e tij ishte e survejuar, dakord, por jo deri në atë pikë sa t'i jepej mbështetje pa kushte regjimit. Në të kundërt, si e shpjegoni ju llojshmërinë e botimeve në këto vende, veçanërisht në vendin tim?

— *Nëse më lejoni, do ta trajtojmë këtë çështje nën një tjetër këndvështrim. Ju jeni shkrimtar, keni shkruar dhe botuar nën regjimin komunist që ju hapi rrugën e karrierës. Si ndodhi kjo konkretisht?*

— E fillova me poezinë. Isha gjimnazist, shtatëmbëdhjetë vjeç. Në fillimet e mia shkruaja ç'më vinte ndërmend dhe çova një përmbledhje në një shtëpi botuese. M'i vlerësuan poemat si tepër intime, tepër personale. Më kërkuan të shkruaj diçka më të "dobishme" që t'i drejtohej një kategorie shoqërore apo kremtimit të një ngjarjeje me karakter kombëtar.

U përgjigja se do të shikoja nëse kisha shkruar diçka të tillë. Theksoj se kjo ishte një formë sugjerimi dhe jo një kërkesë direkte e shprehur qartë.

Kur paraqita këtë përmbledhje të parë që përmbante dhe një poezi për Parisin, drejtori letrar u habit. Nuk kuptonte përse e kisha shkruar. Meqenëse Parisi ishte kryeqyteti i një vendi të huaj, armik, sipas tij kjo poezi duhej hequr. I thashë se nuk do ta hiqja. Poezia më pëlqente, më dukej e mirë. Si e pa që ngulja këmbë në timen, u mendua pak dhe, si kundërpërgjigje, më foli për Moskën. Duhet të them se këtë nuk e mora për censurë. Nuk e dija se ç'ishte censura.

Në atë periudhë ishte në modë korrespondenca me vajza sovjetike. Kësisoj ai më propozoi të shtoj dhe diçka tjetër në përputhje me arsyetimet e tij.

Pranova. Kisha vërtet korrespondencë me një vajzë ruse që nuk e kisha parë kurrë. Ai më propozoi të shkruaja një poezi të shkurtër që të

fillonte me fraza të huazuara nga letrat që këmbenim, si: “E dashur Ludmillë, të shkruaj nga Shqipëria...” apo: “Miku im shqiptar, të shkruaj nga Moska...” Vargjet që më sugjeroi ishin idiote, kuptohet. Ishte thjesht një poezi e shkurtër...

— *Për Moskën dhe një vajzë moskovite?*

— Po, në dy-tre strofa. Ju kujtoj se isha vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç.

Më vonë botova përmbledhjen e dytë. Isha student. Ishte një përmbledhje krejtësisht lirike, personale...

— *Subjektive, siç thuhej atëherë?*

— Sigurisht, tepër intime. Përfshiheshin aty dhe disa balada paksa heroike sepse, ashtu si shumëkush në ato kohë, besoja në këto gjëra. Eshtë një libër që fare mirë mund ta shkruaj edhe sot.

— *Ju lutem të më ndjeni, Ismail Kadare, por ju thoni se besonit në gjërat që besonin të gjithë. Ju besonit tek epika, tek ideologjia e epokës?*

— Unë bëj dallim mes epikës dhe ideologjisë. Më dukej normale të shkruaja në një frymë epike, të evokoja tmerret e luftës. Më dukej diçka e

zakonshme, pozitive, si këtu në Francë kur shkruhet për Jeanne d'Arc-ën.

Në këtë përmbledhje kishte vargje për martirët e luftës çlirimtare apo për një dëshmor të vrarë nga një terrorist fashist.

— *Paraqitnit një popull që luftonte?*

— Kur je ende i ri, kjo është diçka që të tërheq. Na flisnin në shkollë për të. Për mua dhe shokët e mi jeta që bënim ishte e vetmja jetë normale, përderisa nuk njihnim tjetër.

— *Kjo nënkuptonte një pajtim, një miratim të regjimit të Enver Hoxhës?*

— Nuk kishim asnjë ide për pajtim apo mospajtim. Flas për vitet '50. Kampi socialist dukej i fortë, i qëndrueshëm. Nuk na shkonte në mendje të kishte mospajtim me regjimin, me përjashtim të njerëzve që e vuanin direkt këtë regjim si dhe familjeve të tyre...

Im atë, që ishte i moshuar, nuk e donte regjimin. Unë e kuptoja, ashtu siç kuptoja dhe xhaxhallarët e mi që ishin partizanë. Disa e donin këtë regjim, të tjerë jo...

— *Duke mos qenë dakord me regjimin, a ishte në rrezik babai juaj?*

— Jo, sepse ishte me një prejardhje modeste, një nëpunës i thjeshtë që nuk fliste për politikën me askënd. Edhe në shtëpi ai nuk e shfaqte hapur pakënaqësinë. Nëna ime, tezja dhe unë talleshim me këtë fakt: “Asnjë funksionar nuk i tregon zorrët e barkut”, etj. Dhe nuk na dukej dramatike.

Sepse, siç jû thashë, ishte një njeri i thjeshtë, një nëpunës i thjeshtë gjyqi që kishte parë e dëgjuar shumë gjëra, që kishte qenë i pranishëm në shumë raste dënimesh. Nganjëherë ai ndodhej në sallën e gjyqeve, i neveritur nga ato që shihte. Eshtë ky shkaku kryesor, mendoj, që i ushqente një pakënaqësi thujse të përhershme.

Pastaj, ngurrimi i tij përballë regjimit vinte dhe nga fakti që ai e kishte njohur Enver Hoxhën, diktatorin shqiptar. Ai kishte banuar në lagjen tonë...

— *Pra duhet thënë, për të çuar më tej formulën e Hegelit, se askush nuk është “njeri i madh” për të afërmit e vet?*

— Për tim atë, që ishte puritan, Enver Hoxha nuk mund të ishte njeri i madh, me apo pa thonjëza. Enver Hoxha frekuentonte kafenetë, lyente flokët me brilantinë, e si rrjedhim nuk mund të ishte një burrë shteti.

Ky njeri nuk ishte serioz. Im atë pretendonte se ishte i tillë dhe nuk e pranonte të kundërtën.

— *Pra kishte arsye personale për të mos e pëlqyer?*

— Nuk është pikërisht ajo që desha të them. Jo për arsye personale, më tepër arsye mentaliteti. Im atë e njihnte familjen Hoxha, sjelljet e Hoxhës, veprimet e tij dhe nganjëherë psherëtinte: “Të shkretët shqiptarë...” sepse, për të, ky burrë nuk ishte i tillë. Hoxha ishte një lloj dendi.

— *Dhe për të ishte i papranueshëm ky dendizëm?*

— Në njëfarë mënyre im atë kishte të drejtë. Ishte një naiv që kishte të drejtë, të paktën në këtë pikë... Shqipëria ishte një vend epik, ballkanik, që sipas tij kishte nevojë për një dorë të fortë. Hoxha ishte latuar nga Kominterni.

— *“Latuar nga Kominterni”, kjo formulë ka nevojë për një sqarim. Kominterni kërkonte njerëz të bindur e të lakueshëm?*

— Po. Enver Hoxha ishte zgjedhur sepse ishte elastik, i lakueshëm, i errët. Në Komintern kërkoheshin njerëz të tillë.

— *Megjithatë, Enver Hoxha drejtoi luftën çlirimtare kundër nazistëve. Ai u nda me Moskën*

pas destalinizimit të ndërmarrë nga Hrushovi. U nda dhe me Kinën. Në pamje të parë dukej si një dëshirë e flaktë për pavarësi...

— Eshtë e vërtetë që ai shfaqti një lloj guximi, një lloj dëshire për të sfiduar ata që cënonin sovranitetin e vendit. Por më vonë ai u përpoq të mbronte interesat personale dhe jo ato të Shqipërisë.

— *Nuk mendoni se qëndrimi i tij i përngjan një qëndrimi shqiptar, një rebelimi kundër...*

— Jo! Ai u nda me sovjetikët dhe kinezët kur e kuptoi se përbënin një rrezik për të, për personin e tij. Aleatët e tij donin ta përmbysnin. Nuk ishin arsye shtetërore ato që e shtynë Enver Hoxhën të vepronte ashtu siç veproi. Ai mund të sillej në të gjitha mënyrat e mund t'i përshtatej çdo situatë...

— *Do të doja t'i rikthehem rinisë suaj. Më parë përmendët kalimthi institucionin shkollor që kishte një kornizë ideologjike. Por fëmija Kadarka qenë anëtar i "Pionierëve". A jeni formuar ju nga kjo organizatë?*

— Në Shqipëri të gjithë kanë qenë pionerë. Të gjithë kanë qenë në organizatat e rinisë, përveç fëmijëve të të dënuarve politikë që ishin të

përrjashtuar. Në Shqipëri nuk ekzistonin organizata
rinore komuniste...

— *A ruani prej tyre ndonjë kujtim të pashly-
eshëm?*

Jo. Ne ishim nxënës dhe organizata e rinisë
rridhte nga e njëjta sferë. Nuk ishte dhe kaq e
rëndësishme sa ç'mendohet. Nuk e dinim përse
bënim pjesë në të. Bënim pjesë dhe kaq.

— *Për ju ky vizion i pashmangshëm për këto
lloj organizatash nuk i përgjigjej realitetit?*

— Eshtë një vizion i çuditshëm që i vesh
gjërat me një rëndësi që për ne nuk ishte dhe kaq
e madhe.

— *Nuk përjashtoj dhe një edukim i veçantë
në shërbim të regjimit?*

— Gjatë verës na dërgonin nëpër fshatra për
të ndihmuar fshatarët. Ose merrnim pjesë në
ndërtimin e një hekurudhe apo diçka të tillë. Dhe
thuhej se këto ishin aksione të rinisë.

— *Sipas jush, asgjë për t'u vajtuar?*

— Njerëzit shkonin me kënaqësi, aty vallë-

zohej.

— *A nuk i kushtoheshin të gjitha përpjekjet një pedagogjie si ajo e Makarenkos, për shembull, që ishte në fuqi gjatë epokës staliniane në Bashkimin Sovjetik?*

— Shumë fenomene që ndodhën në Bashkimin Sovjetik nuk ndodhën në Shqipëri. Çdo vend kishte specifikën e vet, për të mos thënë specialitetin e vet. Gjatë qëndrimit tim në Bashkimin Sovjetik pashë gjëra, si të them, të vërtetuara. Në Shqipëri ndodhën ngjarje “sensacionale”, nganjëherë të tmerrshme, por shpesh pa thellësi. Diktatura më tepër bënte spektakël. Ajo nuk pati kohë të gërmonte, të thellohej, nëse më lejohet ta them.

— *Shqipëria kishte huazuar nga Bashkimi Sovjetik disa trajta të diktaturës komuniste: partia unike ...*

— Pa dyshim. Shqipëria i kishte të gjitha trajtat e diktaturës komuniste, dhe shpesh në forma barbare.

— *Jeta shoqërore dhe veprimtaritë politike ishin në shënjestër të policisë së shtetit, policisë sekrete ...*

— Pa të, pushteti nuk do të kishte qëndruar në këmbë as një javë. Megjithatë e ritheksoj se gjërat nuk ishin kaq të përpunuara sa në Bashkimin Sovjetik.

— *Apo si në Kinë, përderisa Shqipëria dikur e mori si model ...*

— Por trajtat e diktaturës, nëse ishin spektakolare, e përsëris, gjithësesi ishin më pak të spikatura se gjetiu. Veçoritë e Shqipërisë konsistonin në veprime të shpejta, por të pastudiuara dhe shpesh kontradiktore. Një veprim i ndërmarrë mund të kundërshtonte një tjetër. Dhe fakti që Shqipëria e la kampin socialist krijoi një mori problemesh të cilat e përçanë, e prishën unitetin e diktaturës. Nuk u pranua të hiqej dorë nga zakonet sovjetike e më pas nga zakonet e importuara nga Kina. Mbetën vetëm zakone krejtësisht diktatoriale. U bënë përpjekje për të krijuar zakone të reja, por ishte tepër vonë.

Hoxha ishte tepër i mprehtë. Ai e kritikoi Bashkimin Sovjetik kur pati nevojë për ta bërë këtë, për të forcuar pushtetin e vet. Dhe arriti ta kritikonte Bashkimin Sovjetik kur aty u zbuluan përmasat e krimeve të Stalinit, të cilin ai e adhuronte.

Njëkohësisht dhe në një mënyrë të paqartë ai denonconte kampet siberiane. Përdori njëherësh

propagandë staliniane dhe antistaliniane. Arriti deri aty sa ta kritikonte kulturën sovjetike duke u bazuar në shabllone gjoja perëndimore. Çuditërisht ai kishte neveri për cirilizmin. Pra ai shfrytëzoi një arsenal të caktuar armësh që thuhej se vinin nga Perëndimi. Përdori çdo mjet për të mbrojtur, në varësi të rrethanave, kauzën e vet. Dhe kështu, në disa raste, provokoi një çorganizim total të disa hallkave të sistemit.

— *Sidoqoftë në Shqipëri ekzistonte një ideologji masive, një ideologji e pranishme në të gjitha hallkat e jetës, pavarësisht karakterit të rrëmbyer të Enver Hoxhës, ndryshimeve të tij në fjalime, në orientim ...*

— Sigurisht, sigurisht ... Por dëgjoni, po ju jap një shembull të asaj që ndodhi, a e dini që në Shqipëri u ndalua gjithë letërsia sovjetike dhe ajo e vendeve të Lindjes? Një paradoks i madh, apo jo?

— *Bëhet fjalë për vitin 1956?*

— Jo, për 1960-n. Përsa i përket Ruisë, u lanë në shitje vetëm Leon Tolstoi dhe Çehovi. Gjithë autorët e tjerë rusë, e si rrjedhim dhe ata sovjetikë, u zhdukën nga libraritë; letërsia bashkëkohore e vendeve socialiste pësoi të njëjtin

fat.

— *Nga larg kjo dukej e pranueshme dhe e papranueshme ...*

— Eshtë një nga aspektet e kundërshtive për të cilat ju fola. U bënë përpjekje për ta mbushur boshllëkun me letërsi kubane, vëllimi i së cilës ishte i pamjaftueshëm. Atëherë hodhëm sytë nga letërsia përparimtare perëndimore. Por ajo nuk ishte e të njëjtit kallëp me letërsinë klasike sovjetike, madje ishte më dogmatike. U botuan shkrimtarë amerikanë si Dreiser, Dos Passos apo Maurice Druon, ndërsa Sartre-i jo, ky për atë kohë u vlerësua me prirje komuniste.

Diktatura e Enver Hoxhës pati shumë pengesa, uniteti i saj ishte gjithnjë në rrezik shkatërrimi... Mos harroni që u ndaluan gjithë filmat dhe muzika sovjetike...

— *E kam të vështirë të përfytyroj pasojat që sollën këto privilegje në lëmin kulturor të Shqipërisë së Enver Hoxhës...*

— Muzika sovjetike u zëvendësua nga muzika klasike dhe nga ajo popullore shqiptare. Pushoi një pjesë e madhe e arsenalit të propagandës thellësisht komuniste.

Gjithë poetët sovjetikë të viteve 30, 40, 50,

poezitë entuziaste dhe poemat e tyre optimiste u zhdukën nga libraritë dhe bibliotekat. Fitores mbi hitlerianët iu këndua me njëfarë përmbajtje.

Çfarë mbeti? Mbetën gjëra krejt të brishta, të paqëndrueshme. Prandaj dhe modelet u zhdukën dhe shkrimtarët përfituan për të botuar tekste të një natyre më intime. Pikërisht për këtë arsye ju fola për aspekte të pasigurta, sipërfaqësore e të papërpunuara të kësaj diktature që humbi zakonet e veta pa patur kohë të krijonte të tjera.

— *Sipas këtyre që thatë, diktatura e Enver Hoxhës ishte “sipërfaqësore”, “e cekët”?*

— Efektet e saj ishin të dëmshme, shpesh sipërfaqësore, sidomos në fushën e kulturës. Pa mbështetjen ekonomike të Bashkimit Sovjetik, Shqipëria u ndodh pak e çarmatosur. Pushteti hasi në vështirësi të mëdha për të krijuar një kulturë që t’i përgjigjej kriterëve komuniste. Dhe nuk ia doli dot mbanë. Ishte tepër vonë. Në mungesë të mbështetjes së Bashkimit Sovjetik, Shqipëria e Enver Hoxhës u ballafaqua me një boshllëk të tmerrshëm. Në sistemin shkollor u hoqën dy mijë tituj librash.

— *Prishja e marrëdhënieve çoi në masa rrënjësore.*

— Vetë prishja ishte rrënjësore. Shqipëria është i vetmi vend që bëri ndarje totale me kampin socialist. U ndaluan deri dhe këngët ruse...

— *Besoj se kultura kombëtare u rivlerësua dhe pësoi një zgjerim?*

— Përjetuam një fenomen interesant: u përzien tre burime për të formuar një kulturë pak a shumë origjinale. Kultura e kësaj periudhe u bë “kopja” e tre elementëve kulturorë. Ajo bashkoi kulturën klasike perëndimore, kulturën përparimtare dhe kulturën shqiptare. Duke qenë se Shqipëria u tërhoq nga kultura komuniste në shkallë botërore, si këmbim morëm pak ajër të freskët. Për të gjithë ata që kanë jetuar në kampin socialist nuk kishte gjë më të tmerrshme, më mbytëse se kultura sovjetike ruse.

— *Totalitarizmi rus me formën e tij perandorake dominonte gjithë sektorin e kulturës shqiptare?*

— Pa dyshim. Në gjithë shkollat shqiptare dëgjohej i njëjti avaz. Ishte bërë diçka e pashmangshme. Rusët ishin në zanafillë të çdo gjëje. Ua detyronim atyre gjithë shpikjet e mëdha, në të gjitha fushat. Asgjë nuk i shpëtonte talentit të tyre. Kur Hoxha i dha fund kësaj situate, të gjithë

psherëtinë të lehtësuar. Si një demagog kompetent që ishte, Hoxha i akuzoi rusët se na kishin shtyrë në iluzione. Ai përdori kundër rusëve argumentin kombëtar, u ngrit kundër rusifikimit dhe sovjetizimit të shoqërisë shqiptare. Kështu ai krijoi përshtypjen se ishte çlirimtari ynë. Dhe, në njëfarë mënyre, kjo i përgjigjet së vërtetës. Na urdhëruan të mos flisnim më për Rusinë, të mos nderonim flamurin sovjetik, të mos përdornim gjuhën e sovjetikëve, studimi i rusishtes nëpër shkolla u ndalua.

Më kujtohet se rastësisht kam takuar një çek që ishte larguar nga Çekosllovakia. Më tha: “Sa të lumtur duhet të jeni! Jetoni pa rusët, pa sovjetikët. E pabesueshme!”

— *Por ju, Ismail Kadare, jeni ballafaquar drejtpërdrejt me shkollimin sovjetik. Ju shkuat në Moskë si student...*

— Aty dhe i mbarova studimet...
(*Të qeshura...*)

— *Ju ishit aty kur Hrushovi erdhi në fuqi dhe u kthyet në atdhe...*

— Për fat të keq...

— *Edhe në Moskë, atëherë njerëzit kujtuan*

se po mërrnin pak ajër të pastër. Për të cituar formulën e Erhenbourg-ut, ky ishte “zhbllokimi”...

— Situata ishte komplekse dhe konfuze... Hoxha e provokoi prishjen e marrëdhënieve për shkak të këtij ajri të pastër. Por populli shqiptar nuk e mori kështu. Përgjatë pesëmbëdhjetë vjetëve ai ishte shtypur nga sovjetizimi. Larja e duarve prej rusëve i ngjante një fati të madh. Reagimi i parë përballë kësaj situatë të jashtëzakonshme ishte një ndjenjë gëzimi. Gjatë dy-tre vjetëve jeta në Shqipëri u liberalizua; zakonet sovjetike u hoqën qafe pa qenë nevoja e nënshtimit ndaj zakoneve të reja. Detyrimet e reja të diktaturës shqiptare ende nuk kishin hyrë në fuqi dhe “kinezëritë” e detyruara ishin ende tepër larg. U formova si shkrimtar në këtë “çlirim” që zgjati tre-katër vjet dhe botova romanin tim të parë, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur. Përbindëshi*, romani im i dytë, u botua kur tashmë regjimi ishte zgjuar. Dhe u ndalua.

— *U ndalua të botohej?*

— Jo, u ndalua pasi ishte botuar.

— *Dhe ç’ndodhi në këto rrethana?*

— Atëherë e kuptova se nuk mund të shkruhej

më kaq lirisht dhe kërkova një mënyrë tjetër për ta bërë këtë. Çdokush mund të konstatojë se kam krijuar vetëm një vepër gjatë diktaturës komuniste. Një vepër dhe jo dy. Nuk shkrova libra për shqiptarët dhe, fshehtazi, libra për të tjerët, evropianët. Megjithë vështirësitë e shumta që hasa.

— *Pjesa më e madhe e veprës suaj u krijua nën regjimin e Enver Hoxhës...*

— Pikërisht! Vepra ime është e lidhur, e njëtrajtshme, si nga pikëpamja artistike, ashtu dhe nga pikëpamja ideologjike. Është i njëjti univers. Më pas nuk u përpoqa të kompensoj ndonjë të metë. Jam krenar që zgjodha një moral të cilit iu përmbajta plotësisht.

— *Ju thatë se, në momente të caktuara, duhet të bije në ujdi me regjimin...*

— Të biesh në ujdi, “të bësh një nderim të detyruar”, nuk do të thotë kurrësesi të mbështetësh regjimin. Intervistat që kam dhënë jashtë shtetit e vërtetojnë këtë.

— *Si kështu?*

— Ato janë rreth treqind-katërqind faqe. Në

to nuk do të gjeni kurrë një mbrojtje të sistemit komunist shqiptar. Kurrë! Asnjëherë nuk kam thënë se regjimi shqiptar ishte demokratik, megjithëse më kanë pyetur shpesh për këtë çështje.

— *Dhe si u jeni përgjigjur?*

— Sigurisht që nuk e kam përmendur shtypjen, kjo ishte e pamundur. Por kur, për shembull, më pyesnin nëse kishte të burgosur politikë në Shqipëri, asnjëherë nuk e kam mohuar. “A ka shkrimtarë të internuar?” Sërish u përgjigja me një pohim. “Janë të dëgjuar?” Thashë jo, sepse kështu ishte e vërteta.

— *Liria juaj ishte e kufizuar e, si rrjedhim, edhe përgjigjet tuaja ishin të tilla. Ato mund të merreshin si tendencioze.*

— Megjithatë mund të thuheshin disa gjëra të ndershme që mund të zbulonin diçka. Kështu, në *Le Quotidien de Paris* m’u bë një pyetje tepër delikate: “Zoti Kadare, a janë të lirë shkrimtarët shqiptarë të shkruajnë atë që duan?”

— *Iu shmangët përgjigjes?*

— Jo. Përse duhet ta bëja? Thashë se, tek ne, kuptimi i lirisë ishte i ndryshëm nga ai që përdorej

në Francë. Gjatë një emisioni të drejtpërdrejtë në televizionin gjerman më bënë të njëjtën pyetje, e më pas erdhi dhe pyetja tjetër: “Zoti Kadare, a mund të shkruani kundër regjimit?” Për disa çaste nuk fola.

— *Kjo ishte përgjigjja juaj?*

— Kurrresi jo! Ja dhe përgjigjja: “Jo, nuk mund të shkruaj kundër regjimit. Ligji e ndalon.” Ç’mund të thoja tjetër?

— *Ju përdorët dredhinë e shteteve totalitare, ashtu siç këshillonte Brecht-i?*

— Jo, nuk përdora asnjë dredhi. Shkrova romanin *Kështjella*, që është një libër thujse normal. Deri në moshën tridhjetë vjeç nuk e kisha vrarë mendjen se si do të merreshin librat e mi nga censuruesit, cilëtdo qofshin ata. Isha krejt i lirë. Dhe vazhdova me *Kronikë në gur*, duke u përpjekur të ruaj lirinë time letrare sa më shumë që të ishte e mundur. Nuk pata presione vetëm nga shteti, por edhe nga kolegët e mi. Presionet e ushtruara prej shkrimtarëve ishin të tmerrshme. Ata nuk pranonin një letërsi të re.

— *Ata përdornin ideologjinë e shtetit për t’ju përjashtuar?*

— Ata spekuluan me ideologjinë. Për *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur* kritikant më të ashpra bazoheshin në faktin se nuk përmendja në roman partinë komuniste. Dhe kjo është e vërtetë. Nuk tregoja urrejtje ndaj gjeneralit italian, përkundrazi, për të ndieja mëshirë. Atmosfera që përshkruaja ishte tepër e errët...

— *Kemi të bëjmë me një fundosje...*

— Këto ishin gjëra të papranueshme për funksionarët e socializmit.

— *A ishte në fuqi realizmi socialist në Shqipëri? Cilat ishin pasojat e tij?*

— Po, realizmi socialist përbënte një notë kaluese. Ndoshta jo deri në atë shkallë qesharake sa në disa vende të tjera, por gjithësesi prania e tij ishte e dukshme. Nëse, për shembull, mbizotëronin skena të zymta e të trishtuara si në romanin tim *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, më vinin në dukje se “jeta jonë” nuk krahasohej me këtë atmosferë. E nëse nuk tregoja urrejtje ndaj armikut, nuk e kisha zbatuar siç duhej teorinë e luftës së klasave që na mësonte të ishim të pamëshirshëm me të. Në këtë shabllon mendimi nuk lejohej kompromis. Dhe, mbi të gjitha, nuk i jepja partisë komuniste rëndësinë që kishte patur

gjatë luftës.

Sipas logjikës së tyre, ata kishin të drejtë. Një miku im më foli hapur, dhe romani, pas disa hezitimeve, kaloi. Ndërsa *Përbindëshi*, (gjithnjë sipas këndvështrimit të tyre), ishte një roman i rrezikshëm sepse bënte fjalë për një ankth politik.

— *Nuk iu referuan Trojës? I shpërfillën ndikimet e Greqisë antike dhe iu përmbajtën vetëm rrjedhimeve ideologjiko-politike të romanit?*

— Nuk iu interesonin pikëpamjet e mirëfillta letrare. Para së gjithash, ajo çka kishin parasysh ishte ideologjia, dhe censura ushtrohej duke u bazuar në pasojat, kur libri ishte botuar tashmë. Përpilohej një qarkore sekrete ku rekomandohej të mos përmendej romani i cili, qysh prej atij momenti, dënohej me heshtje. Veprime në këtë mënyrë për të mos u thelluar në shkaqet e ndalimit. Nuk thuhej kurrë që ky apo ai roman ishte kundër regjimit ose diktatorit sepse vetë dënimi dhe formulimi i qartë i dënimit gjykoheshin të rrezikshëm. Kjo mund të nxiste tendencat “rebele”.

Thellë në zyra të errëta hartoheshin raporte që nuk bëheshin kurrë publike. Mjaftonte një sulm i vetëm kundër veprës së inkriminuar. Dhe nuk i ktheheshin më. Ajo ishte dënuar me heshtje.

— *Ju thoni që censura ushtrohej pas botimit, po kush e ushtronte këtë censurë?*

— Për rastin e *Përbindëshit*, kjo ndodhi në një mbledhje shkrimtarësh. Dikush e kritikoi romanin duke thënë se ishte një vepër perëndimore, dekadente, dhe kaq mjaftoi që romani të dënohej.

— *Por kjo nuk është një kritikë, kjo i ngjan më tepër një gjyqi.*

— Me të vërtetë që ishte një gjyq. Por fakti më paradoksal ishte se, shkrimtari që për motive joletrare kritikoi romanin tim, një ditë të bukur e pa veten në burg.

Ai bëri njëzet vjet burg dhe çështja e tij ende nuk është sqaruar. Eshtë po ky njeri që, kur e liruan, deklaroi se e kishin futur në burg sepse kishte “kritikuar” Ismail Kadarenë. I poshtri! Ai më ndaloi romanin.

— *Keni dijeni se pse ju kishte mëri?*

— Ai u arrestua pesë vjet pas botimit të *Përbindëshit*, në një kohë që i kishte punët shumë mirë me qeverinë. Gjeti një pretekst për t’u mburrur, duke harruar të thotë se më kishte akuzuar si “spiun të Perëndimit dekadent”...

Si mundi ta bëjë këtë? Ai sigurisht u përpoq të tërhiqej sa s'ishte vonë, por nuk i eci dhe, si përfundim, u largua nga Shqipëria. Hidhërimi i tij ishte kaq i madh sa u kthye kundër gjithë kombit. E shpalli veten serb; nuk ishte më shqiptar. Nuk e arriti lavdinë që shpresonte. Shkrimtarët mediokër mund të bëjnë gjithçka, për shkak të dështimeve personale ata mund të arrijnë deri në përçmim të popullit dhe atdheut të tyre.

— *Më lejoni që t'i rikthehem ndalimit të romanit tuaj. Përbindëshi ra viktimë e censurës, por ju vazhduat të botonit. Madje ju kishit lidhje politike me regjimin. Kishit një post të rëndësishëm në Lidhjen e Shkrimtarëve, ishit deputet...*

— Në Lidhjen e Shkrimtarëve nuk kisha asnjë funksion me rëndësi, isha anëtar i kryesisë bashkë me njëzet e pesë shkrimtarë të tjerë. Aty mund të figuroja edhe një mijë vjet, por është e tepërt kur thuhet se kisha funksione të rëndësishme. Përsa i përket funksionit tim si deputet, kjo deri diku ngrë disa probleme...

Disa shkrimtarë që kishin fituar njëfarë fame ishin deputetë, ashtu siç ishin dhe disa shkencëtarë të njohur apo disa muzikantë pak a shumë të dëgjuar. Duhej arritur njëfarë përqindje intelektuale. Të ishe deputet në Shqipërinë e Enver Hoxhës ishte gjëja më e parëndësishme në botë.

Sidoqoftë, në Kuvendin Popullor nuk “kuvendohet”...

— *A kishte ndonjë funksion ky Kuvend?*

— Asnjë, për Zotin! Mblidhej dy-tri herë në vit. Na paraqitej buxheti i shtetit që duhej miratuar. Paqartësia ishte totale. Ky institucion ishte absurd... Nuk kishte pikë rëndësie.

Isha deputet kur ndodhesha nën një ndalim kritik të veprës sime. Në tetor 1975 më detyruan të jetoja në një fshat të humbur. Madje më dëbuan nga Tirana. Përfytyroni pak një deputet që nuk ka të drejtë të banojë në qytetin që e ka zgjedhur. Tek ne të ishe deputet në atë kohë nuk ishte ndonjë gjë e madhe, për të mos thënë asgjë. Ishte Komiteti Qendror, Partia ajo që qeveriste në të vërtetë. Kuvendi ishte vendi ku mblidheshin kategori të ndryshme sipas përqindjeve: kishte aty sasi të duhura pleqsh, punëtorësh, fshatarësh, etj.

Askush nuk të kushtonte vëmendje kur zgjidheshe deputet e madje dhe ti vetë e harroje këtë fakt dy javë pasi të kishin zgjedhur.

Të ishe deputet nuk përbënte asnjë privilegj, por ta refuzoje këtë post, sado e vogël të ishte shprehja e ngurrimit, kjo vinte në rrezik jetën tënde (ose lirinë, në rastin më të mirë). Nuk mund t'i bëje bisht këtij “ofiqi” pa u ndëshkuar...

— *E nëse dikush gjithësesi refuzonte?*

— Nuk do t'i vlente shumë lëkura... Do ta linin dy, shumë-shumë tri javë pa e shqetësuar. Një heshtje e thellë e rrethonte. Një javë më pas e arrestonin. Pastaj informohej opinioni publik se i dyshimti ishte agjent i Perëndimit. Ai kishte marrë urdhra nga jashtë për t'u tërhequr nga funksioni i deputetit. Mospranimi i tij destabilizonte vendin. Dhe kulmi i kësaj psikodrame me nuanca tragjike ishte se të gjithë e besonin...

Populli nuk ishte i informuar dhe nuk kishte dijeni për deklaratat e njërit apo të tjetrit. Të ishe deputet nuk përbënte asnjë privilegj. Kjo ndoshta ju çudit. Por mund të thuhet se njëqind shkrimtarë nga më të rëndësishmit mund të bëheshin deputetë dhe shumica e tyre udhëtonin jashtë shtetit, e kam fjalën për shkrimtarë që kishin botuar diçka. Sepse Shqipëria e vogël duhet të kishte delegacionet e veta, të cilat krijoheshin me njerëz pak a shumë të shquar. Nëse në Francë organizohej një Javë e filmit shqiptar, aty dërgoheshin pesë kineastë, kuptohet. Nëse mbahej një simpozium për romanin shqiptar, dërgoheshin pesë-gjashtë shkrimtarë për të marrë pjesë. Të gjithë udhëtonin, dhe nuk bëhej fjalë vetëm për Kinën, Kubën apo Vietnamin... Delegacione kishte çdo muaj. Dhe nuk janë të vërteta pretendimet se nuk mund të merrje pjesë në këto udhëtime. Edhe shkrimtarët

më të thjeshtë udhëtonin, sadopak të njohur të ishin për krahinën e tyre. Sigurisht, kishte dhe shkrimtarë që, për arsye të ndryshme nuk udhëtonin: ish të dënuar politikë, ata që dyshohej se ishin spiunë apo agjentë të të huajve.

Me gjasë në Francë ka ardhur gjysma e shkrimtarëve më të njohur dhe, natyrisht, ky fakt ende nuk vlerësohet.

Për mua ishte krejt ndryshe. Sa herë që udhëtoja jashtë shtetit flitej poshtë e lart. Gjithësesi, të tjerët kishin avantazhin të udhëtonin si anëtarë delegacioni, ndërsa unë kam ardhur në Francë i ftuar nga botuesi im, pra privatisht. Ishte krijuar përshtypja sikur isha i vetmi shkrimtar shqiptar që udhëtoja, sepse shtypi dhe mediat pasqyronin vizitat e mia.

— *Këta shkrimtarë udhëtonin zyrtarisht, pra pa ndonjë vështirësi?*

— Zyrtarisht po. Por unë nuk kisha fare nevojë të figuroja në këtë apo atë delegacion. Për fatin tim të mirë më kishin mënjanuar në këtë pikë. Përsa i përket privilegjeve që duhet të gëzoja, më lini pak të qesh. Nga pikëpamja ekonomike isha shkrimtari më i persekutuar i vendit. Po pse, mund të më pyesni. Sepse të gjitha honoraret e mia konfiskoheshin nga shteti. Më jepnin një pagë si gjithë të tjerët.

— *Shkrimtarët pak a shumë paguheshin nga shteti. Mbi ç'bazë?*

— Kishte disa kategori shkrimtarësh. Më të vlerësuarit e nxirrnin gjysmën e honorareve nga një punë, gjysmën tjetër ua paguante Lidhja e Shkrimtarëve.

Ndërsa unë merrja një pagë që vlente një mijë herë më pak nga të drejtat e mia si autor. Të gjitha të drejtat e mia kalonin në buxhetin e shtetit. Kur fitoja një mijë dollarë, merrja vetëm një, kjo është e gjitha. Më thoni ku është privilegji këtu? Në këto rrethana është absurde të flasësh për privilegj. Ku janë këto privilegje? Mund të flitet vetëm për të kundërtën. Isha një individ i zhveshur nga të ardhurat e veta, dhe këto të ardhura, e përsëris, shkonin për të financuar marrëzitë e letërsisë shqipe...

BISEDA E DYTE

(dhjetor 1996)

Biseda jonë e dytë u zhvillua sërish në Saint-Claude, gjithnjë nën strehën e një Diderot-i ëndërrues.

Kësaj here e pamë të udhës të ndryshojmë vend për t'i shpëtuar zhurmave të ndryshme të fund-sallës.

Duke mos patur mundësi tjetër, u ulëm në taracën e brendëshme me pamje nga shëtitorja Saint-Germaine, që në atë orë ishte plot gjallëri, e zhurmshme e me rrjedhën e vet të makinave me sinjale tri ngjyrëshe që na kalonin shumë afër.

Para se të fillojmë bisedën e dytë, bëjmë një pasqyrë të së parës. Ismail Kadare më vëzhgon me vëmendje. Rifillojmë aty ku e kishim lënë.

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Gjatë bisedës sonë të parë trajtuam pozicionin tuaj si shkrimtar. Por ku konsistonte roli juaj në Lidhjen e Shkrimtarëve?*

ISMAIL KADARE: Jo kushedi se çfarë. Merrja pjesë nëpër mbledhje ku diskutoheshin probleme nga më të ndryshmet. Ndodhte që silleshin fakte lidhur me këtë apo atë shkrimtar, i cili, në një farë mënyre, mbetej i shpenguar.

Nëse dikush ishte joprodhimtar, mund edhe t'i hiqej rroga. Ishte shumë e thjeshtë, zbatoheshin rregullat e dekretuara nga regjimi.

— *Ismail Kadare, ju keni lindur në Shqipëri, u larguat në moshën njëzet vjeçare për në Moskë, ku zbuluat një shoqëri të ndryshme nga ajo shqiptare dhe një tjetër funksionim, ndoshta më të afërt me Perëndimin...*

— Që të jem i saktë, më lejoni që t'i ndaj këto dy fakte. Në fillim njoha Moskën e më pas Perëndimin, prandaj po vendos një vijë ndarjeje mes këtyre të dyjave.

— *Çfarë bënit në Moskë? Merrnit leksione në universitetin Lomonosov?*

— Jo në universitetin Lomonosov, por në Institutin Gorki ku studimet, si të thuash, janë të rezervuara për letërsinë.

— *Aty ku fabrikoheshin shkrimtarë në shërbim të regjimit?*

— Pikërisht. Një fabrikë që e furnizonte regjimin me shkrimtarë që i përmbaheshin disa kritereve të caktuara.

— *Dhe ishin shkrimtarë të mirë?*

— Kurrsesi jo. Mësova si të shkruaj duke mohuar, vetëm duke mohuar.

— *Por, gjithësesi, ju aty zbuluat letërsinë sovjetike?*

— Asokohe e njihja këtë letërsi, por në Institut kuptova se si duhet të shkruaja, sepse të gjitha rregullat apo dogmat që më mësuan atje më provokonin fillimisht mosbesim e më pas neveri. Thashë me vete: “O Zot! Duhet të veproj në të kundërt. Harroji të gjitha këto”.

— *Atëherë si e shpjegoni pozitën e Majakovskit në letërsinë sovjetike, i cili, nëse nuk gabohem, nuk ishte një poet realist socialist, por Stalini*

kishte urdhëruar botimin e veprës së tij të plotë?

— Besoj e kuptoni që unë preferoj Majakovskin më tepër se Stalinin. Majakovskin e kam vlerësuar gjithnjë. Flas për Majakovskin e vërtetë e jo për surrogaton e tij në kohën kur bashkëpunonte me propagandën dhe me dritaret Rosta. Majakovski i vërtetë nuk ka të bëjë fare me realizmin socialist.

— *Ky Majakovsk ju “flet” ende?*

— Pa dyshim!

— *Besoj se ju e kishit lexuar para se të shkonit në Moskë?*

— E njihja shumë mirë poezinë e tij. Vetëm më vjen keq që ende sot më tepër mësohet Majakovski i keq.

— *Cilat ishin principet themelore të Institutit Gorki? Ato që kishte formuluar Gorki në 1934 ose 1935?*

— Jua përsëris, asnjëherë nuk i kam marrë seriozisht leksionet që na jepnin. Nuk më kujtohet pothuajse asgjë. Isha student, i kënaqur e i shkujdesur pa dyshim, sepse isha i ri dhe për mua shkolla dhe studimet e këtij lloji nuk kishin asnjë

rëndësi. Atëherë kuptova se kisha të drejtë të prisja dhe këtë bëra.

— *Gjatë kësaj periudhe që përkon dhe me fillimin e erës apo mbretërimit të Hrushovit, në letërsinë e Bashkimit Sovjetik lindi emra të rinj. Mund të përmend këtu Jevtushenkon e Vosnesenkin.*

— Ju lutem të më falni, por më duket se po gaboni. Jevtushenko ishte vërtet i njohur në këtë periudhë, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Vosnesenkin...

— *Çfarë mendoni për poezinë kritike që u zhvillua në Bashkimin Sovjetik në vitet '60? A kishte depërtuar tashmë kjo lloj poezie në Institut?*

— Në Institut ishin gjithnjë të njëjtët poetë që bridhnin poshtë e lart. Më kujtohen disa poetë të dorës së dytë, “vogëlsira” që nuk krijuan asgjë me vlerë, me përjashtim të Bela Ahmadulina, Pankratov, Harabarov, etj. Atyre u jepeshin çmime, të cilat në Bashkimin Sovjetik ishin diçka e re.

Në romanin tim *Muzgu i Perëndive të stepës* kam shkruar se disa ministra, një ish-kryeministër i një krahine kaukaziane e ndoshta dhe drejtues të policisë merrnin pjesë në leksione. Të gjithë donin

të bëheshin shkrimtarë... Dhe ky nuk është një trillim romanesk, një fantazi...

— *Po nga pikëpamja letrare?*

— Ju e kuptoni që unë vija nga një vend shumë i vështirë, nga Shqipëria. Në lëmin letrar e ndiejmë vetëm blatërisht superior ndaj Moskës, Institutit dhe shkrimtarëve të saj.

Ju siguroj që vetëm mediokritetet arrinin të bënin bujë. Këta shkrimtarë nuk ishin në nivelin e duhur artistik. Ishin fillestarë, primitivë e mbi të gjitha naivë.

Për mua liria e të shkruarit ishte mëse e plotë. Liria i korrespondon një niveli të caktuar artistik dhe kur ky nivel bie shumë poshtë, liria zhduket. Mund të thuash ç'të duash, por në këto rrethana bëhet fjalë për një liri që do ta cilësoja vulgare, një liri kafeneje me të cilën, nëse të jepet mundësia, mund të ngrihesh kundër regjimit. Por në fushën e letrave është krejt tjetër gjë, ka shumë ndryshim. Pavarësisht nga larmia, ky nivel mbetet i mjerë, i trishtë... Me një fjalë, le të themi se nuk ishte "i këndshëm", artistik. Ajo çka shkruhej atëherë nuk mund të mbahej si letërsi e madhe. Ja pse nuk kishte rëndësi për mua.

— *Nuk mund të injorohet rehabilitimi gjatë kësaj periudhe i disa shkrimtarëve ose poetëve të*

persekutuar apo të dënuar nga regjimi stalinian.
Kam parasysh, për shembull Ahmatovën.

— Kishte shumë pak të tillë...

— Për Pasternakun nuk bëhej fjalë vetëm për
"probleme", por edhe për dënim, censurë...

— Unë kam jetuar në Moskë, aty kam shkruar
një roman ku e mbroj Pasternakun dhe përshkruaj
atmosferën e asaj kohe...

Paradoksi buronte (dhe këtë e kam deklaruar gjithnjë) nga fakti që Shqipëria ishte i pari vend lindor që, me anë të një romani, e paraqiste Pasternakun/pothuajse si hero, apo më saktë si personazh pozitiv. Ai ishte i vetëm kundër të gjithëve, kundër gjithë idiotëve të Lidhjes së Shkrimtarëve. Doktor Zhivago nuk u botua për faktin se, për nga vetë qëllimi i romanit, nga forma dhe natyra e tij letrare, ai ngrihej kundër shkrimtarëve sovjetikë, të cilët nuk ia falën këtë. Ata u shndërruan në kundërshtarë të vendosur. Si përfundim, fakti që Pasternaku u ndodh i vetëm përballë atyre që e dënuan e bënte atë pozitiv.

Në romanin tim kam përshkruar këtë fushatë të mjerë drejtuar nga ziliqarët xhelozë të Pasternakut. Denoncova gjithë xhelatët e letërsisë sovjetike dhe i pikturova ata me ngjyrat më të errëta që munda, madje me një lloj mizorie.

Shqiptarët u alarmuan. Menduan: “Ç’po ndodh? Qeveria duhet t’i dijë më mirë arsyet e këtij qëndrimi!” Sepse çfarëdo që të mendohet, Pasternaku ishte një personazh, ishte dikushi...

Përfitova nga mundësia që m’u dha nga ndarja me Bashkimin Sovjetik për të sulmuar ngrehinën e propagandës shqiptare. I njëjti stil... Por, meqenëse në këtë rast bëhej fjalë për sovjetikët, mund të dilje kundër.

Sidoqoftë më duhet të ngul këmbë në faktin që tek ne aparatçikët, mbajtësit e pushtetit, vepronin krejt njëlloj. Kështu që bëra një përshkrim të qelizave të regjimit sovjetik por, meqenëse në pamje të parë dukej sikur bëhej fjalë vetëm për sovjetikët, mund të mos pajtoheshe me këtë përshkrim, duke mos injoruar ndërkohë faktin që, si në Moskë dhe në Tiranë ishte e njëjta gjë, lundronim në të njëjtat ujëra...

— *Ju donit të denonconit qëndrimet dhe zakonet e tyre?*

— Këtë bëra, natyrisht, sepse nuk mund të tregohesha “i njerëzishëm” me ta, e si rrjedhim u ngrita kundër kësaj skote policësh, spiunësh e shkrimtarësh, të cilët i përkisnin të njëjtës racë.

— *A e njihite Shqipëria këtë dukuri? A kishit hasur ju në situata të ngjashme me ato të*

Bashkimit Sovjetik?

— Sigurisht. Ishte e njëjta gjë. E përmenda dhe në fillim. Nganjëherë, madje shpesh, ishim të detyruar të ngriheshim kundër imazhit tonë, të hiqnim dorë prej tij duke sulmuar atë që kishim më për zemër.

— *'Nuk kishte shteg për ndonjë dredhi? Njëfarë letërsie kontrabandë?*

— Jo, kjo nuk ishte e mundur. Vendi shtrihej në një sipërfaqe të vogël dhe mbikqyrja e tij ishte siguruar me lehtësi. Kjo mbikqyrje mbështetej tek terrori.

— *Atëherë, sipas jush, çfarë e karakterizonte totalitarizmin shqiptar, çfarë e dallonte atë nga totalitarizmat e tjerë të nxitur nga stalinizmi? A u praktikua totalitarizmi në Shqipëri?*

— Më habit pjesa e dytë e pyetjes tuaj. Po, sigurisht, nuk ka asnjë dyshim për këtë pikë. Ishte një totalitarizëm nga ata që hasen rëndom, një totalitarizëm i egër, barbar, i përshtatur për Shqipërinë dhe i bazuar në parimet bolshevike apo më saktë një model i krijuar nga Bashkimi i Revolucionit të Tetorit me ballkanizmin. Këto dy elementë formonin një përzierje shpërthyes, të paimagjinueshme.

Në Shqipëri para së gjithash bëhej fjalë për një totalitarizëm pasional që nuk i përgjigjej asnjë logjike, asnjë racionaliteti totalitar, por një pasioni totalitar të udhëheqësve. Ne u ishim nënshtruar gjendjeve të tyre shpirtërore, paranojës dhe sëmundjeve të tyre mendore. Në veprimet e tyre nuk kishte kurrfarë lidhje. Mund t'ju siguroj që hallakatja mbretëronte kudo. Kishte raste kur disa prej vendimeve që merreshin ishin kontradiktore.

— *Besoj se mbi të gjitha e keni fjalën për psikologjinë e Enver Hoxhës?*

— Kuptohet. Sentimentalizmi i tij, për shembull, luajti një rol të rëndësishëm — aq sa ç'mund të lozë rol sentimentalizmi. Ai ishte njëherësh sentimental e diktator, si të gjithë njerëzit me karakter të dobët.

Ai ishte në gjendje të qante në publik...

— *Enver Hoxha ishte tepër i ndjeshëm?*

— I ndjeshëm apo i sëmurë, merreni si të doni. Sa për të sjellë një shembull, po përmend këtu faktin që ndjeshmëria e tij i bënte përshtypje të madhe turmave. Jo rrallë hasje njerëz të ekzaltuar, të mallëngjyer nga ndjeshmëria e tij. Ata mahniteshin, mbeteshin pa mend. Thoshin se Enver Hoxha, përderisa derdhte lotë në publik,

ishte njeri i jashtëzakonshëm: “Ai qan. Keni parë ndonjë diktator komunist të qajë?”

Ishte i vetmi që qante.

— *I vetmi, vërtet?*

— Besoj se po, madje “drejtpërdrejt”, nëse mund të shprehem kështu. Duhet të shtoj se ai nuk qante kur lexonte fjalime, por në raste të tjera.

— *Meqë jemi këtu, a jeni takuar ju me Enver Hoxhën?*

— Vetëm një herë më 1971. Kurrë më parë apo më pas.

— *Biseduat me të apo thjesht u takuat?*

— Ne “biseduam” dy-tri orë.

Megjithatë theksoj që rolet i ndau: ai fliste dhe unë dëgjoja. Më foli si të mos ishte komunist, si të mos ishte ai që e udhëhiqte Shqipërinë.

— *Ku donte të dilte? Ç’pamje mori para jush?*

— Ai m’u paraqit si një intelektual i madh.

Enver Hoxha ishte një komedian, madje një aktor i madh. Nuk e përmendi politikën. Solli kujtime nga qyteti i tij i lindjes (dhe imi

njëkohësisht), kujtime nga Moska, Parisi, foli për muzikën shqiptare, për letërsinë dhe për leximet e rinisë së tij.

— *Me ç' rast apo me dëshirën e kujt u bë ky takim me Enver Hoxhën?*

— Oh! Nuk ishte veçse një takim joformal, domethënë ngjante si diçka e diktuar nga rastësia, por sigurisht që ishte krejt e kundërta.

Afërmendsh që për të shkruar *Dimrin e vetmisë së madhe* kisha nevojë për dokumentacion lidhur me mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste që u mbajt në Moskë e në mbyllje të së cilës ndodhi ndarja e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Duhet t'i pasqyroja ngjarjet sa më besnikërisht nëpërmjet dokumentave që mbaheshin sekret. Kështu formulova një kërkesë zyrtare e cila më dha mundësinë të shqyrtoj dosjet historike: “Më duhet të shikoj këto dokumente. A është e mundur?”. Por për t'i parë ato “më dërguan” të takoj drejtoreshën e arkivave, e cila ishte dora vetë e shoqja e Enver Hoxhës. Më dhanë autorizim. Gjatë disa orëve munda të shqyrtoj këtë dosje tronditëse. Në romanin tim e kam përshkruar këtë histori shumë të bukur, dramatike e tërheqëse.

Para se të më jepej leja, zonja Hoxha më ftoi një mbrëmje në shtëpinë e saj për t'u fjalosur e, ndërkohë që po bisedonim, Enver Hoxha hyri

kështu si *rastësisht*.

Dhe, siç ua thashë pak më parë, u realizua kështu takimi ynë. Ky takim u bë në 1971 e më pas nuk e takova më kurrë. Jetoi dhe katërmbëdhjetë vjet të tjerë dhe nuk iu afrova më.

Ky njeri — të themi të drejtën — mernte vesh nga letërsia. Kishte një shije letrare mjaft të hollë. Ju duket e çuditshme, apo jo?

E përçmonte në mënyrë të dukshme letërsinë zyrtare. Ai lexonte për kënaqësi. Kishte një nderim të thellë për letërsinë që, në kujtesën e tij, kishte mbetur si një kujtim pushimesh, si diçka e këndshme.

— *Pra, çuditërisht, ai dilte nga kornizat e ngushta të diktatorit me këtë vlerësim që i bënte letërsisë...*

— Lidhur me këtë Enver Hoxha ka shprehur mendimin e vet se si letërsia mund të arrinte kulmin e madhështisë, të bëhej e kulluar. Dëshira e tij e dukshme ishte të shkruante tregime, drama, poezi, etj. Ai mendonte, megjithëse nuk jam i sigurt për këtë, të zinte një vend në letërsi. Dhe duke mos patur mundësi të njëjhej si shkrimtar, kam përshtypjen se ishte i mikluar nga ideja e figurimit në një roman të vërtetë ku ai të zbulonte portretin e vet.

— *Doni të thoni që kjo vinte nga një dëshirë e fshentë?*

— Sigurisht, ishte mjaft e qartë...

— *A shkruante vetë?*

— Ah! Po. Me njëfarë talenti shkruante kujtime; përvijonte portrete, zotëronte një dhunti të vogël të të shkruarit. Në këtë fushë nuk mund ta akuzosh për sharlatanizëm. Ndodhte që nuk shkruante keq, ndonëse ajo çka shkruante nuk ishte aspak letërsi artistike. I përshkruante mjaft mirë situatat dhe portrëtet e tij ishin të goditur. Gjurmonte detaje. Sigurisht, këtu nuk e kam fjalën për veprat e tij politiko-teorike, cilësia e të cilave është në përpjestim të zhdrejtë me “kilometrazhin” e tyre. Këto idiotësi janë një mynxyrë pa pikë vlerë. Por dy-treqind faqe dëshmojnë për atë dhunti letrare që përmenda pak më lart.

— *Kjo dëshirë për të shkruar është një gjë e zakonshme tek politikanët, udhëheqësit dhe shefat e shtetit. Për ta të shkruarit është një tundim për të nënshtruar botën. Dhe radha e tyre është e gjatë duke filluar që nga Neroni e deri tek Mao Ce Duni (që duket se është një poet i madh klasik kinez). Mund të përmend Frederikun II të Prusisë, Saint-Juste-in, Robespierre-in, Napoléon Bonaparte-in.*

*Franco ka shkruar një roman dhe lista vazhdon...
Djaloshi Stalin shkruante poezi, ndërsa Brezhnjevi
mori vlerësimin më të madh të vendit të vet,
çmimin Lenin për letërsi...*

— Vërejtja juaj më duket tepër e saktë. Por të flasësh për poezinë duke iu referuar Stalinit, kjo nuk më duket e drejtë. Të gjithë e dinë që dorëshkrimet e këtyre njerëzve flenë nëpër funde sirtarësh...

Shkrimet e tyre letrare janë e vetmja gjurmë që kanë dashur të lënë pas vdekjes. Eshtë e kuptueshme...

Për shembull, për gjeninë e padiskutuar të Marksit për herë të parë dyshova instiktivisht kur lexova poezitë e tij. Ishte bërë zakon të ngriheshin në qiell, ndërkohë që mediokriteti i tyre dukej sheshit.

— *Bëhet fjalë për tjetër pushtet, për një mënyrë tjetër të ushtrimit të pushtetit, nëpërmjet joshjes...*

— Rikthehemi tek Stalini, krahasuar me Enver Hoxhën, ai nuk ngrinte peshë, nëse mund të shprehem kështu.

— *Kjo më kujton Antonio Gramsci-n që vinte në dukje rivalitetin mes shkrimtarëve dhe*

politikanëve. Të dyja palët kanë të njëjtin autoritet simbolik. Për shembull, kur Gramschi përmend Dante-n, shprehet për të se “ai është një parti më vete”.

— Një shkrimtar është më tepër se një parti, ai është një atdhe më vete. Ai flet në emër të këtij atdheu. Një shkrimtar si Dante e rilind atdheun e vet; ai është ekuivalenti, zëdhënësi i vlerave të epokës së tij. Mund të rilindë atdheun e vet, t’i vendosë gjërat në një tjetër perspektivë, t’i paraqesë ato në mënyrë tjetër. Ai bashkëpunon — megjithëse e di që kjo fjalë lë shteg për keqkuptim — për një “rilindje”. Dante hapi rrugën e “përdorimit” të të folurit popullor, duke i dhënë atij një dimension artistik. Nuk ishte vetëm pionieri i poezisë italiane që u zhvillua gjatë shekujve XV e XVI, por *Ferri* i tij e zgjeroi botën tonë. Një projekt i tillë i një poeti kurrë më parë nuk kishte njohur një shtrirje kaq të madhe.

— *Kemi biseduar gjerë e gjatë për totalitarizmin dhe pasojat e tij. Cili është përkufizimi juaj për totalitarizmin?*

— Mirë pra! Sipas meje, totalitarizmi është një harmoni negative, duke u shprehur në mënyrë paksa skematike. Në politikë nuk ekziston harmoni pozitive. Vendet relativisht të demokraci-

zuara nuk e kanë këtë lloj harmonie; ato nuk janë homogjene, ndërkohë që e vetmja formë shteti që paraqitet e bashkuar, harmonike është komunizmi, totalitarizmi.

— *Ju mendoni që utopia komuniste, në atë formë që u zbatua, përbënte një harmoni? Ajo, mbi të gjitha, pati mosfunksionime...*

— Utopia komuniste është një harmoni. Dua të them që ajo ishte rrjedhim i një pengimi dhe është ky pengim që krijon këtë lloj harmonie. Dhe ishte vërtet një harmoni.

— *Si e keni përjetuar këtë harmoni?*

— Harmoninë negative?

— *Po, harmoninë negative. A e kuptoni ju atë?*

— E çfarë të kuptuari se! Ajo ishte e formuar më së miri, pavarësisht nga ftohtësia dhe pesha e saj... Sidoqoftë, harmonia e vendeve totalitare nuk ka të bëjë aspak me harmoninë që mund të krijohet në vende të tjera ku ajo është thjesht e skicuar.

Regjimet totalitare u ngjajnë ndërtesave simetrike me një arkitekturë në të cilën simetritë dytësore janë rrjedhim i një simetrie parësore.

Çdo gjë në të është rrjedhim.

— *A bëni ju një dallim midis totalitarizmit komunist dhe totalitarizmit të tipit fashist?*

— Dallimi i vetëm që i ndan këto nga njëra-tjetra mendoj se është fakti që totalitarizmi komunist është më i ngjeshur, më i njohur se totalitarizmi fashist.

— *Më i përgjithshëm në përfytyrimin e vet?*

— Më i përgjithshëm dhe më i rrezikshëm... Totalitarizmi fashist ishte më sipërfaqësor, besoj... Ai nuk i kishte vënë vetes qëllime kaq të rëndësishme e me kohëzgjatje kaq të madhe sa totalitarizmi stalinian. Ky i fundit donte të arrinte jo vetëm shndërrimin e raporteve shoqërore, por edhe ndryshimin rrënjësor të natyrës së njeriut...

— *Hitleri mendonte se Rajhu i Tretë do të zgjaste njëmijë vjet. Nazizmi parashtronte zgjidhje duke filluar nga sundimi i "racës ariane".*

— Ndoshta Hitleri ka dashur të imitojë praktikat komuniste apo të huazojë disa nga qëllimet e tyre, por regjimi i tij, megjithëse ishte më dinamik, më i drejtëpërdrejtë e më i shpejtë, nuk gërmoi kaq thellë në shoqëri. Nëse doni të bëj një krahasim, do të përdor imazhin e dy

piramidave, një piramide egjiptiane dhe një piramide të ngritur me kokat e prera nga Timur Lengu.

Komunizmi kishte trajtat e piramidës egjiptiane: masive, e dendur, me një bazament të fortë. Ndërkohë që nazizmi kishte pamjen e një ngrehine më të dobët, më pak të ndyrë e misterioze.

— *Nuk ju kuptoj...*

— Piramida egjiptiane, që përfaqëson totalitarizmin komunist, është masive dhe harmonike. Në të terrori është i fshehur ndërkohë që dukja e saj është e lëmuar, hijerëndë e fashitëse... Tjetra është dhjetë herë më e shkurtër dhe përmbajtja e saj shfaqet më drejtpërdrejt...

— *E menjëhershme, më e dukshme?*

— Më e dukshme, pikërisht... Përse e përdora këtë metaforë piramidale? Për t'ju shpjeguar se, nëse baza e këtyre totalitarizmave është e njëjtë, njëri është më pak i tejdukshëm se tjetri.

Në rastin e komunizmit, pesha e pushtetit është më e rëndë, fshehja e këtij pushteti më e sofistikuar, më kuptoni?

— *Edhe diçka tjetër, lidhur me Enver Hoxhën... Ai ishte diktatori i një sistemi totalitar,*

por në romanin tuaj Dimri i madh ju bëni portretin e një tirani me kulturë...

— Këtu, Denis Fernandez-Récatala, unë ju përgënjeshtroj! Enver Hoxha nuk ishte një tiran me kulturë, por një tiran atipik.

— *Ai lexonte autorë të antikitetit dhe shkrimtarë revolucionarë...*

— Ishte një lexues sipërfaqësor! Ai lexonte shumë, është e vërtetë. Hoxha vuante nga ca lloj krizash të manisë së leximit, por mendoj se nuk ishte një lexues i vëmendshëm, i përpiktë...

Ai ishte tepër eklektik, një imitues i talentuar. Mos harroni që ju kam thënë se ai ishte një aktor i madh. Kishte stil, lustër...

— *Gjithësesi, nuk ishit i interesuar për figurën e tiranit të ditur?*

— Përse të isha? Vetë shkrimtari është një tiran, madje një tiran i madh. E si mund të ishe i magjepsur nga një tiran shumë pak i rëndësishëm: ata për të cilët flisni ju janë aktorë të këqinj, qenie mediokre, meskinë...

— *Duke ju dëgjuar në këto çaste më krijohet përshtypja se diktatura qeveriset si të ishte një*

dyqan bakalli.

— Pikërisht...

— *A bëni dallim mes diktaturës dhe tiranisë?*

— Ekziston vetëm një dallim. Tirania i referohet më tepër Greqisë antike, ndërsa diktatura futet në historinë e Romës.

— *Mund të thuhet se kemi të bëjmë me një lloj paranteze institucionale...*

— Që në parim nuk duhet t'i kalojë të gjashtë muajt... Por natyrisht që abuzohet... Por ju më pyetët se ç' dallim bëj mes diktaturës dhe tiranisë... S' do mend që tirania ka shtrirje më të gjerë dhe presioni i saj është më i plotë se në rastin e diktaturës.

Gati-gati ma ka ënda t'ju përgjigjesha me një shaka: flasim më me qejf për tiraninë e një gruaje se sa për diktaturën e një gruaje...

— *Kjo diferencë gjinish ju duket dome-
thënëse?*

— Sa më s'bëhet... Ky dallim nuk më duket thelbësor, i dobishëm... Kam përshtypjen se po kërkojmë qimen në vezë...

Dëgjoni: diktatura dhe tirania janë thuajse të ngjashme kur bëhet fjalë për llumin njerëzor për të cilën që të dyja kanë nevojë. Më kuptoni? "Lumin njerëzor"...

BISEDA E TRETE

(prill 1997)

U takuam edhe njëherë tjetër në Saint-Claude, më të qetë në këtë mjedis pasditeje. Parapëlqyem të ulemi në taracën e brendshme dhe porositëm dy kafet tashmë të zakonshme.

Para se të hynim, më pyeti, me një mirësjellje që më duhet ta vë në dukje, se ç'të reja kisha.

Për një kohë të gjatë u fjalosëm për shumë gjëra derisa u futëm në temë.

Bëra një përmbledhje të bisedës së mësipërme, Instituti Gorki, totalitarizmi, kalemxhinjtë dhe shkrimtarët, dhe dola te pyetja e parë.

*

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Më thoni, Ismail Kadare, gjatë bisedës sonë të mëparshme përmendëm Moskën, botën letrare... A keni dëgjuar aty të flitet për Solzhenicinin dhe Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit?*

ISMAIL KADARE: Ky tregim ende nuk ishte shkruar.

— *Ai u botua më 1963?*

— Po, pikërisht... Por më 1961 Solzhenicini “nuk ekzistonte”. Madje dhe emri i tij nuk ishte i dëgjuar. Askush nuk e njihnte...

— *Po më pas, a patët rast ta njihnit veprën e tij?*

— Po, më vonë...

— *Shumë më vonë?*

— Menjëherë pas botimit të tij.

— *A pati jehonë tregimi i Solzhenicinit në Shqipëri?*

— Absolutisht. Por unë munda ta lexoj nëpër

agjensitë e shtypit të cilat kishin shumë informacione.

— *Çfarë ndjetë kur e lexuat? U tronditët? Aty përshkruhej jeta në kampet staliniane...*

— *Çuditërisht jo, Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit më bëri shumë pak përshtypje. Në krahasim me ato që kisha dëgjuar, tregimi më dukej i thjeshtë, thujse elementar. Ai solli shumë pak gjëra të reja.*

— *Po më habisni.*

— Natyrisht, sepse unë prisja diçka më tronditëse. Jo vetëm nga pikëpamja letrare, por mbi të gjitha në planin historik.

Ajo çka dëgjova në Bashkimin Sovjetik ishte shumë më e tmerrshme. Disa miq të mi më kishin treguar diçka. Kisha dëgjuar tregime më dramatike, më tragjike.

Juve do t'ju duket i tepruar gjykimi im, por kjo shpjegohet me informacionet që mora në Moskë. Kam dëgjuar histori me ngjyra më të thekshme, me përmbajtje më të fortë, dhe kjo është arsyeja që në këtë pikë pata një interesim pak a shumë të vakët edhe pse, në fund të fundit, u habita pak.

— *Nga vinte kjo habi? Çfarë e shkaktoi atë?*

— Thashethemet.

— *Domethënë?*

— Thashethemet që shkaktoi botimi i tregimit. Për mua këto thashetheme ishin në përpjestim të zhdrejtë me të ashtuquajturat informata të tyre.

— *Ju mendonit se nuk vlente një jehonë të tillë?*

— Nuk e thashë këtë. Për sovjetikët ndoshta ia vlente... Por duke pasur parasysh informacionet që disponoja, për mua nuk ia vlente, vërtet nuk ia vlente...

— *“Vërtet”, ky ishte mendimi juaj? Për këtë arsye ju sapo u shprehët...*

— ...se teksti i Solzhenicinit paraqiste pak gjëra, vuante nga një lloj pamjaftueshmërie, rëndësia e tij nuk përbënte një eveniment të denjë për çlirimin apo liberalizimin që u shfaq në Bashkimin Sovjetik në atë kohë.

Ishte diçka shumë e vogël, më kuptoni, përballë ngjarjeve që ndodhën në BRSS...

Pa dyshim që ishte thjesht një përshtypje, një

përshtypje e gabuar, kuptohet, por të paktën kështu e ndieja unë...

Mendoja — dhe këtë moment e kisha pritur gjatë, — që në Bashkimin Sovjetik të zbuloheshin krimet e Stalinit dhe për to të flitej haptaz, që letërsia të bëhej e ndërgjegjshme për këto krime, pa lëshuar megjithatë në planin artistik...

Më kishin treguar gjëra shkatërruese...

Kemi lexuar tregime shumë pak interesante, madje të parëndësishme...

Ka gjithmonë një marrëdhënie mes krimit dhe letërsisë, kjo duket qartë, dhe nuk ka nevojë t'i rikthehesh teksteve më të hershme të njerëzimit për t'u bindur për këtë fakt, por në këtë marrëdhënie ndieja një lloj bezdie. Mes botimit të *Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit* dhe Kongresit XX të PKBS-së rrodhën thujse dhjetë vjet...

Mendoja që shkrimtarëve sovjetikë u takonte të shkruanin, të konturonin këtë dhimbje të pamatë, këtë gjëmë të mynxyrshme. Nuk e dija se rrjedha e ngjarjeve — një mënyrë e vjetër të menduari, — vazhdonte ende për ta. Sepse për Stalinin flitej në shtyp, nëpër mbledhje. Në to shpalosej shtrirja e katastrofës, detajoheshin krimet e Stalinit, numëroheshin: “Ai ka bërë këtë, këtë dhe këtë...”

Letërsia sovjetike thujse nuk e ceku fare këtë temë, madje dhe në ato pak raste që e trajtoi, përdori doza homeopatike, duke përjashtuar këtu,

natyrisht, *Arkipelagun gulag* që është, ashtu siç do të ishte shprehur James Joyce-i, një katedrale e dhimbjes.

— *Më 1956 u mbajt Kongresi XX i PKBS-së, që sidoqoftë çeli perspektiva të reja. Aty Hrushovi, duke denoncuar krimet staliniane, u përpoq të liberalizojë regjimin, megjithëse nuk bëri një ndryshim rrënjësor. Është fillimi i shkrirjes së akullit...*

— Ndoshta. Kam qenë dhe në vende të tjera më pak të lira ku letërsia gëzonte (dhe ky është një paradoks) liri më të pakta; ajo i nënshtrohej kushteve më të ashpra se në Bashkimin Sovjetik. Megjithatë aty herë pas here botoheshin gjëra të guximshme. Në këtë atmosferë staliniane, shkatërruese, spikaste guximi i disa shkrimtarëve, por ky fakt nuk bënte dhe aq përshtypje...

Nga pikëpamja e lirive, Bashkimi Sovjetik pas-stalinian i ngjante një parajse nëse do ta krahasonim me atë që kaluam ne. E megjithatë...

Letërsia, që të mos i largohem kësaj teme, më dukej e prekur nga një prapambetje kur bëja krahasimin me lirinë politike që dukej se gëzonte vendi. Një përshtypje e rremë, mashtruese, që vinte nga fakti se unë bëja krahasim me vendin tonë ku çdo gjë ishte e ndaluar.

— *Kjo është e kuptueshme... Ç'vend zë Dimri*

i Madh në këtë periudhë? Sepse ky roman është, në njëfarë mënyre, produkt i prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike.

— Titulli në original është *Dimri i vetmisë së madhe*. *Dimri i madh* u imponua si titull më vonë, në botimin e dytë të romanit.

Por më lejoni, Denis Fernández-Récatala, t'ju bëj një pyetje... Më keni pyetur për *Dimrin e madh*?

— *Përse ma bëni këtë pyetje?*

— Përse? Këtu qëndron problemi. Kur një gazetar kërkon sqarimin e kësaj apo asaj pike, ndodh që, para se të jepet përgjigjja, ai e ndërpret papritmas autorin me pyetjen: “Përse kërkonti të justifikoheni?” Kjo pabesi prej akuzuesi publik më revoltonte.

— *Nuk mendoj se bëj pjesë në këtë kategori, Ismail Kadare...Pra po ju kërkoj “sinqerisht” shpjegime lidhur me Dimrin e madh...*

— Eshtë një histori e gjatë dhe e ndërlikuar, e për këtë një nga shkaqet duhet kërkuar në urrejtjen tradicionale të Rusisë ndaj Shqipërisë.

— *Për shkak të Sllavëve të jugut?*

— Po! Carizmi ishte armik i deklaruar i Shqipërisë, madje armiku numër një, siç thuhej në atë kohë.

— *Sipas jush Rusia Sovjetike ndoqi këtë rrugë?*

— Ajo u tregua armiqësore ndaj nesh në disa forma, kjo është e gjitha. Shkurt, *Dimri i madh* tregon vetëm këtë armiqësi. Por përpara se të merremi me brendinë e këtij problemi, do të doja të përshkruaja rrethanat që më shtynë ta shkruaj këtë roman. Ajo çka dua të them nuk përmban hollësira. Në atë periudhë, rreth 1968-69 ndihesha i rraskapitur.

— *I rraskapitur? Sa romane kishit shkruar?*

— Katër. Nga i pari, *Qyteti i jugut*, botova vetëm disa pjesë. Ai u ndalua dhe disa miq më këshilluan ta digjja. I dyti, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* — për të cilin është krijuar përshtypja se është romani im i parë, — u botua me vështirësi të madhe dhe ra në gjysmë-harresë. *Përbindëshi* u ndalua. Përsa i përket romanit të katërt (që në Francë nuk është botuar ende), pashë i tmerruar se kisha bërë lëshime ndaj estetikës realiste socialiste...

— *Nga e cila ju gjithësesi qëndruat larg?*

— Jua thashë: nuk i bëra dot ballë presionit të mjedisit. Libri i katërt nuk ka ndonjë meritë të veçantë. Lexuesi francez do të bindet për këtë së shpejti. Nuk përpiqem ta fsheh. Ai është pjesë e jetës sime si shkrimtar në një vend të nënshtruar nga regjimi totalitar. Kritika komuniste u tregua entuziaste për këtë roman njëqindfaqësh të titulluar *Dasma*. Atëherë e kuptova se duhet t'i shmangesha kësaj rruge të ezauruar.

— *Ishit gati të hiqnit dorë nga të shkruarit pas atij suksesi që e konsideruat si një dështim?*

— Isha i tronditur nga fakti që, në katër romane, dy ishin ndaluar, i treti dremiste nëpër qoshet e bibliotekave dhe i katërti, i censuruar, më diskreditonte relativisht si shkrimtar.

Në fakt kisha parë fundin e karrierës sime letrare. Nga ana tjetër tashmë e shihja veten në burg për mospranim kompromentimi; alternativa ishte shumë e thjeshtë: ose të bëhesha një shkrimtar idiot për të cilin krijimtaria ishte dytësore, ose të bëhesha një kundërshtar i regjimit që do të dergjej burgjeve. Apo vetëvrasja... Isha tridhjetë vjeç dhe horizonti im zyptohej përditë e më shumë.

— *Megjithatë ju ishit i njohur...*

— E saktë. Nuk doja të bëhesha shkrimtar i regjimit, i një regjimi që do të abuzonte me famën time. Histori me brigada sulmuese, me ndërtim socializmi, me heroizma komuniste, mbushur me parrullat e regjimit, jo, sinqerisht jo! Shumë pak për mua! Kisha nevojë për liri, aq më tepër që mendoja se më mbetej për të shkruar edhe tetëdhjetë përqind e veprës. Shtrydhja trurin për të gjetur një ide se si mund të më linin të qetë.

— *Dhe kjo ide ishte Dimri i madh?*

— Po, por mos e përshpejtoni rrjedhën e ngjarjeve. Duhet diçka e qëndrueshme. Nuk mund ta hidhja lumin me nja dy poezi apo tregime. Një haraç i tillë do të ishte i pamjaftueshëm. Duhet të shkruaja një roman për konfliktin mes Shqipërisë e Bashkimit Sovjetik. Po që se e shkruaja, do të siguroja lirinë time për disa vjet. Censorëve të mi mund t'u shpallja përpara fytyrës: “Përshkrova epokën. E mjaftueshme, apo jo?”

— *Me një fjalë, ky roman do t'ju ndihmonte të jetonit si shkrimtar?*

— Kështu shpresoja. Tema vetë ishte bërë tabu. Asnjë tekst letrar nuk e citonte prishjen e

marrëdhënieve. I shkrova Ramiz Alisë, sekretarit të propagandës: “Shoku Alia, mendoj të shkruaj një roman për Shqipërinë socialiste dhe Bashkimin Sovjetik revizionist...” Përdora një formulë tepër të njohur për kohën... Kërkova të më jepej mundësia të shfletoja dosjen sekrete që ishte nëpër arkiva.

— *Besoj se morët një përgjigje pozitive?*

— Ramiz Alia më la shumë muaj në heshtje. Kur fliste për mua, më quante të çmendur. Një shkrimtar kërkoka të zhbirojë sekretet e zotave. Më në fund, një ditë të bukur, (shumë muaj më vonë), ai vendosi të më priste. Kërkesa ime iu duk shumë e çuditshme. Dhe jo për faktin që dosja mbahej sekret. Unë e binda se bëhej fjalë për një konflikt të shkëlqyer, “të fortë”, kuptohet, por mbi të gjitha “të mirë”, domethënë “të mirë” nga pikëpamja letrare. Ai më vuri në dijeni se do të mendohej.

— *A e informoi ai Enver Hoxhën?*

— Natyrisht. Ramiz Alia më telefonoi për të më dhënë pëlqimin e tij. Po përpiqeshin të gjenin dosjen, sikur të kishte humbur. Një tragji-komedi e vërtetë. Por, papritmas, ngjarjet rrodhën si të mos ekzistojë fare, si të më kishin dërguar në Hënë.

Kadareja nuk ishte më shkrimtari që shkruante vetëm për Greqinë antike. Kisha fituar qetësinë time, kisha zbuluar besimin tim.

— *E arritët qetësinë tuaj duke shkruar një roman me pesëqind faqe?*

— Nuk është kaq e thjeshtë...Më dërguan te Nexhmije Hoxha, gruaja e diktatorit. Ajo ishte gardiane e arkivave. Më vuri në dijeni se kërkimet e mia do t'i nënshtroheshin disa rregullave shumë të rrepta. Në dalje shënimet e mia do të kontrolloheshin.

— *Nuk dyshuan për ato që do shkruanit?*

— Sigurisht që po! Por ata u treguan zemërgjerë e të dashur. Mbajtën një qëndrim tepër fisnik ndaj meje. Ata po respektonin lirinë time si shkrimtar. U thashë disa miqve të mi: “O Zot! sa kanë ndryshuar...Si të ishim në Francë!” Madje më lanë të zgjedh edhe datën. Nderimet e tyre të pazakonta, e pranoj, më turbulluan.

— *Dhe praktikisht ju nuk hasët në vështirësi?*

— Aspak. E shfletova dosjen. Ishte diçka e mrekullueshme. Për herë të parë pashë se çfarë ndodhte në sferat e larta të botës komuniste. Këtë



e përshkrova me hollësi në Dimrin e madh, ju e dini mirë. Por mendoni pak të keni mundësi për herë të parë të lexoni të vërtetën e gjallë, lakuriqe, të kësaj mbledhjeje të Moskës ku propaganda nuk i ka lëmuar mendimet e këtij apo atij udhëheqësi. Aty kishe me se të mahniteshe: atmosferë mesjetare, moderne, e zyrtë, kurdisje intrigash, copëza fyerjesh, britmash, kërcënimesh...Mbajta shënime të cilat m'i kthyen të nesërmen.

— *Kjo punë mori fund shpejt e shpejt...*

— Ju vjen për të qeshur! Nuk u zija besë. Nuk isha ende i bindur se mund të shkruaja ç'të doja e si të doja. Por duhet ta pranoj që ndaj meje nuk u ushtrua asnjë presion. Ishte një situatë ideale. Megjithatë intuita më shtynte të mendoja se kjo fashitje nuk do të zgjaste shumë. Kur arrita të shtij në dorë materialin e dosjes, iu futa menjëherë punës për të shkruar Kështjellën.

(2)

— *Përse?*

— Kisha kohë, kohë të lirë dhe qetësi, mandej nuk isha i sigurt që kjo situatë do të mbetej kështu. Ia dhashë botuesit këtë roman që nuk kishte të bënte fare me komunizmin. Ai ishte i shqetësuar. Romanit, për t'u ruajtur, i kisha vendosur datë më të hershme. Propaganda nuk u tregua entuziaste.

3

Atëherë fillova të shkruaj *Kronikë në gur*, një roman që sërish nuk kishte të bënte me komunizmin.

— *Romani u botua pa probleme? Nga ju pritej tjetër gjë...*

— Kaloi me lehtësinë e zarfit në kutinë postare. Ramiz Alia ishte i shqetësuar. Ai më thirri: “Më thuaj, ku je me romanin që na the se do të shkruaje?” I thashë që po punoja, që këto dy romane i kisha shkruar më parë dhe që, për t’i hequr qafe, i kisha çuar për botim. Më dëgjoi me dashamirësi. Kështu, nën hijen e romanit tim të ardhshëm, kisha shkruar e botuar dy romane pa iu nënshtruar kontroleve. Përfitimi ishte i konsiderueshëm. Isha i lumtur që kisha botuar dy romane që nuk mburrnin e nuk shanin askënd e që publiku i lexonte. 9

Dimri i vetmisë së madhe kishte dhënë frytet e veta. Vetëm në sajë të tij kisha shkruar dy nga romanet më të rëndësishëm të veprës sime.

— *Kur e filluat Dimrin e vetmisë së madhe?*

— Nga fundi i 1970-ës, fillimi i 1971-shit. Kishte kaluar një vit nga kërkimi im nëpër arkiva dhe kishte ardhur koha ta shkruaja *Dimrin*. Helena, ime shoqe, ishte e shqetësuar. Por unë e

qetësova. Dyzet faqet e dosjes, që përbënin dhe pjesën dokumentare të romanit, në njëfarë mënyre më mbronin. Me ta mbaruar romanin, u takova me “shokun” Ramiz Alia: “A doni t’i lexoni dyzet faqet që kisha premtuar t’jua tregoja?” Po ju kujtoj se Dimri i vetmisë së madhe kapte pesëqind faqe...

— “Kontrata” juaj mjaftohej me dyzet faqet e nxjerra nga dosja?

— Po, raporti ishte në favorin tim. Por ja që pas një tjetër heshtjeje, Ramiz Alia më telefonoi. Nuk e fshihte sikletin. Po i vinte rrotull e rrotull. Më tha se ishte kurioz ta lexonte të gjithë librin, në mënyrë “krejtësisht miqësore”. Sido që të ishte, libri do të mbërrinte në shtëpinë botuese. Ramiz Alia shpejt a vonë do të njihej me librin. Kështu që...

— Nuk ju bëri vërejtje për ato dyzet faqe?

— Arkivat nuk patën asnjë kundërshtim. Marrëveshja ishte respektuar. E vura në dijeni Ramiz Alinë i cili, me zemërgjerësinë e panda-shme, m’u përgjigj se mund të bëja ç’të doja. Më dërgoi dhe një raport të shkurtër. E kishte lexuar romanin: “Mendoj se është interesant por, të lutem, mos ia bëj askujt të ditur opinionin tim. Nuk dua të ndikoj në shtëpinë botuese.” Gjест i bukur,

demokraci e madhe, më kuptoni? I thashë se kjo do të mbetej mes nesh. E dorëzova romanin te botuesi. Më pas “përgjegjësi i romaneve” më dha pëlqimin e vet e ca më vonë më kërkoi korrekturat.

— *Të rëndësishme?*

— Mbiemra, gjëra pa rëndësi, që më hëngrën vetëm çerek ore kohë. Isha i befasuar. Sapo kisha shkruar “anti-himnin” e universit komunist. Propaganda dhe letërsia realiste socialiste festonin qysh prej dyzet vjetësh ndarjen me Perëndimin. Me *Dimrin e vetmisë së madhe* (e më pas me *Koncertin*) kisha marrë përfundimisht anën e kundërt. Aty unë i thurja lavdi ndarjes me Lindjen dhe me komunizmin. Ky është thelbi i romanit e njëkohësisht ajo çka i interesonte publikut shqiptar. Ja pse këto dy romane (të cilët i jepnin fund një tabuje dhe përmbysnin idhujt) ishin më të njohurit në vend, në mos më të vlerësuarit. Jua përsëris (me frikën se po ju mërzis) se pikërisht në këtë drejtim *Dimri* është një “anti-himn” e se nën këtë këndvështrim duhet gjykuar. Të tjerat s’janë veçse meskinitete. Nga ana tjetër, portreti i komunizmit u interesonte të gjithëve.

— *Përtej kufijve të Shqipërisë?*

— Si jo! I kisha ngulur thikën në zemër

komunizmit! Në roman Kremlini i ngjante kështjellës së Makbethit ku vrasës, kurtizanë, maskarenj e hipokritë kërkonin t'i nxirrnin sytë apo ta helmonin njëri-tjetrin gjatë gjumit të natës. Kisha pikturuar një tablo të zezë, krejtësisht negative e dëshpëruese të komunizmit ndër-kombëtar. Dhe romani u botua...

— *Cilat ishin pasojat në momentet e para?*

— Të kundërta me ato që prisja. Kundër meje u ngrit një fushatë e egër. Shtypi i bënte jehonë shqetësimit që me gjasë po përshkonte mbarë vendin. Botoheshin një ortek letrash që i dërgonin studentë, ushtarë, policë, militantë, veteranë komunistë, organizata gjithfarëshe...Dhe sa vinte e shtoheshin...

— *Kjo fushatë ishte e telekomanduar?*

— Thashë se bëhej fjalë për një fushatë, por më tepër i ngjante një stuhie, një uragani. Gjatë një periudhe prej më shumë se tre muajsh nuk pati ditë që të mos kishte protesta, artikuj që më dënonin, deklarata ministrash apo anëtarësh të Byrosë Politike. Në vijim të mbledhjeve militantët dërgonin telegrame ku kërkonin ndalimin e romanit. Diktatura ishte tronditur.

Edhe ministri i brendshëm u përzie në këtë

çështje. Ai deklaroi: “Dyzet faqe lexova nga ky libër dhe dyzet herë pështyva.” Në Tiranë të gjithë pyesnin: “E dëgjove deklaratën e ministrit të brendshëm? Përse nuk ndihet Enver Hoxha?”

— *Ai nuk ndërhyri?*

— Po, ndërhyri... Por para kësaj, një mbrëmje rreth orës dhjetë trokitën në portën time. E hapa dhe pashë një oficer të ri. Ai dridhej: “Shoku Kadare, armiku vepron në Shqipëri.”

— *Ç’donte të thoshte? Dyshonte te ju?*

— Përkundrazi. Ky djalosh rreth të njëzetave (që ishte edhe poet e student për letërsi) më paralajmëroi se në Komitetin e Partisë në Tiranë ishte thirrur një grup studentësh në të cilin bënte pjesë dhe ai. Kishin marrë urdhër të hartonin një deklaratë kundër romanit tim. Ai mendonte se kjo mënyrë veprimi ishte “anti-parti”. Shtoj këtu se ai aktualisht drejton partinë komuniste.

— *Ishte përpara një dileme...*

— Mendoj se po, ndërkohë që “Zëri i rinisë” ishte organi që villte më shumë vrer ndaj meje. Aty u botua një letër me titullin: “Korbat e zinj në botën tonë.” Dhe më e bukura, nëse mund të

shprehem kështu, është se dy ditë më parë Nexhmije Hoxha, e shoqja e diktatorit, më kishte telefonuar duke u hequr sikur s'dinte gjë: “Shoku Kadare, ç’po ndodh në shtyp? Jam shumë e çuditur.” Më merrte për një idiot. Dhe ia ktheva: “Para dyzetetë orësh më pyetët se ç’po ndodhte. E pra, pyesni X-in, ushtarin student, se përse e kanë thirrur së bashku me shokët në Komitetin e Partisë për të shkruar një pisllek kundër meje.” Ajo thujse më falënderoi që po e vija në dijeni për ato që po kurdiseshin. Por dy ditë më vonë fushata arriti kulmin. Gruaja e diktatorit kishte gisht në të. E kuptova.

— *Si e përjetuat këtë moment?*

— Me frikën e burgut, përderisa që të gjithë këtë synonin.

— *Pra fushata nuk u zbut?*

— Ajo veçse u fuqizua dhe u bë më e egër. Arrestimi im kërkohet thujse nga të gjithë. Kurrë më parë shtypi nuk ishte treguar kaq virulent. Duhet t’jua bëj të qartë se mjaftonte një rresht për të të dënuar: “Është personazh i dyshimtë, etj.” Po të përjashtojmë komplotet e mëdha politike organizuar nga regjimi, mund të them se një shpërthim i tillë në një interval kohe prej disa

javësh nuk ishte parë ndonjëherë.

— *Çfarë ndodhi me librin tuaj?*

— Me shpërndarjen e tij? Tirazhi prej njëzetepesëmijë kopjesh u shit në më pak se një orë. Punëtorët e shtypshkronjës kishin folur për përmbajtjen e tij. *Dimri i vetmisë së madhe* pritej me padurim.

— *Enver Hoxha nuk u prononcua?*

— Posi jo, gjatë një mitingu të militantëve në qytetin e dytë të vendit. Natyrisht, ishin përgatitur pyetje lidhur me problemin tim: “Shoku Enver, përse nuk merren masa ndaj autorit, përderisa romani i tij ka shkaktuar një mospëlqim të përgjithshëm?”

— *Dhe si u përgjigj ai?*

— Me një përgjigje inteligjente, dinake, djallëzore... E pranoi se e kishte lexuar romanin dhe se kishte dijeni për shqetësimin e shokëve të tij të luftës. Ai i kuptonte reagimet e tyre, revoltën e tyre të ligjshme. Por... por duheshin kuptuar dy gjëra: e para ishte se “shkrimtarët nuk janë si ne”. Ata janë intelektualë. Idetë e tyre janë të ngatërruara. Ata përdorin metafora, pra me një

fjalë, mendja u fluturon në qiell. Kthjelltësia e tyre nuk krahasohet me kthjelltësinë tonë prej komunisti.

Pastaj ç'do të mendojnë sovjetikët në qoftë se e dënojmë autorin? Ata do të thonë se janë shumë të fuqishëm (megjithë sulmet që autori drejton ndaj tyre në libër) dhe do të mburren me dënimin që do të marrë ky autor. Do të thonë: "Sa shumë na duan në Shqipëri!" Ja pse këtë çështje duhet ta zgjidhim me të butë.

— *Një përgjigje e errët dhe me dy kuptime, apo jo?*

— Sigurisht por, duke mbajtur një qëndrim të tillë, Enver Hoxha më mbrojti. Eshtë i vetmi rast kur ai u shpreh publikisht në favorin tim. Duhet të saktësoj: nga se apo nga kush më mbrojti? Isha kritikuar nga regjimi në fuqi, nga diktatura, nga funksionarët dhe militantët e saj fanatikë. Thelbi i historisë është që Enver Hoxha më mbrojti nga vetja e tij. Nga ky fakt ka rrjedhur dhe legjenda e diktatorit që më mbronte.

— *Ky fakt ju qetësoi?*

— Në këto rrethana ai më shpëtoi lëkurën, duhet ta pranoj. Më pas u përpoqa të mbijetoj si shkrimtar dhe besoj se kësaj ia kam arritur. Vepra ime më e kobshme është shkruar më pas e në të



unë nuk kam bërë asnjë lëshim. Pallati i ëndrrave dhe librat ku dënoj diktaturën erdhën pas kësaj periudhe të ndyrë.

Botova romane nën emërtesën “tregime”; ishte e vetmja mënyrë për t’i botuar...

— *Kur e lexon Dimrin e vetmisë së madhe me një sy të ftohtë, të krijohet përshtypja (në sajë të shkëputjes që ndodh në të gjitha nivelet: politike, ideologjike e madje edhe personale) se ju e mbështetni personazhin kryesor. Nuk ju duket se keni dhënë ndihmesë në një lloj apologjie të tiranit?*

— Dëgjoni, që t’i vemë gjërat në vendin e vet, ç’kam bërë unë në këtë roman? Para së gjithash nuk duhet harruar se ai është një tablo negative e komunizmit ndërkombëtar.

Eshtë një tablo e komunizmit ndërkombëtar në Moskë, në kryeqytetin botëror të komunizmit.

Të gjithë këta elementë duhen marrë në konsideratë. Ashtu siç duhet theksuar se bëhet fjalë për skicimin e një atmosfere që të ngjall tmerr.

— *Por dhe një pjesë e madhe e lexuesve tuaj kështu e konceptuan romanin. Aty Enver Hoxha shkëlqen...*

— Nuk jam i sigurt se mund të përdoret ky

cilësim. Problemi është më i thjeshtë. Më tepër se një lavdithurje Enver Hoxhës, në këtë roman unë i kushtohem përshkrimit të një episodi pozitiv të jetës së tij. Ndoshta të vetmit episod të tillë.

— *Por...*

— Por?

— *Nuk mund të mohohet që në Dimrin e madh Enver Hoxha shfaqet në një formë më të pranueshme...*

— Më të pranueshme për çfarë, Denis Fernandez-Récatala? Ky episod është real; nuk e kam përpunuar. Nëse lexon proces-verbalet autentike të kësaj kryemeshe moskovite (mbledhjes dramatike të përshkruar në *Dimrin e madh*), atëherë pa dyshim që personazhi kryesor ngjall njëfarë simpatie, sidomos përballë kundërshtarëve të vet.

— *Meqë jemi këtu, në Dimrin e madh Kina është munguesja e madhe, apo jo?*

— I keni rënë më të; çuditem se si pothuajse askush nuk e ka vënë re. Fakti që shtëpia botuese nuk më “sugjeroi” (siç e kishte zakon) të shtoja disa fjali për Kinën, m’a forcoi bindjen për këtë

ndryshim “mashtrues”, për të përdorur termin tuaj...

— *Nuk ju qortoj për këtë, Ismail Kadare. Dua të saktësoj orientimin e Dimrit të madh dhe vendin që zë Enver Hoxha në të.*

— Orientimin? Në *Dimrin e madh* sulmi që i bëhet komunizmit është i përgjithshëm, i plotë, edhe pse Shqipëria, në dukje, është e përjashtuar nga ky sulm. Këtu qëndron dhe absurditeti apo dykuptimësia e romanit, e pranoj, por nuk mund të veproja ndryshe.

Çfarë mund të paraqiste kjo tablo-gravurë për lexuesin e pjesës tjetër të botës? Atij i shfaqeshin para syve shefa klanesh e bandash me gangsterë. Dhe çfarë konstatonte ky lexues? Një mbledhje vrastarësh, kriminelësh, çdonjëri i gatshëm për ta vrarë tjetrin në gjumë e sipër.

Eshtë një tablo e përpiktë ku të gjithë udhëheqësit e komunizmit shfaqen si vrasës në shërbim të një kryevrasësi.

Asnjë nga lexuesit e mi shqiptarë nuk mendonte se Shqipëria ishte e veçuar nga kjo pikturë e zezë e komunizmit. Dihej që Shqipëria nuk bënte përjashtim nga rregulli komunist që qeveriste totalitarizmin komunist.

— *Ju jeni i bindur se kjo pikturë është e*

lexueshme?

— Për kë? Për një shqiptar? Pa as më të voglin dyshim. Nuk ishte e nevojshme të lexoje mes rreshtave: Kina, ky model pasardhës, solli përfitimet dhe humbjet e veta. Për një lexues pak a shumë mendjehollë ishte e qartë që, nën mbulesën e denoncimit të funksionimit stalinist, fshiheshin dy kritika konkurente që, në fund të fundit, e për çudi, plotësonin njëra-tjetrën.

— *Dy kritika?*

— Dy kritika, po. Duke përfituar nga prishja e marrëdhënieve, formohej kritika dogmatike, e urryer, një kritikë që e vinte theksin në revizionizmin e Bashkimit Sovjetik, akuzonte Hrushovin për liberalizëm perëndimor, portretizonte një komunizëm moskovit në dukje simpatik; por kritika tjetër, që rridhte nga kriteret në fuqi të asaj kohe, ishte më radikale: ajo drejtohej kundër prapambetjes, aziatizimit e mizorisë, shkurt barbarisë së BRSS-së.

— *BRSS po demokratizohej.*

— E megjithatë askush nuk besonte më në këtë fakt. Në mbledhjen e Moskës një shtet drejt liberalizimit kishte tentuar të nënshtrohte një shtet

të vogël që, për motive pozitive a negative, nuk e pranonte satelitizimin dhe diktatin e një super-fuqie...

— *Gjatë një prej bisedave të mëparshme kemi folur për dredhinë që duhet të përdorte një shkrimtar nëse donte të botonte gjëra të “bezdisshme” për atë periudhë. A ishte kjo një preferencë për ju? Ju keni bërë hile ndaj sistemit?*

— *Te Dimri i madh nuk pata nevojë të përdor dredhi. Do ta cilësoja këtë si një roman objektiv. Nuk pata nevojë t’i stisja dialogët e çuditshëm të këtij romani, por vetëm i rikrijova. Nuk pata nevojë t’i përfytyroja situatat, por u dhashë thjesht një kthesë letrare, artistike, nëse mund të shprehem kështu. Nuk pata nevojë të shtoja ndonjë shënim apo të bëja komente. Unë bëra një përshkrim, thjesht një përshkrim të atmosferës, qëndrimet e palëve, marrëdhëniet e tyre. U përpoqa t’i përmbahesha vërtetësisë. Veprova në të njëjtën mënyrë dhe për Enver Hoxhën, diktatorin tonë. Nuk i shtrembërova fjalët e tij. Pastaj, si mund ta bëja këtë? Ku mbështeteshja për atë që po shkruaja? U bazova në dyzet faqe të nxjerra nga arkivat. Kisha një kontratë rileximi me qëllim që të kontrollohej shfrytëzimi i këtij dokumentacioni. Shënimet e mia mbi këtë dokumentacion iu nënshtruan verifikimit. Dhe këto dyzet faqe të*

dosjes figurojnë në roman.

— *Një lexues perëndimor vëren se ju e keni privilegjuar Enver Hoxhën...*

— Eshtë e vërtetë se në këto rrethana fjalët e tij m'u dukën më pak absurde se ato të vrasësve të tjerë, më të sakta e më logjike se fjalët e Hrushovit e lakejve të tij që e mbanin veten (natyrisht me të drejtë) si më liberalë, shumë më liberalë se Enver Hoxha. Por, tek e fundit, ata ishin thjesht qesharakë e të neveritshëm.

Nëpërmjet akuzave të ngritura kundër Enver Hoxhës ata, si ta them, pretendonin që Hoxha kishte tradhtuar komunizmin, Bashkimin Sovjetik, "familjen". Ata i dënonin vizitat e tij në Perëndim. Dokrra... Ishte diçka absurde, idiote. Ndërkohë që përgjigjet e Enver Hoxhës, siç jua thashë, ishin logjike, racionale. Këto përgjigje dhe qëndrimi i tij shkaktuan një valë simpatie në Shqipëri, sepse ai ia kishte thënë troç Hrushovit dhe bandës së tij: "Nuk dua të jem vasali juaj." Vendosmëria e tij na pëlqeu, sepse ai veproi vërtet kështu në mbledhjen e famshme.

— *Ai ishte trim?*

— Ai guxoi, Denis Fernandez-Récatala; nuk do t'ju bëj moral: "Të dish të guxosh", etj. Ai

shkatërroi një formë të re të feudalizmit dhe, duke shpallur se nuk do t'i bindej urdhrave të kryezotit, ngjalli një nderim të përgjithshëm. Pikërisht këto përshkrova në roman, nuk kam se ç'të them tjetër.

Enver Hoxha shfaqet simpatik për vetë qëndrimin që mbajti në këtë mbledhje. Ai foli dhe tha ato çka kishte për t'i thënë disa njerëzve më të sinqertë (ndoshta) e më liberalë, por më pak inteligjentë se ai, edhe pse duhet thënë se sinqeriteti i tij ishte i kufizuar. Logjika historike ishte në anën e tij. Në të bazohej e drejta e tij.

Përballë kundërshtarëve të vet Enver Hoxha provoi se kishte të drejtë. Pala tjetër arsyetonte me logjikë feudali; ata treguan mendjengushtësinë e tyre.

Në sytë e tyre qëndrimi i Enver Hoxhës përbënte një tradhti ndaj Bashkimit Sovjetik. Ai ishte shndërruar në një lloj antikrishti.

Më vonë BRSS-në e tradhtuan edhe polakët, hungarezët, francezët, italianët, partitë perëndimore në përgjithësi, dhe që të gjithë këta e akuzuan diktatorin shqiptar se kishte bërë tradhti, pra me një fjalë kishte vepruar siç do të vepronin më pas dhe ata vetë, por vetëm e ashtuquajtura tradhti shqiptare u vlerësua e papranueshme. Kjo akuzë absurde ishte një palaçollëk.

Këtyre argumentave, po që se duhet, mund t'iu kundërvihen disa parime bazë të komunizmit (gjithnjë nëse një ditë ato do të ishin zbatuar në

praktikë). Siç është, për shembull, e drejta e popujve për vetvendosje, etj.

Në të vërtetë, a mund të funksiononte kjo? Ndërkohë që këto akuza shtrojnë disa probleme...

Kështu, përse nuk duhej “tradhtuar” Bashkimi Sovjetik? Në emër të kujt?

Unë i përkas një vendi tjetër, një populli e një shteti tjetër. Përse nuk mund ta tradhëtoja BRSS-në? Çfarë do të më pengonte nëse unë do doja të mbroja interesat e mia, pavarësinë time?

— *Po rrëmbeheni, Ismail Kadare...*

— Përkundrazi, po përpiqem të vendos gjërat në vendin që iu takon, dhe nuk bëhet fjalë për vetëkënaqësi. Kur mendoj për të gjitha këto, nuk e kuptoj pse duhet ta fshihja të vërtetën. Walter Ulbricht-i ishte i pari që sulmoi nga tribuna. Walter Ulbricht-i... Mos ishte më i mirë se Enver Hoxha? Më i drejtë? Lërini këto, Denis Fernandez-Récatala, le të merremi me gjëra më të rëndësishme...

— *Në Dimri i madh/ju paraqisni manifestimin e ndjenjës kombëtare të diktatorit.*

— Nëse do ta përmblihdja dhe transformoja *Dimrin e vetmisë së madhe* në një përrallë zanash, do të shkruaja: “Na ishin njëherë tetëdhjetë e një

vrasës që u mbloodhën në një kështjellë me emrin Kremlin në një qytet që quhej Moskë. Tetëdhjetë nga këta vrasës donin të mundnin të tetëdhjetëenjëtin, edhe ky vrasës si ata e ndoshta nga më të famshmit...” Ky vrasës ishte një aktor, pra një hipokrit, po të nisemi nga greqishtja. Të tjerët ishin ndoshta më të sinqertë, por më pak inteligjentë e të logjikshëm. Ja pse ky vrasës dukej më simpatik se të tjerët. Fjalimi i tij ishte më koherent, më i drejtë se fjalimet e të tjerëve... madje e gjithë Shqipëria e mbështeti këtë fjalim. Edhe unë. Nuk dua ta përjashtoj veten nga kjo mbështetje rrethanore. Romani im përshkruante një veprim me të cilin isha dakord.

— *Kështu ju po i dilni në krah Enver Hoxhës?*

— Mos shtoni nga vetja, ju lutem. Të mos e teprojmë. Romani im doli para... Nëse *Dimri i madh* atij i vinte për shtat, kjo i detyrohet dosjes sekrete. Enver Hoxha ishte një gjëmë për Shqipërinë. Ai krijoi lidhje perverse, kundër natyrës, me Jugosllavinë, Rusinë Sovjetike dhe Kinën. Dy të parat janë armike për vdekje me Shqipërinë, ndërsa e treta është një lloj përbindëshi gjakftohtë.

Krimi më i madh i Enver Hoxhës ishte shkëputja e Shqipërisë nga Evropa perëndimore. Nëse ai do të ishte kthyer me vendosmëri drejt

Evropës, ndoshta rasti i tij mund të rishikohej. Krimet e tjera që ai kreu nuk janë asgjë para këtij.

— *Ju përmendët Kinën, përbindëshin gjakftohtë...*

— Në *Dimrin e madh* nuk e kam përmendur fare, ndërsa te *Koncerti* shkoj dhe më larg. Aty tregoj se si Mao Ce Duni zhduk “pasardhësin” e vet, Lin Biaon. Dhe këtë “Timonieri i Madh” nuk e fshihte. Ai parodizon Macbeth-in: “E vrava Duncan-in sepse ai donte të më vriste.” Solli kështu një variant kinez të tragjedisë së Shakespeare-it.

— *Le të kthehemi tek Enver Hoxha: vazhdoj të mendoj se Dimri i vetmisë së madhe jep një portret të pëlqyeshëm për figurën e tij...*

— Denis Fernandez-Récatala, nganjëherë keni maninë t’i ndërlikoni gjërat. Në Moskë, në një atmosferë të ndyrë e të rrënuar, Enver Hoxha kreu një akt pozitiv, që nga pikëpamja historike ishte i vetmi gjatë sundimit të tij. Mos doni që ta injoroj këtë fakt?

— *Nuk ju kërkoj kaq shumë.*

— *Atëherë, ja kush është bindja ime: ne*

shqiptarët ishim viktima të një gënjeshtre; por nëse Enver Hoxha — dhe këtu po përpiqem të riprodhoj sa më saktë që të jetë e mundur opinionin tonë të asaj kohe, — nëse Enver Hoxha, pra, më 1960, ashtu si dhe më 1970, do të ishte ndarë përfundimisht me botën komuniste nëpërmjet grindjeve që pati me BRSS-në e më pas me Kinën popullore, historia e Shqipërisë moderne do të kishte marrë një fytyrë të re, dhe kjo për të mirën e Hoxhës.

— *Kjo është vetëm një mundësi e pasigurt...*

— Sigurisht, për ata që nuk kanë jetuar në atë kohë. Por, pa më thoni, po për ne? Pranoni ta vini veten në vendin tonë. Enver Hoxha i ishte futur një rrugë e cila ndoshta do të çonte në një afrim me Evropën. Tragjeditë që ndodhën më pas në Shqipëri mund të ishin evituar.

— *Nuk keni frikë se shkuat paska larg me përdorimin e “nëse”-ve?*

— Mbi të gjitha kam frikë se ju nuk ia vini veshin rrethanave e mundësive të asaj kohe. Pati një moment që dalja nga kampi socialist dhe afrimi me Evropën u bënë të mundura. Ndoshta gabohehim, madje sigurisht që kështu ishte. Historia është e mbushur me të tilla iluzione, por janë këto shpresa e iluzione me të cilat ajo del jashtë kursit

të paracaktuar. Kujtoni vargjet e Bajronit: “Ka çaste kur fati ndërron kuajt...” Por çfarëdo që të mendoni ju “tani”, është fakt që Enver Hoxha, gjatë dy periudhave që pasuan prishjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën popullore, ngjalli tek ne një ndjenjë të madhe optimizmi. Të dyja herët, me këto dy romane, por sidomos me *Dimrin e vetimisë së madhe* nxita me sa munda orientimin e ri për të cilin ishim të bindur se do të na çonte drejt brigjeve të Evropës. Nëse Enver Hoxha nuk do të ishte ndalur në mes të kësaj rruge kaq të mbarë, do të kishte zënë një vend më të mirë në Histori. Si përfundim, Enver Hoxha ndërkohë kishte kryer gjysmën e krimeve, askush nuk e harron këtë, e aq më pak unë. Megjithatë besoj se, pikërisht në këto rrethana, edhe do t’ia kishin falur. Ndoshta pjesërisht edhe do të ishte shpërlbyer. Kush e di?

— *Vërtet kështu mendoni?*

— Në një moment të dhënë menduam se kjo ishte e mundur. Ai ishte në gjendje të ndryshonte fatin tonë.

Tronditja ishte e përgjithshme, po, po, e përgjithshme... Njerëzit nuk i zinte gjumi... Ndodheshim përpara një udhëkryqi.

Madje dhe nëpër rrugë — më ndiqni? — formoheshin grupe njerëzish që shkëmbenin

"Kohë" barbare, "Amal" Kërkese

Gato 22.10.2001

Dimri For mardex Recatulo

mendime, nganjëherë me vrazhdësi. Kishte nga ata që i quanin të tjerët reaksionarë; kërkonin që të arrestoheshin e të ekzekutoheshin në publik.

Për disa ishte e paimagjinueshme që të mjaftohej vetëm me shtrimin e problemit. Në horizont po shfaqej Evropa... Përse duhej afrimi me Evropën dhe Perëndimin?

Të tjerë, natyrisht, përpiqeshin të të mbushnin mendjen me mendime të kundërta. Tek Evropa dhe Perëndimi ata shikonin një mjet shpëtimi, një objektiv të natyrshëm. Për ta komunizmi kishte marrë të krisur, pra ishte dërrmuar. Me një fjalë, ishte zhdukur; ishte bërë diçka abstrakte.

Kur Shqipëria humbi çdo shpresë, çdo iluzion se do të pritej me krahë hapur nga Perëndimi, tirania, diktatura u forcua dhe mori trajta barbare. Deri më 1962-64, hera-herës dilte në pah pak liri, e më pas puhiza regëtitëse e ajrit të freskët u shua...

— *Le të kthehemi te shkrimtarët, dhe tek ju në veçanti, a e vështirësoi punën tuaj shuarja e kësaj puhize?*

— Kjo edhe mund të thuhet. Kjo pati pasoja të drejtpërdrejta. Në romanin tim *Dimri i madh* nuk sulmoja diktatorin shqiptar, por sistemin, dhe këtë jua kam shpjeguar dhe më parë. Nuk dua t'i rikthehem kësaj pike por, në dallim nga vendet e tjera komuniste, në Shqipëri publikimi i fakteve

të tilla ishte bërë i mundur dhe kishte shkaktuar debate që nuk ishin zhvilluar gjetiu, si në Bashkimin Sovjetik, ashtu dhe në vendet satelite...

— *Mendoj se tanimë kjo gjë ka ndodhur.*

— Me vonesë... Kjo ndodhi pas grushtit të shtetit të Janevit dhe, në vijim, pas shembjes së BRSS-së dhe sistemit komunist. *Dimri i madh* u botua në Moskë më 1992, me një tirazh të madh (për të cilin, kuptohet, jam i kënaqur), ndërkohë që parathënia vinte përkrah Shqipërinë e vogël dhe Rusinë e madhe të cilat përjetuan një tragjedi të përbashkët, një histori ku të dyja patën rolin e viktimës: totalitarizmi.

— *Le të kthehemi te Shqipëria, nëse nuk keni kundërshtim. Dimri i madh dëshmon për një "liberalizëm" krejt relativ, inisiatori i së cilës u bë Enver Hoxha. Ju e vini këtë në dukje duke trajtuar qëndrimet divergjente brenda partisë komuniste shqiptare, qeverisë shqiptare. Në romanin tuaj shohim Hoxhën të qortojë një nga bashkëpunëtorët e vet. Kjo mund të duket e habitshme po të mendosh se prishja e marrëdhënieve mund ta shtynte, logjikisht, drejt brutalitetit...*

— Ai ishte shumë i zgjuar...

— Ç'doni të thoni?

— E përdorte brutalitetin me një mendje-mprehtësi hipokrite. Që të flasim në përgjithësi, ai gjithashtu “bëri pastrimin”, por duke u kujdesur të fshihej pas figurës së “mësuesit të madh”, intelektualit të madh. Fjalimet e tij ishin plot me shprehje në frëngjisht, me formula latine, me kujtime nga kafenetë pariziane, me citime nga letërsia franceze. Nuk harronte asnjëherë të shpaloste bagazhin e vet...

— *Nuk tregohej finok?*

— Jua thashë dhe më parë: arriti deri aty sa t'i kundërvihej policisë së vet sekrete. Haptazi...

— *Nuk më kujtohet...*

— Mund ta kishit vënë re... Në Dimrin e madh kritikoja policinë sekrete. Zakonisht — dhe kjo është e kuptueshme — ishte e paimagjinueshme ta bëje këtë, sepse policia ishte shtylla e regjimit... Po ç'bëri Hoxha?

— *Ma thoni ju, Ismail Kadare.*

— Dhe po ju përgjigjem, Denis Fernandez-Récatala... Ai denoncoi veprimtarinë e policisë së

tij sekrete për shkaqe demagogjike. Ai u shtir si armiku i shtypjes së instaluar nga ai vetë, dhe këtë e bëri me qëllimin që të dukej si një intelektual i madh që i gjykon faktet me një lloj mospërfillje, nga lart dhe nga larg... Ai e la të lirë, madje e ushqeu zhurmën e zërave kundër policisë së tij sekrete. Ai e bënte këtë herë pas here, e pastaj?

Përfitova nga kjo gjendje dhe i riprodhova fjalët e tij në roman.

Rezultati është gjëja e vetme që më intereson. Njerëzit që kishin dijeni për këtë fakt pyesnin: “Vetë Enver Hoxha është kundër policisë? Epo, kjo ndryshon shumë gjëra...”

Kështu qëndronin punët. Ishte hequr një kapak... dhe u ngritëm, thuajse hapur, kundër kësaj policie të kundërshtuar nga vetë Enver Hoxha...

E nganjëherë ky qëndrim merrte formë gjysmë-zyrtare...

Enver Hoxha ishte objekt iurvejimit nga vetë policia e tij. Kjo binte në sy në fjalët e tij...

E thoshte për t’u mburrur? Për t’u vendosur në një pozicion të rëndomtë si gjithë bashkëqytetarët e vet? Megjithatë, përmes këtyre historive me polici, ai donte të ndikonte në botëkuptimin e njerëzve, ashtu siç prishja e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike solli pasoja të ngjashme në mentalitetin e tyre...

Ja pra, ai ishte një manipulues me stil të lartë, tepër mendjehollë. Duke u shtirur se bënte me faj

policinë e tij e duke mbajtur (në dukje) anën e intelektualëve, ai shkaktoi të çara në sistemin e tij...

Dhe nuk e kuptoj pse, në emër të kujt ne shkrimtarët nuk duhet të nxirrnim përfitimin tonë nga kjo...

Në këtë rast nuk e ushqenim veten me shpresa sepse Hoxha, në të njëjtën kohë, përkujdesej për policinë sekrete dhe e igrinte atë kundër intelektualëve. Gjatë mbledhjeve me këtë polici ai denonconte qëndrimet e intelektualëve...

— *Ju përshkruani një personazh kompleks me pamje shekspiriane...*

— Shekspiriane? Shkuat shumë larg... Krahasimi me Shakespeare-in nuk është shumë i goditur...

Por më lejoni të vazhdoj më tej... Përsa më takon mua, unë duhet të përfitoja nga ky ekuivok, por jo për të krijuar një model personazhi romanesk... Dhe përfshirja e Enver Hoxhës në një roman, si në rastin e *Dimrit të madh*, më dha mundësinë, mes shumë të tjerash, të formuloja në mënyrë objektive një lloj pretence kundër komunizmit dhe regjimit.

Dhe për çudi, ky roman që pati mbështetjen e autoriteteve, u bë njëherësh dhe romani më i urryer prej diktaturës shqiptare. Ishte i tillë në një mënyrë

të ngathët nga gjithë zyrtarët e para së gjithash, kuptohet vetiu, nga policia. Por skematikisht veprohej sikur asgjë s'kishte ndodhur.

— *Në këtë këndvështrim psikologjik, çfarë mendoni për Titon, i cili kishte marrë, shumë kohë më parë se Enver Hoxha, një qëndrim kundërshtues ndaj Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini dhe, për pasojë, ishte përjashtuar nga kampi socialist?*

— Me Titon, megjithëse mund t'ju duket e çuditshme, nuk ndryshoi gjë.

Gjatë një periudhe prej dyzet vjetësh Tito gëzoi pozicionin e tij dhe u miklua nga ky pozicion gjë që, sipas meje, nuk e pengoi të miklonte të tjerët. Mes tij dhe BRSS pati shpesh llastime. Sido që të jetë, marrëdhëniet e tyre ishin si të një çifti të vjetër. Kundërvënia e Titos ishte e përkohshme; zgjati vetëm disa vjet. Më pas ai u pajtua sërish me rusët dhe mund të thuhet — të paktën kështu mendoj unë — që ai ishte aleati më i sigurt i sovjetikëve, më besniku; mjafton të marrësh në konsideratë shërbimet e tij ndaj komunizmit. Po ta shohësh nga jashtë, komunizmi i Titos kishte ngjyra më të ngrohta, më të pranueshme se stalinizmi... Ishte Tito ai që e tërhoqi Botën e Tretë në bashkësinë e vet, në prehrin e komunizmit, ndërkohë... ndërkohë që ai ishte një diktator i

madh i bllokut komunsit. Sigurisht, jo më i madhi, por më i afti...

— *E paraqisnin si më “liberal” se kolegët e vet...*

— “Kolegët”? Të zyrës?

— *Le të themi më mirë të burokracisë, nëse ju pëlqen...*

— E megjithatë ky “liberal i madh” vetë-administrues i mbushi burgjet me mijëra shqiptarë të Kosovës, dhe askush nuk e ngriti zërin, as andej e as këndej kufirit. Më pas i njëjti fenomen ndodhi dhe në Bosnjë...

— *Ismail Kadare, ky ndoshta nuk është i njëjti fenomen. Tito kishte vdekur...*

— Tito kishte vdekur, por kjo nuk ndryshon asgjë. Ngjarjet e Bosnjës tregojnë që fara e krimi ishte mbjellë, dhe ishte mbjellë mirë... lulet e saj — lulet e së keqes, nëse mund të shprehem kështu — çelën...

— *Ju përmendët lëvizjen e papërshtatshmërive që i shërbeu kauzës komuniste. . Por më lejoni, pa kaluar gjithsesi nga një degë në*

tjetrën, t'ju pyes për dallimin që bëni ju mes komunizmit (ashtu siç u praktikua në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Lindjes — e kam fjalën për fenomenin historik, shekullor), dhe “teorisë”, ideve komuniste...

Për ta bërë më të qartë pyetjen, po i referohem Vaclav Havel-it që deklaronte se ideologjia komuniste në një moment të caktuar i shërbeu totalitarizmit... Duke “dëgjuar” këto fjalë kupton apo mund të kuptosh se Havel bën dallimin midis komunizmit ideal, “teorik”, dhe komunizmit real që u instalua qysh prej vitit 1917. E pranoni ju këtë dallim?

— Nuk mund t'ju përgjigjem ndryshe veçse duke theksuar banalitetin e ideologjisë komuniste. Asgjë më tepër...

Kjo ideologji është e njohur, nëse i referohemi historisë, qysh prej kohëve më të vjetra...

E vetmja gjë e re është fakti që komunizmi u realizua, mori formë konkrete dhe zbatimi i tij tërhoqi vëmendjen e qindra, madje mijëra milionë njerëzish...

Marksisi dhe Lenini e morën parasysh këtë ide dhe u përpoqën t'ia përshtatin një periudhe moderne, por komunizmi si ideologji është tepër i varfër, më i varfër se shumë ideologji të tjera, më i varfër se fetë, thuhetse i zhveshur nga kompleksiteti. Shndërrimi i njerëzve të vegjël në

heronj (të lumtur a fatkeqë) të Historisë ka ekzistuar dhe do të vazhdojë të ekzistojë...

Çuditërisht, për një sistem që e mban veten materialist e historik, realiteti i komunizmit risjell frikën e komunizmit si një projekt mesianik...

Qysh prej vitit 1917 nuk mund të bëhet një veçim i formës në të cilën u zhvillua komunizmi, edhe pse, kuptohet, duke ardhur tek pyetja juaj, unë bëj një dallim mes komunizmit “ideal” (që u formua si aspiratë) dhe realizimit të tij konkret...

Në njëfarë mënyre ky lloj komunizmi u “zbulua” ashtu siç erdhi... Dua të them që ai u nxor lakuriq...

— Dëgjoni, ndoshta po marr në mbrojtje një çështje të humbur por, këmbëngul për këtë, mendoj se komunizmi (që ju e cilësoni si banal) e ka bazën në një traditë të vjetër... Eshtë ndoshta ky fakt, kohëzgjatja, qëndrueshmëria e tij si hipotezë, që ju shtyn ta trajtoni në këtë formë; por në Histori duket hapur dëshira për një shoqëri më të drejtë, ose të paktën për një shoqëri ku të ekzistojë barazia e të drejtave...

— Kjo dëshirë është shfaqur qysh para dy mijë vjetësh...

— Ndoshta e keni fjalën për Esenianët që përmenden në Bibël...

— E pranoj, por kjo nuk ndryshon asgjë...
Komunizmi gjendet ngado, jo vetëm në besimet fetare kryesore, por dhe në qarqet e vogla — për të mos thënë sektet, — në tributë e vogla... Shenjat e komunizmit janë të pranishme kudo, dhe kjo më shtyn të mendoj që nuk bëhet fjalë për një novitet me përmasa të mëdha, me gjithë rimodelimet apo përshtatjet moderne që ai pësoi...

— *A qëndron ky novitet në thelbin e zbatimit të komunizmit?*

— Ky novitet qëndron në faktin që komunizmi i dha vetes pushtet dhe u shndërrua në një monstër... ^{si për Leninit} Ky është, tashmë, përkufizimi i këtij komunizmi.

Mendoni vetëm për një çast sikur komunizmi të mos ta kishte marrë në dorë pushtetin, sikur, rastësisht, Lenini të mos ta kishte kryer puçin ushtarak në Rusi dhe bolshevikët të mos ta zgjerorin autoritetin e tyre nëpërmjet terrorit, ç' do të ndodhte atëherë me ideologjinë apo me idealin komunist? E pra! unë mendoj se do të kishte mbetur një ide e varur pezull që do të zhdukej si shumë gjëra të tjera. Apo, në rastin më të mirë, do të mbetej në imagjinatë si një mundësi e vakët...

Kështu, në rastin më të mirë, pa dyshim që ai do të kishte mbetur i dobishëm, si gjithë lëvizjet njerëzore — e theksoj “njerëzore”. Nëse do të shkoja në ekstrem, mund të përfytyroja një

komunizëm pa pushtet...

— *Ky komunizëm hipotetik nuk ju intereson, nuk ju ngjall asnjë ndjenjë?*

— Sigurisht që ai ka vlera që nuk mund të mohohen... Por, nëse duhet të jap opinionin tim për këtë çështje, do të thoja se komunizmi më tepër i ka shërbyer Perëndimit, në sensin që Perëndimi ka shfrytëzuar disa nga këto vlera dhe kundër-modeli i përdorur nga Bashkimi Sovjetik, në njëfarë mënyre, e legjitimoi këtë Perëndim...

— *Ju keni parasysh disa komunistë kundërshtarë të sistemit sovjetik... Ekzistenca e një Bashkimi Sovjetik tiranik për ta ishte një mjet mohimi i ideve komuniste...*

— Mjafton t'i hedhësh një vështrim Kinës në ditët e sotme për të kuptuar marrëveshjen e fshehtë që ekziston mes Perëndimit dhe komunizmit... Kina përdor praktika perëndimore për të qëndruar e lidhur pas komunizmit. Dhe Perëndimi veproi në të njëjtën mënyrë. Ai nxori një përfitim të madh nga komunizmi. Maniakët e mëdhenj të komunizmit, si në fushën politike, ashtu dhe në atë sociale apo ekonomike, janë ata perëndimorë që e kanë zbatuar komunizmin e që, rrjedhimisht, kanë nxjerrë përfitimet e veta. Ndërsa vendet komuniste

devijuan nga rruga që kishin nisur. Shumë shpejt ato i humbën parimet dhe i braktisën vlerat që thuhej se nxisnin këto parime.

E kam fjalën për vlera morale e shpirtërore...

— *Dhe ju vjen keq për këtë?*

— Mjaftohem me një vëzhgim...

un
pu

BISEDA E KATERT

(shtator 1997)

Nga fundi i bisedës së mëparshme Ismail Kadare më kishte folur për problemin e strehimit. Ishte në kërkim të ndonjë apartamenti të përshtatshëm. Më kishte përmendur dy-tri lagje ku do të kishte dëshirë të vendosej nëse do t'i jepej mundësia...

Kështu u fjalosëm për gjeografinë pariziane, një gjeografi letrare dhe e përfytyruar duke qenë se nuk i kalonte kufijtë e Sanit-Germain-des-Prés apo Quartier latin.

Nëse e mbaj mend mirë, arritëm deri aty sa të diskutonim për shumën e preferuar të qerasë...

Për bisedën e katërt caktuam si vendtakim Rostand-in, në rrugën de Médicis, përballë kopshteve të Luxembourg-ut dhe ujëvarës me tritonë që spërkateshin nga uji i cili në dimër kthehej në ngricë e akull.

Ismail Kadare dhe e shoqja, Helena, po më

prisnin në banak.

Mjedisi, si zakonisht, ishte plot e përplot e, për pasojë, ishte e vështirë të punoje...

Kërkuam të uleshim në një tavolinë, por shumë shpejt hoqëm dorë.

Atëherë Ismail Kadare më propozoi të shkonim në apartamentin e tij të ri që ndodhej fare afër, sapo kaloje bulevardin Saint-Michel, duke më kërkuar më parë ndjesë për rrëmujën e shkaktuar nga lyerja që po i bënin apartamentit.


Nuk është e nevojshme të ndalem në hollësira për apartamentin, një apartament me hapësirë, plot dritë, ende i mbuluar me mushama në pjesën më të madhe, me kolona të veshura me mbulesë.

Punëtorët nuk dukeshin; ndoshta në këtë orë ishin larguar. Ishte fund pasditeje.

U ulëm para një tavoline të madhe ku ishin vendosur disa dosje dhe një fjalor. Ndërkohë që po rehatoheshim, Ismail Kadare më bëri të ditur rrethanat në të cilat u mbart në këtë banesë.

Zonja Kadare na solli kafet. Dhe ne u bëmë gati t'i hyjmë bisedës së katërt.

*



DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Ismail Kadare, shpërngulja juaj më e fundit më jep mundësinë, apo më saktë, marifetin për t'ju bërë një pyetje mbi Francën.*

Ju keni jetuar në regjimin e vjetër shqiptar, në regjimin e Enver Hoxhës; nga fundi i këtij regjimi ju jetoni në Francë ku morët dhe nënshtetësinë. Ç'nënkupton marrja e kësaj nënshtetësie? A pati kjo ndonjë vlerë praktike?

ISMAIL KADARE: Së pari më duhet të saktësoj që e kam ruajtur nënshtetësinë shqiptare, që është edhe nënshtetësia ime e parë. Nënshtetësinë franceze e kam zgjedhur si një mundësi të dytë, nëse mund të shprehem kështu. Po përse kjo nënshtetësi e dyfishtë, do të pyesni ju? E pra, mendoj të jetoj dhe për shumë vjet akoma në Francë me qëllim që të mbaroj veprën time të plotë.

— *Preferoni Francën më shumë se Shqipërinë?*

— Po. Dëshiroj ta kaloj jetën time mes Shqipërisë dhe Francës. Por këtu në Francë është e vështirë të jetoj pa pasur dokumenta franceze. E pranoj se ato më kanë sjellë shumë lehtësira...

Duhet të kuptoni që unë nuk mund dhe nuk dua të bëj luftë në dyert e ambasadës për të marrë një vizë kur më duhet (po sjell një shembull të thjeshtë) të jap një konferencë shtypi. E kam pësuar tashmë disa herë...

— *Ju shkoni herë pas here në Shqipëri?*

— Sa më rregullisht që mundem...

— *Keni nostalgji për Tiranën?*

— Nuk kam kohë të kem nostalgji. Në Tiranë unë shkoj shpesh. Aty jeta është e këndshme. Siç mund ta merrni me mend, aty shkoj me kënaqësi të madhe. Madje do të mund të qëndroja dhe më shumë. Por, që të kthehem tek pyetja juaj lidhur me Francën, e kam të vështirë të zhvendosem me një valixhe mbushur me dorëshkrime e dokumenta... Veç kësaj, kur ndodhem në Tiranë, mendjen e kam “gjetiu”... Në Shqipëri jam shumë i kërkuar. Kam një lloj fame. Aty nuk më lënë të punoj.

— *Vendimi juaj për të jetuar në Francë përbën dhe një akt politik?*

— Jo, ju siguroj... Sepse, para së gjithash, Franca, (kuptohet, pas Shqipërisë) është vendi më

i afërt për mua. Në këtë botë të madhe ajo është vërtet atdheu im i dytë.

Në sajë të Francës vepra ime është shpërndarë në të katër cepat e planetit. Duke qenë vendi i parë që m'i hapi dyert, m'u duk e natyrshme të merrja shtetësinë franceze... Kjo gjithashtu bën pjesë në vlerat praktike që përmendët pak më lart, nëse mbahet parasysh që kjo ka të bëjë me ndjenjat që unë provoj për Francën...

— *Ku konsiston afërsia juaj me Francën? Me të ju lidhin evenimentet kulturore? Atmosfera?... Nga ana tjetër, ju banoni në Paris, por Franca nuk është vetëm Parisi, i cili është një qytet i veçantë, për të mos thënë unikal... Vetëm Viktor Hygo e identifikonte Francën me Parisin...*

— Jam dakort me ju, Franca nuk përbëhet vetëm nga Parisi, sepse Parisi e kapërcen Francën; ai është edhe një kryeqytet evropian, dhe unë jam pro Evropës...

— *Doni të thoni se nëpërmjet Parisit, ju shprehni një dëshirë evropiane?*

— Sigurisht!

— *E ndjeni veten evropian?*

— Ndoshta do të habiteni, por kështu është, e ndiej veten evropian.

— *A ka kjo ndonjë domethënie konkrete për ju? Si ka lëshuar rrënjë kjo dëshirë evropiane tek një shqiptar? Megjithëse Shqipëria ndodhet në Evropë, ajo më duket njëkohësisht shumë larg Evropës...*

— Ju lutem të më ndjeni, por mua më duket se kjo ndjenjë është më se e natyrshme. Të ndjehesh ose jo evropian, kjo nuk varet nga pamja e jashtme, nga vitrinat e dyqaneve, nga reklamat e kozmetikës, as nga spektaklet apo koncertet *rock*... Kjo varet nga gjëra më të rëndësishme. Dhe nëse ekziston një cep apo një pjesë e Ballkanit që qëndron larg Evropës, kjo sigurisht që nuk është Shqipëria, ju betohem...

Po jua them troç: për mua të jesh evropian do të thotë të disponosh një moral njerëzor ku të tjerët, të huajt, pranohen me origjinalitetin e tyre. Bëhet fjalë për një histori tepër të gjerë e jo për xhingla e çikërrima apo për hedhje hi syve. Evropa nuk është një skenë *music-hall*-i me stuko e diamantë fals. Tek Evropa unë shoh fytyrën e një njerëzimi me larminë e vet. Kjo është marka (apo vula, si të dëshironi) e saj më thelbësore. Në një farë mënyre gjithë kultura e saj e dëshiron këtë markë, pavarësisht nga tragjeditë e këtij shekulli.

— *Ju hidhni poshtë orenditë e Evropës, aspektet e saj sipërfaqësore, dakord, por ku e vendosni kulturën e saj?*

— Ndoshta do t'ju dukem i prerë, madje barbar. Mendoj se letërsia evropiane aktualisht përfaqëson tetëdhjetë përqind të shtresës më të rëndësishme të trashëgimisë botërore në këtë fushë.

— *Tetëdhjetë përqind? Qenkeni i shpejtë në llogaritje...*

— Më kuptoni drejt. Unë e urrej racizmin dhe ksenofobinë kulturore që nuk është kurrgjë veçse një departament i racizmit. Duke qenë shqiptar, e kam pësuar nga abuzimet e kësaj ksenofobie. Nuk dua të fryj njëfarë rregulli të gjërave duke krijuar hapësira të reja, për shembull kineze, indiane apo afrikane. Sipas meje kontributi i tyre në tërësinë e letërsisë botërore ende nuk është shfaqur. Kjo gjendje është e përkohshme, kjo nuk mund të kundërshtohet. Dhe nuk dyshoj që këto territore janë duke krijuar risi, gjëra të pabotuara, të jashtëzakonshme. Por për momentin...

— *Për momentin?*

— Nuk shikoj të lindin të tjerë Dante, të tjerë Shekspirë, e ca më pak të tjerë Sofoklinj.

— *Ja një deklaratë...*

— ...optimiste. Në fushën e hierarkisë letrare nuk bëj lëshime. Unë nuk bie në asnjë kompromis demagogjik. Po ju flas “profesionalisht”. Nuk jam një “filantrop i Letrave”; letërsia, çfarëdo që thuhet për të, nuk është Ushtri Shpëtimi. Po ju skandalizoj?

— *Nuk dua të jap mendim...*

— Përfundimi: unë ju skandalizoj! Ju nxirrni nga fjalët e mia nuk e di se ‘ç’ profesion përçmimi ndaj një pjese të konsiderueshme të botës. Dhe gaboni! Asgjë nuk është e papërfillshme. Të klasifikosh krijimet nuk do të thotë t’i kalosh në plan të dytë, t’i hedhësh poshtë apo t’i përbuzësh. Unë po pres, pra shpresoj.

— *Kjo shprehja juaj “asgjë nuk është e papërfillshme” çuditërisht më shtyn të mendoj që çdo gjë mund të jetë e papërfillshme...*

— Ju lëvroni paradokse që të lenë pa mend. Atëherë, sikur të shtoja dhe unë që kafenetë dhe bisëdat që bëhen aty sjellin, përmes rrugësh të

tërthorta, vlera ushqyese për letërsinë...

— *As Kina, as India dhe as Afrika nuk janë kafene...*

— Çudi! Ju jetoni në një vend, në një qytet, (Paris), në të cilin kafenetë dhe ekspozitat janë shndërruar në vende krijimtarie. Unë shkruaj me dëshirë në kafene.

— *Ismail Kadare, është radha ime t'ju kujtoj disa nga realitetet tuaja: ju jeni dendur duke pirë në burime folklorike...*

— Folklorike! Dhe pastaj më akuzoni për përçmim... Ju e dini se sa i vlerësoj unë pasuritë mitologjike, thesaret e legjendave popullore, rapsodët, etj.

Nuk dua të bëj paralelizma të pasigurt, por ju gati-gati po më detyroni ta bëj këtë. Nuk mund ta kundërshtoj: unë e respektoj popullin dhe letërsinë që buron prej tij, gjithsesi është fakt që krijimtaria kolektive, e përbashkët, nuk krahasohet me atë individuale, të veçuar. Ndodh që një shkrimtar i vetëm kapërcen dhjetë mijë rapsodë dhe kap majat e letërsisë.

— *Po shmangeni nga tema... Po flisnim për Evropën...*

— Dhe unë u përgjigja që morali dhe etika evropiane nxisin njohjen e të tjerëve, të huajve në origjinalitetin e tyre. Dhe shkrimtari është ky “i huaj”! Ai i përket një komuniteti, sepse komuniteti (apo “tribuja” siç thoshte Mallarmé-ja), kërkon një gjuhë të rreptë, në kufijtë e inkandeshencës, një gjuhë që vetë komuniteti nuk është në gjendje ta krijojë, dhe kjo quhet një kryevepër.

— *Do t'i rikthehemi sërish kësaj pike, nëse nuk keni kundërshtim. Por në veçanti për atë që ka të bëjë me Francën, lidhjet tuaja me të janë vetëm të llojit letrar, apo keni dhe marrëdhënie më personale?*

— Me Francën jam më tepër i lidhur nga pikëpamja profesionale, por, në një lloj këndvështrimi, jam i lidhur në të njëjtën mënyrë me të gjithë botën...

Përsa i përket letërsisë, ajo përbën një fenomen mbarëbotëror. Ajo formon një familje të madhe, e cila përfshin letërsinë franceze, angleze, gjermane, etj.

Nga pikëpamja profesionale nuk kam marrëdhënie të veçanta me letërsinë franceze... Lidhjet e mia me Francën nuk kanë karakter të ngushtë sentimental dhe rastësor...

Franca është i pari vend i huaj që kam njohur dhe dua të shtoj se e gjithë kultura shqiptare dhe

një pjesë e madhe e kulturës së gadishullit notojnë në ujrat e kulturës franceze dhe, para së gjithash, ato janë të lidhura me idealet e Francës.

— *Le të qëndrojmë tek letërsia franceze, nëse nuk keni kundërshtim... Si u njohët me letërsinë franceze bashkëkohore? A i keni ndjekur lëvizjet e saj të pesëdhjetë viteve të fundit? Më thjesht akoma, a keni dijeni për këtë krijimtari?*

— Po, kam dijeni...

— *Po për lëvizjet e fundit të avangardës, për novacionet si Tel Quel...*

— Dëgjoni, unë mendoj se të gjitha këto lëvizje kanë patur rëndësinë e tyre në Francë dhe për Francën, sikundër “Grupi 45” në Gjermani, realizmi i Ri në Spanjë, etj., por, në shkallë botërore, sa më shumë që i largohesh burimit të tyre, aq më pak të ndjeshme janë efektet apo ndikimet e tyre, aq më të zbehta janë rrezatimet e tyre...

— *Ju mendoni që francezët i gënjen mendja kur mburren me lëvizje e sajime të tilla pa ndonjë shtrirje të madhe?*

— Deri më tani të korrat nuk kanë qenë dhe

aq të mbara sa ç'shpresohej. E theksoj “deri më tani”. Rezultatet, ashtu siç duken ndërkohë, kanë qenë njëfarësoj. Si përfundim, them se nuk është ndonjë gjë e madhe. Kjo është përshtypja ime dhe, kuptohet, edhe mund të gabohem... Por çfarë ka mbetur sot nga Romani i Ri? Ja një pyetje me vend...

— *Romani i Ri?*

— Nuk ka sjellë ndonjë gjë bindëse, apo jo?... Gjithësesi më lejoni ta korrigoj mendimin tim: në letërsi nganjëherë përpjekjet që ngjajnë të destinuara për dështim, në vetvete kanë një bukuri, një vlerë, sepse në njëfarë mënyre të tërthortë ato mbështesin të tjera rryma të cilat sjellin edhe frytet e tyre. Dhe nëse mund të bëj një krahasim, do të thoja se jeta artistike e Montparnasse-it në periudhën mes dy luftrave nxitej nga vetë autonomia e tij dhe në vetvete kishte vlera, por për ne që tashmë nuk jemi veçse dëshmitarë të tërthortë, trashëgimtarë të zbehtë të saj...

— *A mund ta saktësoni këtë që thatë?*

— Mund ta bëj pasi ta keni transkriptuar. A mund të bëni durim?

— *Jeni krejt i lirë...*

— Mendoni se me këtë mund të bëj armiq?

— *Aspak! Vetëm se dua të kthehem tek ajo çka thatë mbi letërsinë, tek fakti që ju i bëni asaj një përgjithësim në shkallë botërore dhe nuk merrni parasysh aspektin e saj kombëtar...*

— Shkalla sipërore e letërsisë nuk mund të jetë veçse shkalla botërore. Sa më shumë që zbret hierarkia, aq më rajonale bëhet letërsia... Kur flas për letërsinë, tregoj majat e saj dhe nuk i referohem as shtresave të ndërmjetme, mesatare, dhe as nivelit të saj më elementar që i korrespondon realiteteve rajonale të të gjitha vendeve dhe kombeve. Dhe kur them “botërore”, e kam fjalën për atë që zakonisht emërtohet “letërsi e madhe”. Vetëm në këto sfera të larta të letërsisë mund të hasesh me këtë “familje të madhe” — apo me këtë formacion të madh, nëse do të përdorja një term nga muzika apo gjeologjia, — dhe besoj se kjo “familje e madhe” nuk përfshin detyrimisht atë që, në një moment të caktuar, mund të na duket e pashmangshme, e përkohshme dhe e paqëndrueshme...

Që prej Luftës së Dytë e deri më sot askush nuk mund të thotë se ka zbuluar një Flaubert, një Balzac, një Rimbaud apo një Molière modern...

Askush nuk mund ta krahasojë Sartre-in me

një nga këta romancierë e poetë që sapo citova... Duke patur parasysh që, në këtë sferë të lartë të letërsisë botërore, në këtë Olimp, unë radhis, për shembull, përkrah Kafkës një shkrimtar si Julien Gracq të cilin kam patur fatin ta takoj pasi kishim shkëmbyer disa letra...

Sido që të jetë, për Sartre-in ndoshta është shumë herët të gjykohet...

— *Po për Malraux-në?*

— Edhe për Malraux-në... Sigurisht që ai ka shumë vlera por, nga pikëpamja letrare ashtu si dhe për Sartre-in, duhet pritur vendimi që do të japë shekulli XXI. Nuk do të doja t'ju lëndoja, por përse nuk më pyesni për preferencat e mia?

— *Kur ju pyeta, nuk e kisha fjalën për preferencat e mia. Unë vendos piketa, pika orientimi...*

— Mirë pra, meqë ngulni këmbë, le të themi se, përsa i përket shijeve të mia, përveç Julien Gracq-it, më pëlqejnë Saint-John Perse, Albert Camus, Louis-Ferdinand Céline, Proust... Por jam i sigurt se kam harruar të përmend dhe shumë emra të tjerë.

— *Po Aragon-i?*

— Çfarë t'ju them? Ne — e kam fjalën për shkrimtarët e Lindjes në përgjithësi ku, sigurisht, unë fus edhe veten time, — “ne” jemi në një pozicion të papërshtatshëm për të dhënë një mendim të paanshëm.

Eshtë e njëjta gjë si me politikën... Sipas jush, ç'nënkuptojnë për ne e djathta dhe e majta perëndimore? Për ne e majta ishte e dyshimtë, sepse e mendonim të lidhur me regjimet e vendeve tona, në kundërshtim me të djathtën... Duhet të keni të qartë se idetë tona bazoheshin në kushtëzime konkrete, në faktorë realë; e pra, sipas jush, si mund të na dukej neve Aragon-i?

— *Besoj se mund ta mbyllim këtu parantezën letrare.*

Do të doja të riktheheshim tek Shqipëria, meqenëse, nëse ju kam kuptuar drejt, jeta juaj është ndarë mes Parisit dhe Tiranës. Ç'mendim keni për gjendjen aktuale të vendit tuaj? A ka ende pasoja të regjimit diktatorial?

— Jo, të paktën nuk besoj... Në Shqipëri ekziston opozita, ajo vepron haptaz dhe, ashtu siç i takon, nuk është dakort me qeverinë aktuale.

Madje edhe kur ajo has në vështirësi, nuk bëhet fjalë për ato të mëparshmet, për ato që rridhnin nga mbeturinat e regjimit komunist...

Dalloj gjurmë të regjimit të mëparshëm, por sigurisht që nuk bëhet fjalë për një sistem diktatorial.

— *Këto gjurmë u fshinë pas rënies së gruas së Enver Hoxhës?*

— Sigurisht... Nga ana tjetër, me siguri që e dini se mund të dallosh shenja të diktaturës ngado; madje nganjëherë edhe këtu në Perëndim...

— *Në këtë rast do të na duhej ta prananim se bëhej fjalë për një diktaturë paksa të veçantë...*

— Mendoj për mundësitë që ekzistojnë... Nuk dihet nëse kjo diktaturë e mundshme do të ishte më e thjeshtë ose jo. Ndoshta ajo mund t'i përshtatej modeleve të njohur...

— *Që të qëndrojmë tek Shqipëria. Ç'vend zë Enver Hoxha në historinë e vonshme?*

— Ai është krejtësisht i përjashtuar, i zbrapsur, i mohuar. Më vonë ku i dihet se ç'vend do të zerë?... Siç thuhet, Historia do ta gjykojë. Por nën ç'këndvështrim? Nga ç'pikëpamje? Enver Hoxha ishte një personazh paradoksal; herë-herë ai është shfaqur mjaft ekstravagant e i çuditshëm. Për mua ai duhet gjykuar si një qenie kapriçoze, i

pushtuar nga marrëzia. Ai ishte paranojak. Kjo tashmë është një mënyrë trajtimi, një fillim i trajtimit të kësaj çështjeje. Për ta gjykuar Enver Hoxhën, nuk mund të fshihet fakti që ai ishte paranojak. Kjo është një lloj hyrjeje për të kuptuar personazhin, një skicim i shpjegimit...

— *Sipas jush paranoja është një karakteristikë, një tipar tregues i udhëheqësve komunistë?*

— Udhëheqësve komunistë? Që të gjithë kanë shfaqur shenja paranoje të një shkalle pak a shumë të avancuar. Kemi patur të bëjmë me paranojakë të mëdhenj e të vegjël, mjafton të vëzhgosh qëndrimin, sjelljet e tyre...

Diktatori ynë, Enver Hoxha, ishte diktator i një vendi të vogël, por kjo nuk e pengoi aspak të ishte një paranojak i madh.

— *Paranoja e tij ishte në përpjestim të zhdrejtë me përmasat e Shqipërisë?*

— Të mos i ekzagjerojmë gjërat... Paranojak? Kur unë përdor këtë epitete, kam përshtypjen se po u bëj një nder, sepse, para se të ishin "paranojakë", këta personazhe ishin para së gjithash mediokër, të gërryer nga interesa vocërrake e, përfundimisht, vrastarë. Përsa i takon

të ashtuquajturës “madhështi” të tyre, po përdor fjalë më të butë.

— *Përse? “Madhështia” e tyre nuk i korrespondon gjerësisë së krimeve të tyre?*

— Ku doni të dilni?... Në fakt më hutojnë fjalë të tilla si “gjeniu i madh i së keqes”, “shpirt demoniak”, e dokrra të tjera të këtij lloji. Më hidhëron gjykimi që i bëhet figurës së Stalinit e sidomos një nderim i pamërituar ndaj kësaj figure...

(Heshtje.)

— *Jeni i kënaqur nga Shqipëria aktuale?*

— E si mund të jem i kënaqur. Prisja më tepër; për të kam qenë më optimist se ç’duhej...

Kisha menduar se, në sajë të lirisë së fituar, njerëzit do të bëheshin më fisnikë. Në përgjithësi...

Këtu nuk e kam fjalën për në gjithë Lindjen... Kam përshtypjen se natyra njerëzore është varfëruar edhe më shumë.

Gjatë diktaturës ajo ishte tashmë e varfër... Dhe u varfërua edhe më tepër për arsye që kanë të bëjnë me shtypjen, besoj se e kuptoni... Por, për momentin nuk mund të thuhet se rënia e komunizmit e pasuroi natyrën njerëzore. Për çudi, ndodhi e kundërta.

Kam frikë se, në disa pikëpamje, natyra njerëzore në Evropë e Shtetet e Bashkuara u varfërua dhe kjo varfëri u rrezatua në botën komuniste, të paktën kjo është përshtypja ime.

Në këtë fushë nuk po formuloj ndonjë teori, thjesht po shpreh një ide. Për mua bota varfërohet apo pasurohet në një mënyrë tërësore. Pjesë të veçanta të saj komunikojnë me njëra-tjetrën dhe, në një farë mënyre, ato janë të ndërvarura.

Që të kuptoni më mirë, po qe se dëshironi po ju sjell një metaforë: bota është një kopsht gjigand ku thatësira dhe ujrat zhvendosen nga një vend në tjetrin, ndotin këtë apo atë pjesë të tij, apo përparojnë në këtë apo atë pjesë... Rënia e komunizmit shkretoi gjysmën e botës. Dhe njerëzit që ndodheshin në këtë gjysmë, të prekur e të hidhëruar nga rënia e komunizmit, u mblodhën kruspull, u mpakën...

Mendoj se në këtë fundshekulli natyra njerëzore e shpirtëzimi janë poshtëruar më shumë se më parë...

— *Fundi i komunizmit nuk solli rezultatet e dëshiruara?*

— Kurrsesi... Shikoni, ne jemi të kënaqur deri tani, por nuk jam i sigurt se fundi i komunizmit nuk do të na sjellë telashe të paparashikuara, se në një farë mënyre, nuk do të na marrë me vete,

qoftë edhe pjesërisht...

Duhet dhënë prova të një gjykimi real, të bëhemi të vetëdijshëm...

Për momentin, kemi patur të bëjmë vetëm me një spektakël të ofruar nga mediat, me një informacion në dukje të larmishëm, të bollshëm, të turbullt, masiv... Ç'përfaqëson ky fund komunizmi në formën që paraqitet nga mediat? Eshtë pozitiv? Negativ? Diçka tjetër? Eshtë apo jo i nevojshëm?

— *Doni të thoni që mbiinformacioni ka ndikuar në zgjerimin e të këqijave që ju përmenëdhet?*

— Nuk jam i sigurt se ky agresion audiovizual është diçka e mirë.

— *Domethënë prania e vazhdueshme e mediave sillte çrregullim dhe konfuzion në vend që të pasqyronte me qartësi ngjarjet?...*

— Unë i bëj pyetje vetes, dhe kaq... Megjithatë, nuk do të doja t'i shtyja mediat drejt një ndëshkimi të tepruar. Tek e fundit, qëndrimi i tyre është i ndryshueshëm. Ato janë mirësia dhe ligësia: një gjuhë Ezopi modern. Duhet të marrësh dhe të lësh ato që të interesojnë...

— *Që të qëndrojmë në fushën e mediave (duke e lidhur me hapësirën letrare), çfarë mendoni ju për ndikimin që ushtron televizioni mbi mënyrën e ndërtimit të fabulës, mbi konceptimin e narracionit? E mbi të gjitha, a mendoni se televizioni i imponon letërsisë disa kode?*

— Natyrisht, në fushën e fikSIONIT, televizioni ndikon... Mënyrat e tij të ndërtimit të fabulës e konkurojnë letërsinë. Fabulat e televizionit, narracioni, mbështeten në formula elementare, primitive; dhe këto formula tashmë janë bërë mbizotëruese... Por, duke zbutur këndvështrimin tim, them se televizioni është i ri, në rritje e sipër. Le të presim sa të zhvillohet plotësisht, sa të piqet.

— *A mund të ndodhë që televizioni të jetë shtypës si në rastin e diktaturës?*

— E vështirë ta thuash. Është e njëjta gjë me atë që ndodhi në vendet e Perëndimit, në ndryshim me vendet e kampit socialist ku ishte administrata ajo që e bënte zap letërsinë e madhe, që ia shkurtonte krahët duke ia nënshtruar caqeve politike e kriterëve estetike të një natyre krejt tjetër: realizmit socialist...

Por tek e fundit, përfundimi është po ai... Veprat e shkrimtarëve zëvendësoheshin me biçim librash të shkruar nga palaço, përpiluar nga

politikanë e nganjëherë sharlatanë e batakçinj. Çdokush kishte librin e vet...

Mandej duhet të keni parasysh që palaçot zëvendësuan aktorët, i nxorën ata nga moda e i zbritën prej fronit... Nëse punët do të vazhdojnë të ecin kësisoj, nesër do të na thonë se ministrat, në planin letrar, janë më të vlefshëm se shkrimtarët...

Në më të shumtën e rasteve letërsia, (letërsia e mirëfilltë e kam fjalën), përfaqëson vetëm pesë për qind, (për të mos thënë dy për qind) të veprave të ekspozuara nëpër vitrina. Ndërkohë që “letërsia” (në këtë rast po vendos thonjëzat) e rëndomtë, mediokre, bënte “bujë” e dilte në plan të parë...

— *A gjeni ndonjë mënyrë për t’iu kundërvënë kësaj?*

— Kjo i kalon kompetencat e mia, ju e kuptoni. Dhe është për të ardhur keq. Problemi qëndron në faktin se, me rënien e komunizmit, me të drejtë shpresuam në një tjetër funksionim nga ky që na kishte dënuar me mediokritet. Mund të mendohet që njerëzit ishin të gatshëm t’i ktheheshin përfitimit moral, një përfitimi që e ndrydh individin nga të gjitha vrundujt shpirtërorë. Me pak fjalë, pritej një hop moral, një restaurim i moralit...

— *Eshtë kjo lidhja që bëni mes mediokritetit të mjedisit, letërsisë së ndrydhur dhe fundit të komunizmit?*

— Mund të kuptohet dhe kështu. Mendoni pak për molepsjen...

— *Po ngul këmbë: a bëni ju një lidhje mes gjendjes së tanishme të letërsisë dhe rënies së komunizmit?*

— Pse jo? Rënia e komunizmit shkaktoi një valë egoizmi. Ajo u përjetua si një fitore personale...

— *Prej kujt? Nga çdo individ i shtypur nga regjimet përkatëse në fuqi në vendet e Lindjes?*

— Ajo mbi të gjitha u përjetua si fitore nga kjo anë e ish-perdes së hekurt...

Janë pikërisht përfituesit e mëdhenj materialistë që shpallën triumfin e tyre kur komunizmi u shkatërrua dhe idealizmi i tij u dërrmua nën peshën e praktikave që me gjasë do ta realizonin këtë idealizëm. Këta përfitues besuan tanimë se kishin liri të plotë veprimi...

Ata besonin se kishin të drejtë plotësisht. Dhe dolën në përfundimin se historia e tyre, sistemi

që ata mburrnin ishte më i miri, i vetmi që mund të jetonte e të kishte një të ardhme... Sigurisht, sigurisht, ata mund të krenohen... Eshtë njësoj si të kishin fituar të drejtën morale për të qenë arrogantë.

Nga krimet e kryera nga komunistët në emër të komunizmit ata nxorën dividendë. Dhe klithën: “Ja kush ishte komunizmi!”, ky farë ideali që solli të kundërtën e vet — një kundërshti tmerruese e asaj që duhej të përfitohej (nëse do të ishin respektuar parimet e tij).

— *Ju mendoni që fundi i komunizmit do t’i shndërronte sjelljet e individëve?*

— Pikërisht këtë po ngul këmbë t’ju them... Eshtë për të ardhur keq që disa materialistë vulgarë kanë nxjerrë përfitime dhe nuk u cënuan nga konflikti i madh që tronditi mbarë botën gjatë më shumë se pesëdhjetë vjetëve...

— *A e përfshiu Shqipërinë e ditëve të sotme kjo furi “materialiste”?*

— Jo vetëm Shqipërinë, por dhe gjithë vendet e Lindjes... Gjatë dy-tre vjetëve morali u zvetënuua...

Kam dëgjuar disa persona të pohojnë se do të duhej të bëhej apologjia e parasë, se bëhej fjalë

për një çështje “nderi”. Dhe ne kaluam nga gjuha e akullt e politikës në këtë lavdërim të parasë. Ishim të detyruar të ngrinim në qiell vlerën e parave gjë që, këtu në Francë, nuk ndodhi kurrë...

— *Kjo dalldi për paranë vazhdon ende në Shqipëri?*

— Po! Pas rënies së komunizmit filloi vlerësimi i disa gjërave shumë të parëndësishme... Në shtyp u shfaqën deklaratat të tipit: “E adhuroj paranë”, “Paratë janë gjithçka!”. Dhe kjo vazhdoi për dy-tre vjet... Iu kushtuam sërish kultit të njeriut të pasur.

Në fillim — dhe nuk i rikthehem më këtij momenti — morali u sulmua nga gjëra të llahtarshme... Dëshira për para mbyti çdo dëshirë tjetër...

Dhe këta njerëz që e kërkuan, e brohoritën dhe e ystën paranë, ndiheshin modernë, liberalë. Intelektualë të shquar, (pa harruar këtu dallimet që ekzistonin mes tyre), njerëz që e pandehnin veten të çliruar nga frerët e së kaluarës, i hynë kësaj valleje duke iu gjuhëzuar paragjytimeve të reja.

Ja pse mendoj se bëhet fjalë për një fitore pa vlerë të kësaj pjese të kalbur të njerëzimit. Kjo fitore u shfaq si një shpagim...

— *Ju ishit i pranishëm në rënien e komunizmit, a kujtuat se kjo do të sillte një hap moral, njerëzor?*

— Po, mendoja vërtet se raca njerëzore do të përmirësohej, do të bëhej një “tjetër”, por ndodhi krejt e kundërta. Ajo u shkatërrua edhe më. Për fat të keq...

BISEDA E PESTE

(tetor 1997)

U takuam në apartament...

Për momentin i kemi braktisur kafenetë e sidomos Saint-Claude-in me mjedisin e vet të zhurmshëm.

Lyerja e shtëpisë tashmë ka mbaruar dhe përtokë është shtruar një moket në ngjyrë të çelët.

Fare mirë mund të thuhej që muret në një të bardhë të lehtë formonin një ekran të volitshëm për mendimet...

Para se të fillonim me regjistrimin, u fjalosëm pak për gjëra të ndryshme sa për të hyrë në temë.

E informova Ismail Kadarenë për pikat e bisedës në vijim. I bëra një përmbledhje të bisedës së mëparshme e mandej lidha mikrofonin...

Kësisoj u krijua vetiu një ritual praktik, pa genë e nevojshme që t'i kushtohet vëmendje nga ana jonë.

Ç'të thuash tjetër përveç faktit që Ismail Kadare i nënshtrohet gjithë qejf këtij roli? Ai gjallërohet, qesh shpesh, ia lëshon frerët ligjërimin të zërit të vet, revoltohet, bën hera-herës gjeste e nojma për të shprehur përçmimin apo indiferencën e vet.

Për të transmetuar ndjenjat e veta, ai përdor një koleksion të pasur shprehjesh të cilat shoqërojnë e theksojnë fjalët e tij... Herë-herë ndodh që ai përgjigjet para se të formulohet e gjithë pyetja. Kësisoj ai shfaq një simpati të madhe, nëse nuk bëhet fjalë për të kundërtën...

Interesimi i tij, pavarësisht nga tema e bisedës, është një fakt i pamohueshëm.

E karakterizon gjallëria, një gjallëri që nuk resht veçse në raste të ralla.

Duket sikur ai kërkon pareshtur ta bindë, t'i mbushë mendjen bashkëbiseduesit (që në këtë rast jam unë), për logjikën e vërejtjeve e mendimeve të tij...

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Gjatë bisedës sonë të kaluar përmendëm Shqipërinë dhe etjen për para që është shfaqur aty...*

ISMAIL KADARE: Meqë ra fjala, do të doja të shtoja se disa “shkrimtarë” apo “poetë” nuk ngurrojnë të thurin ode për paranë. Fenomen ky që, në një tjetër kontekst, pa dyshim që do të ishte qesharak, apo jo?

— *Ju më thatë se kjo ju trondit e ndoshta ju hidhëron...*

— E dini, në Shqipëri kam dhënë intervista me qëllim që të dëgjohet edhe violina ime në orkestër, një violinë me tingull të kundërt, kuptohet... Opinionet e mia kanë krijuar një kontrapunkt dëshpërues... Duke shprehur mendimin tim për këtë fenomen të neveritshëm, shpesh kam shkaktuar zemërim... “Si dhe më parë”, më duhet ta theksoj këtë... Megjithë ndryshimet që ka pësuar Shqipëria, herë-herë kam përshtypjen se pozicioni im nuk ka ndryshuar aspak; është po ai pozicioni i kryengritësit kundër “frymës së kohës”

— *A nuk ka njëfarë vetëkënaqësie nga ana juaj kur mbani qëndrime të tilla në kundërshtim me qëndrimin e shumicës?*

— Nuk bëhet fjalë për poza apo gjeste me të cilat të mund të nxjerrësh në pah vlerat e tua... Jo, ju siguroj që bëhet fjalë për gjëra të rëndësishme e të besueshme... Duhet të keni parasysh turbullimin që ka përfshirë Shqipërinë... Duhet të keni parasysh dyshimet, shqetësimin, “novitetin” me të cilin është përballur vendi...

Gjithçka duket se është vënë në pikëpyetje, duke përfshirë këtu dhe rolin e paanshëm të shkrimtarit...

— *Ky rol është vënë në dyshim...*

— E kam fjalën për rolin që patën shkrimtarët në vendet e Lindjes ku, për shembull, ishte e pakonceptueshme që një shkrimtar të mund të ngrihej kundër popullit në tërësi...

— *Po e shtroni tani këtë problem?*

— Eshtë më tepër një pyetje që ma ka bërë një gazetar...

— *Dhe ju këtu dalloni një simptomë të kursit të ri që ka marrë rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri?*

— Më tepër shoh një fakt, përderisa për këtë problem më kanë bërë një pyetje... Në një vend ku, deri dje, në regjimin e vjetër, dukej e pamundur, madje e pakonceptueshme që një shkrimtar të shkonte kundër rrymës dhe të merrte një qëndrim të vendosur kundërshtues; në këtë vend ku roli i paracaktuar i shkrimtarit konsiston në krijimin e lidhjeve shoqërore dhe në paraqitjen e një lloj uniteti... në këtë vend pra, arrin të pyesësh veten nëse “pabesia” nuk është një virtyt, apo të paktën një cilësi e shkrimtarit...

— “Pabesi” ndaj kujt?

— Ja një pyetje me vend... Ndaj kujt, shkrimtari duhet të jetë “besnik” ose “i pabesë”?... Nëse këtë atij ia dikton ndërgjegjja, shkrimtari mund të ngrihet kundër popullit apo, për t’i dhënë një kuptim më solemn, kundër “popullit të gjallë”... Mes këtyre dy pjesëve shkrimtar-popull mund të bëhet divorci...

— *Por ju, Ismail Kadare, keni qenë aktor i këtij divorci që i detyrohet mospajtimit apo shprehjes së mendimeve të kundërta me skemat mbizotëruese të mendimit.*

— Eshtë e vërtetë që jam ndodhur në situata

delikate, dhe pikërisht për këtë ju thashë pak më parë që qëndrimi im ka pësuar ndryshime... Por që t'i rikthehemi problemit të “besnikërisë” e për pasojë dhe “përputhjes”, kujt duhet t'i japë prova besnikërie shkrimtari?

Shkrimtari i përket një mbretërie e cila i bindet tre dimensioneve materiale...

Kjo është pa dyshim e vështirë për t'u shpjeguar, por shkrimtari nuk ka të bëjë vetëm me një “popull të gjallë”, të pranishëm. Ai rrëfen dhe për të vdekurit dhe futet në të ardhmen. Kjo mund të ngjajë me një shabllon, por shkrimtari flet në emër të këtyre tre instancave, thuajse në mbrojtjen e tyre. Dhe nëse ai flet në emër të *një populli*, patjetër që bëhet fjalë për një popull që shtrihet në tre dimensione dhe ai shprehet në emër të të trejave njëherësh...

Shkrimtari e bashkon *kohën e tij* vetëm me të tashmen...

Nga ana tjetër, dua të saktësoj se gjendja kontradiktore ku shkrimtari zhytet hera-herës është vetëm një gjendje e përkohshme... Kjo gjendje vjen kështu vetiu...

— *Me ç'rast? “Kjo” ju ka ndodhur juve kohët e fundit?*

— *Kohët e fundit? Kjo më ka ndodhur lidhur me problemin e atdheut...*

Para dy-tre vjetësh kam mbrojtur një tezë që për shumicën ishte paradoksale. Në vija të trasha deklarova se duhet të përpiqeshim të krijojmë “vërtet” atdheun...

— *Domethënë?*

— Shumë thjesht: na ishte ofruar rasti të “bënim”, të ndërtonim një atdhe sipas dëshirës sonë...

Nuk duhet harruar se jo para shumë kohësh shumë njerëz ishin të gatshëm ta copëtonin Shqipërinë, ta braktisnin... Ata kërkonin zhdukjen e saj... Këtu e kam fjalën për një pjesë të papërfillshme të popullsisë rëndësia e së cilës qëndronte vetëm në zhurmën që arrinte të krijonte. Në të qëndronte forca e saj, nëse mund të shprehem kështu. Këta njerëz të ngjallnin frikë...

— *Në dobi të kujt apo të çfarë ishte zhdukja e Shqipërisë?*

— Në dobi të tyre...

— *Për t’u bashkuar me kë?*

— Këtë nuk e di... Ndoshta këta njerëz donin të bëheshin francezë apo gjermanë... Ndoshta qëllimi i tyre ishte të pranoheshin nga bota

perëndimore...

— *Duke kërkuar zhbërjen e Shqipërisë?*

— Për këtë kam shkruar disa pjesë në formën e një parabole apo më tepër një krahasimi. Dikush i vë flakën shtëpisë së vet duke e kthyer në shkumb e hi. Që atëherë, ai kujton se ka të drejtë të pohojë: “Nuk kam shtëpi. Më strehoni.” Ai thërret për ndihmë...

— *Kjo thirrje për ndihmë shtrihej deri në përmasat e vendit tuaj?*

— Pikërisht. U krijua një sindromë refugjatësh, ndihmash... Dhe njerëz të këtij tipi ishin me mijëra. Njerëz të thjeshtë, por edhe intelektualë. Për një motiv të vështirë për t’u konceptuar, por në të cilin ishte interesi i tyre vetjak, ata donin ta kthenin Shqipërinë në një pronë të vetën ku të rrinin rëndë-rëndë.

— *Ata kërkonin të bëheshin të varur?*

— Po, një marrëzi e kulluar...

— *Ky është mendimi juaj?*

— Pikërisht...

— *Nëse ju kuptova drejt, këta njerëz kërkonin likuidimin e Shqipërisë për të nxjerrë një përfitim personal?*

— Po. Ata mendonin të zhduknin atdheun e tyre për të nxjerrë përfitim. Për ta Shqipëria përbënte një barrë. Për ta pasaporta shqiptare ishte një pengesë. Ata kujtonin me të vërtetë se me zhdukjen e atdheut do të kishin të drejtë të kërkonin dhe të merrnin një pasaportë franceze apo italiane.

Ata arrinin deri aty sa të uronin që Shqipëria të futej në një luftë civile. Kjo do të ishte një arsye e mjaftueshme për të kërkuar strehim politik...

— *Një qëndrim shumë i çuditshëm.*

— Eshtë një gjykim tragjik. E kam përmendur këtë në një nga romanet e mia, *Shkaba*. Heroi plagos shqiponjën që duhet ta transportojë sepse shqiponja, e rraskapitur, nuk mundet dot të vazhdojë më tej. Ai i ngul thikën dhe, duke kryer këtë veprim, ai prek emblemën e atdheut të vet.

— *Për ju, Ismail Kadare, a nuk është kjo një shprehje e dëshpërimit?*

— Ah! jo. Këtu më tepër shoh shprehjen e poshtërsisë, të një paburrërie, një lakmie, babëzie

pa kufij...

Aq sa mund t'ju them se ishin pikërisht më të babëziturit ata që tregoheshin dhe më agresivët.

— *A mos po e teproni pak?*

— E përse duhet ta bëj? Unë jam i trallisur nga qëndrime të tilla, nga shfaqja e një dëshire pa caqe... A nuk ju mjafton kjo?

— *Po... Sigurisht...*

— A e dini, kur jepja intervista, miqtë e mi më paralajmëronin: “Kadare, mos thuaj se ka shpresa për Shqipërinë... Kjo i trazon njerëzit, dhe ata nuk e kanë qejf këtë gjë...”

— *Mendimi juaj i pezmatonte?*

— Pa dyshim, por nuk më bëhej vonë... S'ishin veç disa kriminelë që dëshironin vdekjen e atdheut për motive nga më të ulëtat.

— *Jeni i nxitur nga një ndjenjë e theksuar kombëtare...*

— Nuk e di... Përse “kombëtare”? Përse e cilësoni këtë ndjenjë si “kombëtare”?... Kam përshtypjen se, duke u shprehur në këtë mënyrë,

e bëni më pak të rëndësishme...

Jam i karakterizuar nga një ndjenjë njerëzore, dhe kjo ndjenjë është e vlefshme për të gjitha vendet. Nuk bëhet fjalë për nacionalizëm, të paktën unë jam i bindur për këtë.

Në rajone të ndryshme të botës ka vende ku popullsitë nuk duan të heqin dorë nga toka e të parëve, nga gjuha dhe relievi i tyre... A ka këtu ndonjë gjë anormale? Kjo është jeta e tyre.

Atëherë përse papritmas duhet të heqësh dorë nga territori yt, të shndërrohesh në një endacak, të nisesh një zot e di se ku e se për çfarë, të ribësh Historinë...? Duhet të jesh i çmendur...

Përse shqiptarët duhet të bëhen një komb pa prejardhje? Një sjellje e tillë nuk ka asnjë justifikim. Kësisoj do të binim kokë e këmbë në një katastrofë...

— *Por tashmë ngjarjet në Shqipëri kanë marrë tjetër drejtim. Gjërat po ndryshojnë me shpejtësi...*

— Pa dyshim... Ato po ndryshojnë... Ato tashmë kanë ndryshuar...

— *Aty njerëzit dora-dorës po mësohen me demokracinë...*

— Përditë, sigurisht... Përditë... Por gjithsesi

shumë ngadalë...

Ky mësim për të cilin ju bëni fjalë po ushtrohet nën kontrollin e Evropës. Në Shqipëri janë dërguar specialistë. Ata punojnë, bëjnë raporte, riparojnë difektet... Kështu ata bëjnë një kritikë të menj-ëhershme ndaj regjimit, e kësaj regjimi është i detyruar t'i përulet demokracisë, cilatdo qofshin dëshirat dhe dispozitat e saj...

Dëgjoni, të gjitha vendet ballkanike i qajnë hallet bashkë... Vihen në dukje difektet e Shqipërisë, por nuk bien në sy ato të vendeve fqinjë... A e dini — dhe këtu nuk dua të shtoj nga vetja, — vendet e tjera kufitare janë viktime të psikozave të tmerrshme. Ato madje tregohen edhe më të prapambetura se Shqipëria...

— *Mes këtyre vendeve ju përfshini Greqinë...*

— Më falni, por para së gjithash këtu mendoj për Serbinë... Serbia i është nënshtruar një diktature të llahtarshme, që për më tepër është një diktaturë komuniste... Kush flet për këtë kënd-vështrim të fakteve? Është vendi i fundit në Evropë ku ekziston një diktaturë e këtij lloji... dhe kam përshtypjen se qeveritë perëndimore po sorollaten kundrejt këtij problemi, si dje edhe sot.

— *Situata në ish-Jugosllavi është rrjedhim i rënies së komunizmit...*

— Por nuk është vetëm ish-Jugosllavia që është prekur nga nacionalizmi... Edhe Greqia, që gjoja është një vend perëndimor, është teatri i neurozave nacionaliste, i fushatave të tmerrshme...

Për shumë e shumë vjet qindra mijëra vetë kanë manifestuar armiqësi ndaj fqinjëve të tyre... Në Shqipëri nuk kemi parë asnjëherë fushata të tilla. Këtë mungesë shovinizmi dhe nacionalizmi në Shqipëri unë e kuptoj si një shenjë civilizimi. Mund t'iu përmendësh shumë vese shqiptarëve, por nuk mund t'i akuzosh për këto dy fenomene.

Për shembull, gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit (që ishin vërtet të troshitur nga një liri e shfrenuar), askush nuk e vuri re urtësinë që dëshmoi minoriteti grek e, për këtë arsye, as urtësinë e shumicës shqiptare. Nuk pati asnjë konflikt mes të dy palëve, dhe kjo është domethënëse, apo jo?

— *Në kontekstin ballkanik kjo është mjaft e habitshme.*

— Ajo që më habit mua është se askush nuk e ka vlerësuar plotësisht këtë veçori. Populli shqiptar, i cilësuar si një popull nationalist, nuk lëshoi pe ndaj një manovre që do t'i kundërvihej traditës së tij shumëkulturëshe. Një popull nuk mund të gjykohet duke u nisur nga parrullat e

preferuara të atyre që e udhëheqin.

— *Dëgjoni, Ismail Kadare, populli shqiptar akuzohet për terrorizëm...*

— Kjo është absurde! Shqiptarët nuk janë të dhënë pas terrorizmit dhe nuk vërshojnë drejt teprimeve, ndërkohë që ata kanë një diasporë të strukturuar, të fuqishme, që përbëhet nga miliona vetë të shpërndarë nëpër Evropë, të cilët deri më sot nuk kanë krijuar asnjë shqetësim.

— *Ju pohoni se kritikantët që Evropa iu bën shqiptarëve janë në përpjestim të zhdrejtë me teprimet e vendeve fqinjë e, në të njëjtën kohë, ju mendojnë që Evropa, përmes mediave perëndimore, tregon mosmirënjohje ndaj Shqipërisë dhe, në njëfarë mënyre, asaj i mungon këndvështrimi historik...*

— Kam frikë se njerëzit që reagojnë në mënyrë të ngjashme me disa media perëndimore, më tepër se një mungesë këndvështrimi historik, shfaqin një lloj begenisje. Ata mendojnë për shqiptarët duke u nisur nga paragjykimet, nga modele të nxjerra nga mjedisi i tyre rrethues, parizian apo diçka tjetër. Kur vijnë në Shqipëri, ata hiqen si feudalë dhe, nën pretekstin se vijnë nga Parisi apo Berlini, shpallin botërisht leksionet e tyre... Stolisen me cilësitë e të tjerëve... I trajtojnë

shqiptarët me begenisjeje, dhe pikërisht ndaj kësaj begenisje unë ngre krye. Pyetja e parë që u vjen atyre ndërmend është: “Si mund të jesh shqiptar?” Dhe këtë pyetje nuk e shtrojnë në mënyrë alla Montesquieu, por duke shfaqur përbuzje. Kjo prirje për të shitur mend ka diçka irrituese, tepër irrituese. Për kë e mbajnë veten ata, e mbi të gjitha, për kë i marrin ata njerëz të cilëve iu japin gjoja leksionet e tyre?

— *Ata kujtojnë se Shqipëria është një vend pa Histori?*

Sjellja e tyre është larg njerëzores. Madje më keq: ajo është krejtësisht alogjike. Njerëzit e kësaj sëre nuk na përfillin, pa diskutim. Ata bëjnë pyetje që nxjerrin në pah injorancën e tyre.

— *Për shembull?*

— Për shembull, ata i bashkangjitin dalldisë nacionaliste të Enver Hoxhës faktin që Shqipëria ka si gjuhë një nga gjuhët më origjinale evropiane, një gjuhë shumë të lashtë. Por nuk është Enver Hoxha zbuluesi i këtij fakti. Në këtë pikë ai thjesht përsërit përfundime tashmë të mirënjohura. Kushdo që është sadopak serioz pranon ta pohojë këtë fakt. Nuk do doja të bija në pedantizëm, por më lejoni t’ju sjell dy shembuj mes shumë të tjerësh: më 1695 Gottfried Leibniz botoi një ese

mbi shqiptarët, dhe Franz Bopp, babai i linguitikës së krahasuar, iu fut studimit të kësaj eseje.

Tregojnë vazhdimisht gjëra të pabesueshme. Tregojnë, për shembull, që është Enver Hoxha ai që ka zbuluar origjinën ilire të shqiptarëve. Po kështu dhe për mitin e Skënderbeut: kjo nuk qenkësh veçse një shpikje e komunistëve në përputhje me ideologjinë kombëtare. Nëse në Shqipëri ekzistojnë katër studime për Skënderbeun, kjo nuk është pak.

— *Gjithsesi ai nuk është një figurë e panjohur...*

— Sidomos për Evropën perëndimore! Në të gjitha bibliotekat e kësaj pjese të kontinentit mund të gjesh njëqind herë më tepër se kudo gjetkë (madje deri në Japoni) libra për figurën e tij. Gjatë shumë e shumë shekujsh në Shqipëri ndalohej të përmendej emri i tij.

— *Besoj se e keni fjalën për periudhën e pushtimit otoman.*

— Sigurisht! Otomanët u përpoqën të fshijnë çdo gjurmë të ekzistencës së tij. Ndërsa Evropa dha fuqimisht ndihmesën e vet për të ruajtur praninë e kësaj figure. Në Paris ndodhet një shesh me emrin e tij. Qeveria shqiptare iu kundërvu këtij

fakti dhe s'la gjë pa bërë për ta penguar këtë pagëzim.

— *Si kështu?*

— Për një arsye megallomane: nëse në Paris duhet të kishte një shesh me emrin e një shqiptari, ky duhet të ishte Enver Hoxha. Por ky telash i vogël nuk i heq asnjë presje faktit që Franca duhet t'i bënte nderimet e veta një heroi shqiptar.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Romë ku bashkia ka ngritur një statujë të Skënderbeut po aq të rëndësishme (në mos më tepër) se ajo që ndodhet në Tiranë.

— *Doni të thoni se nëse ekziston një mit i Skënderbeut, kjo i detyrohet më tepër Evropës?*

— Dua të them që Evropa ka dhënë në këtë drejtim një ndihmesë më të madhe se Shqipëria.

— *Sipas jush pra, disa njerëz duan t'i privojnë shqiptarët nga thelbësorja, nga një prej veçorive të tyre?*

— Ata jepen pas një provokimi të vazhdueshëm kundër atdheut. Me një fjalë, ata shkaktojnë acarim...

— *Përfundimisht, ju mendoni se perëndimorët nuk i trajtojnë siç duhet vendet e vogla si Shqipëria?*

— Nuk bëhet fjalë vetëm për perëndimorët. Ata që i përhapin këto gënjeshttra të paimagjinueshme, vulgare e pa asnjë bazë, i përkasin më tepër mediave ballkanike. Dhe kjo pa dyshim vjen nga rivaliteti që ekziston në gjirin e Ballkanit dhe kundërvë kombet ndaj njëri-tjetrit...

— *A ka patur pasoja mbi ju ky rivalitet?*

— Le të themi më mirë se nuk i kam shpëtuar përgjegjësiive indirekte dhe se kam qenë objekt sulmesh të çmendura. Unë kam futur letërsinë shqipe në klubin e letërsive të mëdha evropiane. Kjo me gjasë diku shkakton bezdi, përderisa ajo sjell me vete shkatërrimin e një klisheje.

— *Dhe ju mendoni se në vendet që sapo përmendët ky fakt nuk gëlltitet lehtë?*

— Le të themi se e gëlltisin me vështirësi. Si mundet që një vend i vogël si Shqipëria, një vend i cilësuar (më shpesh se ç' duhet) si i prapambetur, feudal, barbar, pa kulturë, me një fjalë i zhveshur nga çdo gjë, si mundet pra që një vend i vogël të ketë një letërsi të njohur botërisht, ndërkohë që

vetë ata nuk janë në gjendje të shfaqin një letërsi të ngjashme? Eshtë për të thënë: “Të gJORËT.” Ata e përjetojnë keq këtë situatë, sepse e pandehin veten superiorë ndaj shqiptarëve. Ky fakt është kundër logjikës së tyre.

— *Kjo është pikërisht një pyetje që doja t’ju bëja, Ismail Kadare...*

— Kjo është një pyetje të cilës mund t’i përgjigjesha nëse do ta bënit!

Me këtë rast, para së gjithash, dua të ngul këmbë në faktin që paradoksi që ngrita para syve të tyre thyen skemat, shfuqizon shabllonet.

Ekzistenca e një letërsie të përmasave evropiane, e dalë nga një vend i vogël, nga një vend i vlerësuar vazhdimisht më pak se ç’i takon, i trondit visoret mendore. Duket sikur kjo situatë do t’i linte ata në hije...

— *E megjithatë letërsia e madhe nuk është pronë e vendeve të pasura e të zhvilluara...*

— Dakord por, për opinionin vulgar që e gjen rrugën e të shprehurit përmes mediave, kështu është. Për ata — dhe kjo “ata” përfshin kryesisht rivalët ballkanikë —, letërsia detyrimisht duhet të përkojë me njëfarë zhvillimi, përndryshe imazhi që ata duan t’i veshin vetes nuk mundet të

qëndrojë.

— *Nënvlerësimi i kulturës shqiptare përmes sukseseve tuaja do të sillte një epërsi të atdheut të tyre ndaj tuajit?*

— Përsa më përket mua, kjo fare mirë mund të jetë xhelozia.

Xhelozia e tyre shkon deri aty sa disa prej këtyre njerëzve për të cilët ju fola pak më parë nuk kanë hezitur të dërgojnë letra poshtë e lart për të bërë me dije se vepra e Ismail Kadaresë nuk ekziston në vendin e tij të lindjes!

— *Si thatë?*

— Nuk e dinit?

— *Kjo do të thotë se ata ju konsiderojnë si një shkrimtar francez?*

— Jo pikërisht kështu, por si një shkrimtar të botuar në Francë...

— *Ç'qëndrim mbajtën institucionet?*

— Akademia suedeze, për shembull, kërkoi t'i dërgoheshin librat e mi në shqip për të vërtetuar ekzistencën e tyre. Pati një korrespondencë, sigurisht...

— *Dhe si u mbyll kjo çështje?*

— Në një mënyrë të këndshme, gjithsesi, përderisa botuesi im francez më bëri një surprizë të bukur. Ai e përmbloodhi tërësinë e veprave të mia në vëllime...

— *Në gjuhën tuaj tuaj amtare...*

— Po. Sot vepra ime e plotë në shqip ekziston në sajë të botuesit tim francez, Claude Durand. Kësisoj librat e mi nuk janë më të hallakatur. Por ajo që doja të vija në dukje duke përmendur Akademinë suedeze është shtrirja e mashtrimit mbi personin tim; kam qenë një shënjestër brutaliteti...

— *Sigurisht, në mënyrë naive mund të ndaja habinë time me ju... Nga ana tjetër, ajo që më çudit më shumë është gjithë ky teatër objekt i të cilit ju keni qenë — nga e keqja, kuptohet. Por nëse shkrimet tuaja letrare nuk ekzistojnë në gjuhën tuaj tuaj amtare, atëherë kush i paska shkruar e botuar ato që njihen tashmë si veprat tuaja e që përfundimisht ju kanë bërë të njohur?*

— Këtë me të vërtetë që nuk e di... Nuk ka arritur puna deri aty. “Thjesht” është mohuar

ekzistenca ime si autor shqiptar.

Në këtë çështje thelbësor është mashtrimi dhe asgjë tjetër. Dëmi që mund të përftohet... Sigurisht, është një mashtrim vulgar, i lehtë për t'u rrëzuar, por ka dhe gënjeshtër të tjera më të sofistikuara, pra më djallëzore, e që janë po aq absurde sa dhe të parat; ato ngrihen mbi të njëjtat baza.

Për shumë e shumë kohë nuk e kuptoja synimin e këtyre intrigave. Kujtoja se më drejtoheshin vetëm mua. Mund të qeshni... Por këto ishin (për çdo rast) një mënyrë për t'i imponuar heshtje kulturës shqiptare. Hiqem për një viktimë fajshlyese, për një të "persekutuar"; përkundrazi, jam një shkrimtar me fat e prandaj e gjithë kjo më dukej e papërfillshme.

— *Si kështu?*

— Një mënyrë përgënjeshtrimi, mohimi i kulturës... Unë jam një shkrimtar me fat, përderisa fama ime i kalon kufijtë e vendit tim. Këto sulme drejtoheshin kundër kulturës dhe gjuhës së një populli ku bëj pjesë dhe unë, një populli që propaganda e akuzonte për paqëndrueshmëri, madje për një dështim total në këtë fushë. Por nuk ia dolën dot mbanë. Unë isha, në njëfarë mënyre, mishërimi i së kundërtës... Shumë thjesht: shqiptarët akuzoheshin se ishin një popull i pazhvilluar. Ekzistenca ime e rrëzonte këtë klishe.

— *Kjo më kujton çështjen Shollohov. Pasi ai mori çmimin Nobel, u përhapën fjalë se nuk e kishte shkruar ai Donin e qetë...*

— Po, më kujtohet, dhe kjo për të tjera arsye, më personale. Një xheloz i shëmtuar letrare. *Doni i qetë* u quajt si një vepër e një shkrimtari tjetër, nga e njëjta krahinë, por ishte një shkrimtar me më pak rëndësi (besoj) e për më tepër, kishte marrë anën e të bardhëve. Më pas u gjend dorëshkrimi që kishte humbur gjatë luftës...

Çështja u mbyll dhe gjatë disa vjetëve mashtrimi u përhap ngado...

Shollohovi ishte vërtet i dëshpëruar sepse nuk ishte në gjendje të tregonte të kundërtën, të tregonte se ishte ai autori i romanit që e bëri të njohur.

Një Zot e di se sa e ka kërkuar dorëshkrimin e vet! Vdiq pa arritur ta gjente, dhe vetëm dy-tre vjet pas vdekjes së tij e vërteta doli sërish në dritë...

Tepër vonë, sigurisht, tepër vonë...

Përktheu:
Artan Babaramo

BISEDA E GJASHTË

(janar 1998)

Gjithmonë në apartamentin ku është bërë zakon...

Sot, përgjatë hyrjes tonë të zakonit, Ismail Kadareja u ngrit për të gjetur në dhomën ngjitur një vëllim të një enciklopedie dhe Historinë e Ballkanit të Georges Castellan-it, botuar nga Fayard.

Më jep të lexoj një artikull të enciklopedisë që i kushtohej gjuhës shqipe që ai e përktheu nga anglishtja me zë të lartë.

Nuk e di si iu vumë fjalosjes për situatën në ish-Jugosllavi, apo ç'ngjarje e caktuar kish shpënë bisedën tonë në këtë temë. Ishte fundi i luftës në Bosnje, dhe motivet e prekshme për të provokuar një ndryshim ishin të pranishme.

Ismail Kadare më rrëshket punimin e Castellan-it nën sy dhe lexon fragmentin që më shtron

duke ndjekur me gishtin tregues rreshtat. Ai ndalet në disa vende dhe përzien komentet e tij me tekstin. Ai thërret: “E shihni! E shihni!” Në përfundim, shton: “Mbas gati pesëdhjetë vjetësh, serbët mashtrojnë Evropën me historinë e tyre. Ata kanë bërë të besohet se regjimi i tyre ka qenë më demokratik, më liberal se ai të cilit i ishin nënshtruar të tjerat “demokraci popullore”... “Një trimëri...”

Gjatë kësaj kohe, ai qëndronte në këmbë, me trupin e përkulur, me një dorë të mbështetur mbi tryezë...

Përgjatë bisedës, ne do të ndërmendim betejën e Kosovës dhe mashtrimin serb.

*

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Më parë më keni thënë — dhe shpresoj t'i përcjell saktësisht fjalët tuaja — që për ju shkrimtaria përfaqëson një tirani sipërane, e madje nuk ekziston tiran më i madh se shkrimtari. Kjo na shpie te letërsia, në e patëm lënë ndonjëherë. Nga ana tjetër, në çastin e ndarjes, ju më besuat se donit të shkruanit një "libër të vërtetë"...*

ISMAIL KADARE: Kështu ju kam thënë?

— *Po, jashtë regjistrimit...*

— Ju pohoj se s'më kujtohet.

— *Do isha rrekur t'ju përgjigjesha se pak rëndësi ka kjo por, çfarëdo qoftë, ç'është një libër i vërtetë për ju?*

— Pa shkuar më larg, nuk mendoj se i tillë mund të jetë një libër me intervista, nëse ju donit të dëgjoni këtë nga unë...

— *Nuk e prisja këtë lloj përgjigjeje... Për shembull, e për ta kapur çështjen nga një anë tjetër, sërish ajo e tiranisë, a ju imponohet një*

libër?

— Njëfarësoj, po, me përjashtim të brutaritetit... Si t'ju them? Ky rast ka të bëjë me gjëra të ndërlikuara, që mund t'i cilësosh si intime...

— *Nuk do doja t'ju shtyja gjer në llogoren e fundit...*

— Prisni, mos u tregoni i paduruar! Tema është e brishtë... Në fillim fare, kur një libër “vjen”, ju ndjeni një harmoni të brendshme... Elementët e tij të ndryshëm ju duket se lindin në mënyrë të natyrshme. Nuk provoni nevojën e ndryshimit të tyre. Gjithë thellësia apo lartësia e librit shpeshherë ndërtohet vetë. Arkitektura e tij ju shfaqet sikur t'jua kishin “dhuruar”...

— *Libri nuk ka nevojë për ndërhyrje?*

— Nuk them këtë... Them se nuk ndien nevojën e ndërhyrjes së përnjëhershme mbi këtë lloj harmonie të brendshme, harmonie artistike që përfaqëson një libër në lindjen e vet. Të paktën kështu e ndiej unë dhe kjo është pothuaj e pashpjegueshme... Ju jeni përballur me një makineri mendore përballë së cilës ju thoni me vete: “Ky është një libër”...

— *Ky libër që ju shfaqet, vizionar i të cilit*

jeni ju, është një libër i papërfunduar, që kërkon ndihmën tuaj? Ju nuk shkruani thjesht sikur të ishit i nënshtruar ndaj një diktati të brendshëm?

— Jo, gjërat nuk janë po aq të mrekullueshme, ato nuk rrjedhin po aq magjishëm... Sigurisht që ndërhyj! Sigurisht që unë e ndërtoj! Më duhet prapë të nënvizoj se të shkruash dhe të ndërtosh për mua janë e vetmja dhe e njëjta gjë... Ka, shumë-shumë, faza të ndryshme të së njëjtës ecuri... Por nëse libri shfaqet i harmonishëm gjatë rrjedhës së ndërtimit, ai bëhet akoma më shumë i tillë gjatë të shkruarit... Ai priret pareshtur drejt harmonisë, e kuptoni... Dhe shkrimtaria e vesh si një petk që do t'i rrinte për mrekulli apo së paku që do t'i shkonte... Do të ishte sikur të pajisje me shqisa në kuptimin fizik (me të parit, të prekurit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit), një krijesë njerëzore. Organizmi i tij do merrte jetë, do bëhej i gjallë...

— Megjithatë a e keni idenë e subjektit? Ju bëni një zgjedhje?

— Oh! Kjo ndodh në mënyra të ndryshme... Ne s'kemi punë me një gjedhe që do përsëriste veten në një mënyrë të rëndomtë. Gjithçka varet nëse bëhet fjalë për diçka të atypëratyshme, për diçka që ju prisni të konkretizohet menjëherë ose

jo...

Më së shpeshti, për sa më takon mua, unë i nënshtrhem një përshtypjeje të pazakontë... Më jepet një shenjë, dhe diçka — një ndodhi, një ngjarje — çprangohet, diçka e fshehur thellë në pavetëdije, që do veç të zgjohet e të trupëzohet... Dhe kjo diçka — po themi një ndodhi — ruan ende gjurmët e misterit... Ajo prehet në pavetëdijen tuaj, e thashë, dhe është ende e panjohur...

— *Dhe lind nga një trandje?*

— Në zanafillë të veprës, ka trandje... E vë re që është atje por, e përsëris, pa emër e pa fytyrë...

Ma do mendja se kështu ndodh në më të shumtën e rasteve... Vepra është aty, kjo është e sigurt, ajo shtjellet, dhe, kur e kur, ju e kuptoni që njëra prej pamjeve të saj ju kthen mbrapsht në një shëmbëlltyrë të jashtme, që mund ta njohësh, dhe fytyra e asaj që ende s'mund ta cilësosh si vepër formohet pak nga pak, pothuaj pa e kuptuar, por mbetet e vagullt, e paqartë, dhe kështu është kjo gjë e mjegullt që ju zgjidhni për të bërë me të një vepër, kjo gjë prania e së cilës është saktësuar progresivisht...

Po rrekem në këtë rast t'ju kumtoj diçka gati të papërcaktueshme..

— *Ju thoni se vepra në fillimin e saj është e*

privuar nga titulli, nga emri. Vepra që pritet të bëhet ju imponohet qysh në çastin kur provoni ta emërtoni, duke nisur nga titulli që detyroheni t'i vini?

— Për mendimin tim, titullit i vishet veçse një rëndësi relative. Titulli s'është tjetër veçse një hollësi...

— *Te ju, titulli nuk provokon fillimin e shkrimit?*

— Ndonjëherë, mund të nisë shkrimin. Ai, në njëfarë mënyre, mund të përmbledhë, të përfshijë librin që do të rrjedhë aty. Por në të vërtetë, kjo ndodh shumë rrallë. Në shumicën e rasteve, ai është përfundim logjik i vetë shkrimit, i shkrimtarisë (procesit të të shkruarit)...

— *Dhe fjalia e parë... A luan ajo te ju rolin e pedalit? Një teori e tërë shtjellon këtë temë...*

— Fjalia e parë?

— *Po, fjalia e parë...*

— Nuk e besoj aspak... Shumica e shkrimtarëve — të paktën kështu mendoj unë — e ndryshojnë shumë herë fjalinë e parë... Ata

kërkojnë tonin e duhur; dhe ndodh po kështu për fjalitë e fundit, që në sytë e mi marrin rëndësinë më të madhe. Këmbëngul: më të rëndësishme se të parat... epilogu i librit merr ku e ku më shumë rëndësi se fillimi. Shí falë tij, libri fiton gjithë peshën e vet. Është e rëndomtë ta thuash, por fundi i jep gjithë përmbajtjen librit...

— *Një domethënie të fundme apo gjithë domethënie?*

— Është si në jetën e njeriut, as më shumë as më pak. Fundi i ekzistencës është më mbresëlënës se fillimi. Fillimi i ngjan një dokrrë, një marrnie. Ne të gjithë ia nisim duke qenë idiotë...

— *Dhe ju mendoni se fundet njerëzore, të jetës njerëzore, janë më të bukur?*

— Po, për mua ato dhurojnë më tepër brendi...

— *Më tepër kuptim?*

— Sigurisht...

— *Në Francë, e besoj edhe në Evropë, në vitet '60 dhe '70 u pa si u përhapën teori letrare të prejardhura nga strukturalizmi — Jakobson-i, shkolla e Pragës, etj. — apo nga gramatika e*

Noam Chomsky-t. Ç'statuti i mbaheni ju për teorinë letrare?

— Do të isha orvatur t'ju përgjigjesha “asnjë statuti” përse i përket krijimit letrar si të tillë. Ju e dini, këto punët e teorisë letrare janë të lidhura më së shpeshti me amatorizmin. Më thoni: “Ç’përfaqëson për shembull strukturalizmi për një krijues, për një autor?” Sado e çuditshme që mund t’ju duket, unë do mund t’ju përgjigjesha: “Asgjë. S’ka të bëjë fare me krijimtarinë.” Procesi i krijimit është diç tjetër që nuk katandiset në një algjebër, në aksioma...

— *Ju po hidhni poshtë teoritë? Ju mendoni se teoritë letrare janë njëfarësoj kotësie?*

— Në këtë fushë, përgjigjem për vete dhe vetëm për vete... Unë s’i jam përrulur kurrë ndonjë teorie. Koncepti im për letërsinë nuk i bindet ndonjë sistemi të çfarëdoshëm që, veç të tjerash, e shpërfill. Madje, as e kritikoj një sistem të tillë...

— *Stili juaj, estetika juaj u përgjigjen një vullneti, një vendimi që ju keni marrë? A mendoni se shkruhet pafajnisht për to?*

— Kush e di? Për mua, të shkruash është e natyrshme ose, po korrigjoj, mund të jetë e

natyrshme. Në fakt, çdo shkrimtar ka metodën e vet, por nuk e besoj që një shkrimtar mund të ketë mësuar ndonjëherë të shkruajë...

Po përparoj me kujdes: është e mundur që teorisë t'i interesojnë shkrimtarët, por në këtë rast ajo është interesante veçse për të tjerët, jo për mua...

— Ju nuk mendoni se shkrimtari — për të folur me terma të gjinisë — nxjerr atë çka është konkrete nga një teori?

— Në të vërtetë, e meqë ju po këmbëngulni kaq shumë, asnjëherë... Në fakt, unë nuk e besoj që një shkrimtar “normal” të merret me këtë, qoftë edhe një ditë të vetme të jetës së tij prej shkrimtari.

Që teoria të jetë e rëndësishme për të si për një lexues, këtu s'ka asgjë të keqe. Që leximi i studimeve që ka të bëjë me veprat i sjell nganjëherë kënaqësi, kjo merret me mend. Që ai nxjerr nga ky lexim një përfitim, që mbledh në iu dashtë diçka që i hyn në punë, kjo kuptohet. Por “përpara”, në atë kusht paraprak që do përbënte shkrimtarinë, ai s'mendon aspak të zbatojë apo të ilustrojë ndonjë teori. Nuk mundet dot, sepse nuk është e natyrshme... Një shkrimtar “punon” në një lloj pafajnie dhe nëse do e ndryshonte këtë ecuri, këtë do ta bënte duke dhunuar natyrën e tij. Kjo është e pamundur, kuptomëni, dhe s'do të thotë

që ju të mos meditonit për format që një subjekt do huazojë, por duhet gjithashtu të llogaritësh dhe format që subjekti kërkon kur ai nuk i imponon ato...

— *Do mund të më jepnit një shembull?*

— Një shembull? Ta zëmë se ju mendonit për një subjekt dramatik, se diçka tepër e ankthshme ju përshkon mendjen. Në një mënyrë a në një tjetër, subjekti në fjalë sjell me vete forma, dukje, shëmbëlltyra, dua të them forma të përafërta... Dhe ç'ndodh vallë? Ju vëzhgoni dhe doni të ndërhyni. Ju thoni me vete: "Ja, do përdor këtë truk", por ai truk për të cilin ju ëndërronit atëherë nuk i përgjigjet akoma një norme, një modeli të vendosur. Keni të bëni me diç të padëgjuar...

Ja përse unë nuk kuptoj se si të tjerë gjejnë përnjëherësh termat që do vizatonin këto figura të reja, terma të nxjerra nga nuk di ç' repertor. Këto terma, apo kjo tërësi termash, gjenden tepër larg asaj çka ndiej unë vetë.

Kjo terminologji e mbledhur me këtë rast është në përgjithësi e padobishme, e paefektshme, nëse dëshironi...

— *Megjithatë, nuk është kjo përshtypja që të japin librat tuaj...*

— Le ta pranojmë, por kjo është një pamje *a posteriori*... Përgjigjia ime s'po ju kënaq?

— *S'është atje puna! Shekulli, si të thuash, ka derdhur teori, dhe jam thjesht i habitur që ju s'keni patur vramendje për to.*

— Atëherë, po ju besoj diçka për të cilën kam ngulmuar tashmë, për të ditur se çdo shkrimtar përpunon teorinë e vet, pa shpallur asnjëherë që e ka një të tillë. Shkrimtari nuk varet nga ndonjë skemë e jashtme, e parakuptuar, ai ngjiz laboratorin e vet, zbulon konceptet e veta dhe trajton një praktikë që i përket veç atij e askujt tjetër. Dhe këtë sistem, pak a shumë të trafikuar, të sajuar, ai e merr me vete në varr. Mund të përfytyrojmë se humbja e kësaj trashëgimie individuale të pikëllon. Unë jam i bindur për të kundërtën. Falë kësaj zhdukjeje, letërsia nuk resht së përtërituri. Një laborator i përkalueshëm, i trashëguar, do ta ndëshkonte letërsinë me përsëritje, me ngadhënjimin e rutinës, me vdekjen e sajimit nëpërmjet një marrëveshjeje, një rregullimi të paracaktuar.

— *Pa sistem, për rrjedhojë?*

— Të paktën të mos ketë sistem që mund të kënaqë dëshirën e së panjohurës. Subjekti ju mbërrin në një formë ende të pakryer, të skicuar,

ai merr pjesë në një ligjërim që nuk ekziston, që ngelet ende “i pafutur në repertor”. Ju ndjeni, parashikoni, thoni me vete: “Tani do të veproj kështu apo ashtu”, sepse ju nuk jeni i privuar nga çdo përvojë. Por nuk mundem të shpjegoj as si, as pse e me ç’magji prodhohet kjo...

Gjendem në një pritje... Përpiqem të njoh dhe veproj duke u përpjekur: “Ah! Pa shiko, do mund të ecte kjo”. Po aq mirë qëllon që “kjo” — zgjidhja që i propozoj vetes — nuk vihet në përdorim...

E pastaj a nuk ju duket se shkrimtari mbart një barrë tashmë, mjaft të rëndë pa iu dashur të mbajë *akoma më tepër* një “peshë teorike”? Ai përball gjuhën, letërsinë që e paraprin, kulturën... Ai i merr në ngarkim qysh kur nis të shkruajë, atëherë përse vallë të pranonte një teori, një paragjykim tjetër?

— *Nëse më lejoni, Ismail Kadare, do doja të harronim për një çast “tiraninë” e subjektit dhe formave të tij, një “tirani” mbi të gjitha inferiore, më e jashtme se ajo e angazhimit të shkrimtarit. Prejardhja juaj është nga një vend i nënshtruar një regjimi që kërkonte nga shkrimtarët e vet një angazhim politik, ideologjik apo social. Këtë angazhim, në një mënyrë a në një tjetër, ju e keni nënshkruar?*

— Me “nënshkruar”, doni të thoni “pranuar”?

— *Po.*

— Dëgjoni, ju i keni lexuar librat e mi? Epo mirë! Unë nuk e besoj që këta libra vuajnë prej cilitdo angazhim, sikurse nuk mendoj që asnjë pjesëmarrje të mos i ketë dëmtuar.

Kam jetuar nën regjimin e shkaqeve të rreme dhe, për rrjedhojë, në disa keqkuptime të provokuara nga këto shkaqe të rreme.

Ndoshta — po them ndoshta — merrej me mend se mua më takonin disa detyrime. Ndoshta... Por, në të vërtetë, gjithçka ndodhte sikur ju duhet thjesht t'u bindeshit rregullave të mirësjelljes. Bëhej fjalë më pak të bëje një akt detyrimi (bindjeje ndaj shtetit) sesa të respektoje rregullat e mirësjelljes. Më kujtohet se ne jetonim nën një regjim të veçantë. Atëherë, ta zëmë se ju jeni "i ftuari" i një mbledhjeje të cilës s'do të mund të bishtnonit: ju përshëndesni gjithë njerëzit se s'keni si bëni ndryshe. Kështu ia hidhni, por kjo s'shkon më larg; ndjeheni *i detyruar*.

— *Dhe ndodh e njëjta gjë për shkrimtarinë, për letërsinë?*

— Po... Le të themi se askush s'do të shpallte me zë të lartë që shkrimi i tij nuk pajtohej me ligjet e realizmit socialist. Kjo do të bënte që ai të merrte

fund, sepse të deklarosh diçka të tillë publikisht qe një mënyrë detyrimi të hiqje dorë nga çdo bashkëjetesë...

Në të vërtetë, gjithë kjo — dogma e angazhimit në këtë rast — ishte qesharake. Shkrimtaria e vërtetë — dhe, më tej akoma, shkrimtarët e vërtetë — nuk e merrnin seriozisht atë. Është e qartë se ndodhte krejt ndryshe për shkrimtarët mediokër, ata të rendit të dytë, që pretendonin se s'mund të shkruanin ndryshe.

— *Ata e linin veten në atmosferën rrethuese?*

— Nuk e di... Disa përshtateshin, të tjerë ishin të vetëkënaqur, ka mundësi, por unë nuk kam ndërmend t'u hedh gurë atyre.

— *Po përse?*

— Pikërisht për faktin e mediokritetit të tyre. S'rri dot pa menduar se mediokrët, në lëmin e letërsisë dhe artit, ushtrojnë një funksion të nevojshëm, pothuaj shpëtimtar.

— *Po më tej, Ismail Kadare?*

— Me trupin e tyre mbrojtës, sigurisht, ata formojnë një trampolinë për letërsinë e madhe. Me prodhimet e tyre pa hapësirë, ata themelojnë

një lloj abetareje, një manual elementar për lexuesit që nuk dinë të çmojnë përnjëherësh struktura komplekse. Nga ky këndvështrim, do ishte koha të shpallnim një elozh për mediokritetin...

— *Për skamjen?*

— Le të kufizohemi te mediokriteti, ju lutem.

— *Skamja e tyre ose mungesa e tyre e mjeshhtërisë a përkon me naivitetin e lexuesit?*

— E një lexuesi në fëmijërinë e tij që, përmes tyre, merrte shije për tekste më të afirmuar, më të përkryer. Këta shkrimtarë mediokër, përsa u takon atyre, do të përhapnin një pedagogji. Ata do ishin shkallë të dobishme për më shumë aftësi të kuptuari që do lejonte afrimin me një letërsi të madhe.

— *Po këta shkrimtarë a ishin të ndërgjegjshëm për bindjen e tyre ndaj sovranit?*

— Po dhe jo... Kini parasysh se, në të shumtën e kohës, nuk ishte faji i tyre. Ata ishin robër të doktrinës në fuqi, të doktrinës zotëruese. Ishte fjala për shkrimtarë të vegjël, si gjithkund në botë. Pjesa më e madhe e shkrimtarëve, kudo ku ndodhen në

planet, më tepër pësojnë sesa marrin iniciativë. Ata enden nëpër moda dhe rryma... Ata janë mediokër, totalisht mediokër... Mund të vajtojmë për këtë, por s'ke ç'i bë. Kam frikë se s'mund të bëhet asgjë... Tek e fundit, mos mendoni se unë jam ëngjëllor. Mediokriteti shpesh i ka dhëmbët e gjatë. Duhet të ruhesh nga mediokrët, të ndeshesh me ta kur rreken të të imponojnë ligjin e tyre, sepse fati i letërsisë së madhe varet prej andej. Ata kanë lindur sidomos në vendet komuniste dhe kjo ndodh, megjithatë, nga pak gjithkund. Ata janë të nevojshëm në ndonjë rast, dhe të rrezikshëm...

— *Letërsia do të ishte një mbretërim i detyrimit?*

— Letërsia e shpërfill demokracinë. Është një luks, dhe nga një pikëpamje, është gjëja më e padobishme e botës. Ajo fort mirë mund të mos ekzistojë fare dhe, kur ekziston, na shfaqet nën shenjat e një dinastie mbretërore. S'e mendoj dot se si mund të ekzistojë ndryshe. Dhe do shkoj akoma më tej: nëse letërsia do të demokratizohej ose, nëse dëshironi, nëse ajo s'do të pranonte hierarkinë e autorëve, s'më mbetet tjetër, veç të jem i sigurt për zhdukjen e saj. Për ta përmbledhur fjalën time, marr guximin të pohoj se letërsia është pikërisht gjëja e fundme në botë që pranon demokratizimin.

— *E megjithatë, një numër shkrimtarësh, shkrimtarësh të mëdhenj, mëtojnë të kundërtën.*

— Që ta mëtojnë është një gjë, por se sa reale është kjo, kjo është diçka tjetër. Kur unë përmend demokratizimin, e përdor këtë fjalë në kuptimin e barazimit.

— *Pra në një kuptim shumë të ngushtë, Ismail Kadare?*

— Po, nëse doni... dua të them se letërsia — krijimi i saj, për pasojë — nuk është në nivelin e përgjithshëm; një gjë e aq. Shumica e shkrimtarëve, apo të ashtuquajtur të tillë, nuk janë shkrimtarë. Ky është një paradoks. Ata “përdorin” shkrimtarinë, ata nuk shpikin... Nëse ma lejoni këtë formulë, ata besojnë se janë depozitarë. Ata administrojnë një fond tregtie, po doni ta themi kështu. Ata botojnë libra, dakord, tamam si krijues, por krijuesit në të vërtetë nuk përfaqësojnë veçse një përqindje të brishtë të tërësisë së formuar nga shkrimtarët. Le të themi se disa krijojnë vërtet në kohën kur të tjerët përsëritin, kur ata nuk dërdëllitin...

— *Me qëllim bërjen e dallimit midis atyre që krijojnë, “shkruajnë”, dhe atyre që përpilojnë,*

Roland Barthes-i fliste për “shkrimtarë” dhe “shkarrashkrues”...

— Për mendimin tim, parapëlqej të përdor fjalën krijimtar. Krijimtari është i rrallë dhe ai përballon një objekt, një instancë që i është e vështirë ta arrestojë... Ju e dini zanatçinjtë e shkrimtarisë nuk gabohen. Ata e kuptojnë menjëherë kur një sivëlla i tyre i përket ose jo kategorisë së krijimtarëve, apo kur është veçse një epigon që përsërit të njëjtën gjë dhe fabrikon...

— *Me një fjalë, ju nuk besoni tek angazhimi?*

— Besoj sidomos te mosangazhimi.

— *Ju po i bishtnoni përgjigjes.*

— Nuk e mendoj vërtet këtë. Kam krijuar një ide të caktuar për letërsinë, e pëlqyeshme ose jo, dhe nëse ka angazhim nga ana ime, ai duhet kërkuar pikërisht nga kjo anë dhe jo në nuk di ç’përvojë shoqërore dhe politike që do të ishte e jashtme për të, për të mos thënë e huaj. Ka shumë prirje për të thënë se letërsia lind nga jeta. “Nga jeta”... Sa qesharake.

— *Kjo është një ide mjaft e përhapur, qysh prej shumë kohe...*

— Po, është diçka e rëndomtë që nuk shqitet nga mendjet. Nga një anë tjetër, mëtohet se letërsia buron nga bibliotekat, nga bibliotekat borgesiane, pa dyshim?

— *Po ju, Ismail Kadare, ç'mendimi i qëndroni?*

— Për mua marrëdhëniet midis jetës dhe letërsisë janë ku e ku më të ndërlikuara. Letërsia nuk del nga jeta apo nga librat, ajo rrjedh nga *një jetë e caktuar*. Për t'i kuptuar më mirë, po u referohem fillimeve të letërsisë, *Epit të Gilgmeshit* dhe poemave homerike. Ato nuk trajtojnë një jetë të rëndomtë, të përditshme, por një jetë të selitur në marzhet e realitetit, të varur midis qiellit e tokës. Një jetë në zgrip, një jetë që fqinjëron me vdekjen.

— *Ju viheni në mbrojtje të...*

— Unë s'vihem në favor të asgjëje. Po përpiqem, thjesht, t'ju tregoj që tekstet themelore, duke përfshirë pjesën më të madhe të atyre të grupuara në tragjedinë greke, risjellin në mendje një "jetë" fosile, një "të djeshme" të shndërruar në mumje. Ato thonë një "largësi", një fqinjëri, një soj tjetër kohe nga ai me të cilin jemi mësuar.

Po më ndiqni?

— *Po ju dëgjoj, Ismail Kadare.*

— Më vonë, te Dante-ja, Cervantes-i, dhe gjer te Kafka e Joyce-i, ne jemi ndeshur me atë tip “jete” që nuk përfaqëson jetën sikundër kjo rrjedh, por që skicon një jetë specifike.

— *Mos doni të thoni se letërsia zhgënjën realen?*

— Ajo hyn te realja, është një përbërës i reales dhe nuk është kopja e saj. Edhe letërsia e cilësuar si realiste — dhe mendoj në këtë rast për Balzac-un dhe Gogol-in, ndërmjet shumë të tjerëve — edhe kjo lloj letërsie zotëron një forcë të dorës së parë, qenësore, të ardhur nga thellësitë, që e bën të marrë rimëkëmbjen e “reales” dhe i jep asaj një përmasë turbulluese e megjithatë vendimtare. Letërsia nuk imiton jetën: ajo mbushet prej saj, frymëzohet prej saj dhe e tejkalon atë...

Duhet të jesh i verbër për të kufizuar *Shpirtrat e vdekur* të Gogol-it në një pazarllëk të urryer. *Shpirtrat e vdekur* ripërshkruan gjithashtu një udhëtim të djallit që kalon nga Toka në kërkim të të mallkuarve për ferrin e tij... Dhe sa për Don Kishotin e Cervantes-it, nuk duhet kërkuar shprehja e prishjes mendsh prej pleqërisë, por më mirë kërkimi i pezmatuar i parajsës së humbur...

— *Po juua përsëris, marrëdhëniet mes letërsisë e jetës janë debatuar gjerësisht, ky është një fakt...*

— Epo mirë! Unë ju them jo. Është larg së qeni një fakt dhe lidhja e tyre nuk është mekanike. Letërsia i përmbahet një qëndrimi të dyzuar ndaj jetës: ajo ka nevojë për të e, njëkohësisht, ka frikë prej saj. Nuk është një rastësi që, para një shekulli e gjysmë Schiller-i paraqiti, duke studiuar tragjedinë greke, nevojshmërinë e ngritjes së një muri mbrojtës mes letërsisë dhe — për t'i rënë shkurt — turmave. Nëse kjo digë do të shembej, letërsia s'do të qe më veçse një peizazh i përmbytur, një syprinë poshtë së cilës shenjat dhe imazhet do mbeteshin të përpira...

Shihni ç'ndodhi në Kinë: gjatë revolucionit kulturor, diga u rrëzua. Përfundimi: letërsia u bë thellësisht e panatyrshme; ajo, si të thuash, u zhduk...

— *Ismail Kadare, kam përshtypjen se i "rrëshqitët" çështjes së angazhimit...*

— Nuk ju pëlqen përgjigjja ime? Le ta pranojmë. Unë jam i angazhuar. Si shkrimtar, mund të jesh i tillë pa sajuar sidoqoftë një doktrinë për këtë çështje. Por ç'ndryshon kjo për shkrimtarin? Ç'ndryshon kjo pra, ma thoni?

Angazhimi — angazhimi i tij — nuk përfaqëson veçse një pjesë të parëndësishme të shkrimtarit ballë atij mekanizmi të ndërlikuar që është krijimi. Angazhimi, ju e përmendët vetë, prek periferinë e aktit krijues — fundin e tij të brendshëm në një farë mënyre... Raportet mes angazhimit dhe krijimit janë të barazvlefshme me marrëdhëniet e brendësisë me jashtësinë, e rrethanores me një lloj qëndrueshmërie: krijimi është përherë atje, ai mbetet i thadruar brenda jush.

Ç’ë karakterizon forcën dhe pushtetin e artit? Fakti se ato nuk kufizohen në vlerat e zakonta, ato i arratisen rregullit të pranuar në mënyrë të përgjithshme. Arti na kapërcen. Ai fort mirë mund të gjendet “sipër” atij që e ushtron, sikundër përtej së mirës e së keqes. Përkufizimi i tij është i pakapshëm. Shkurt, edhe po të angazhohemi në një çështje fisnike, edhe po të duam të çojmë një kryqëzatë në mbrojtje të tij, është përherë veç një sasi e pamjaftueshme e artit që simbolizon, një sasi sipërfaqësore, pranëndenjese, e ndërshtënë...

Vetëm krijimi i vërtetë qëndron përgjithmonë i pavarur në thellësitë e tij.

— *Për pasojë, në këtë konfigurim, dhe është radha ime t’ju citoj, angazhimi i vërtetë për një shkrimtar është arti si i tillë, që së fundmi, i shërben atij.*

— Në fakt, këtë po bëja çmos të thosha... Për një shkrimtar, angazhimi kryesor është krijimi i tij. Nëse ai krijon çfarëdo qoftë, ai e bën këtë në dobi të planetit, në përfitim të racës njerëzore. Ja, pra ku vendoset, besoj, angazhimi i tij më radikal, ai, për të cilin shkrimtari merr qëndrim.

— *Po format e tjera të angazhimit?*

— Angazhimet që ngjajnë më konkrete, më të dukshme e që kanë të bëjnë me numrin më të madh të njerëzve? Le të themi se ato burojnë nga mirësjellja. Mos shihni aty zemërgjerësi prej krenari, as përçmim. Ka shkaqe fisnike që ia vlejné të vonohesh dhe madje të mundohesh për to; unë nuk jam nga ata shkrimtarë që i shpërfillin apo që mendojnë se “të mëdhenjtë” e letërsisë apo të shkrimtarisë duhet t’u qëndrojnë larg...

— *A s’është kontradiktore me atë që sapo thatë?*

— Jo, nëse bëjmë hierarkinë e vlerave. Unë e relativizoj angazhimin në lëmin e krijimit, as më shumë as më pak. E theksoj, një shkrimtar sado i madh qoftë, është një krijesë njerëzore, dhe asgjë njerëzore nuk është e huaj për të. Ai mundet, pra, të angazhohet në çdo lloj misioni, të shprehet në favor të idealeve të ndryshëm për aq sa aderon në

to, por kam frikë se, nëse e vendos këtë angazhim të jashtëm në krijim më lart se vetë krijimi, ai i humb cilësitë e tij, ose, madje, ai humbet krejt.

Konkretisht, ai është i pajisur me mjete për t' u angazhuar — politikisht, ideologjikisht, shoqërisht — pa u vënë në rrezik, pa e vënë veprën e vet në rrezik.

— *Duke u vendosur në këtë perspektivë, a do mundnit të më jepnit shembullin e një shkrimtari të angazhuar që të ketë shpëtuar artin e tij?*

— Po, sigurisht, e madje pa folur për shkrimtar të madh. Në këtë rast, mund t'ju përmend një shkrimtar realist socialist nëse kjo gjë ju argëton. Pa i arritur dot lartësitë e dëshiruara, bëhet fjalë megjithatë për një shkrimtar serioz, tipik për estetikën së cilës i është kushtuar: Aleksandër Fadajevin. Nuk di nëse e njihni apo jo. Po? Kur Fadajevi ishte i ri, shkroi një roman që m' u duk tepër interesant. Në rusisht ai titullohej *Razgrom*, që do të thotë *Shpartallimi*.

— *Ky është titulli i tij në frëngjisht.*

— Shumë mirë! *Shpartallimi* është një roman i mirë, shumë i mirë ndoshta, shumë “i natyrshëm” sepse, në kohën e përpilimit të tij, angazhimi i Fadajevit ishte i dorës së dytë krahasuar me

shkrimtarinë në vetvete.

Nuk pohoj se Fadajevi s'do kish dashur të shkruante një roman pozitiv, në lidhje me revolucionin, por përfundimi kish qenë krejt ndryshe nga një shpallje politike.

Është një roman ku nuk kuptohet se anën e kujt mban autori sepse, e përsëris, ai është “i natyrshëm”, shí këtë unë quaj krijim të vërtetë, kur një vepër nuk është shtrënguar paraprakisht, që ajo të dalë jashtë caqeve të paragjykimeve të huaja në art, në krijimtari...

— *Unë nuk kam këtë mendim për Shpartallimin.*

— Në fakt të ndjell kureshtjen, por ky roman kundërshton klishetë dhe stereotipet në fuqi të epokës.

Aty nuk i thuren lavde një trimërie “të lumtur” dhe i referohem këtu *happy end*-ve pothuajse të detyrueshme të realizmit socialist. Te *Shpartallimi*, Fadajevi përvijon një lloj gjëme të pësuar nga një detashment partizanësh të komanduar, dhe e theksoj këtë përjashtim, nëpërmjet një intelektual çifut, Levinson, i cili nuk u shty kah barbaria që, në rast nevoje, do të kishte mundur ta shpëtonte...

— *Fadajevin e kapi pasoja e...*

— Më vonë, ai shkroi gjëra të tmerrshme. Realizmi socialist ia zuri frymën. Aty ai humbi trup e shpirt, dhe mund të themi të njëjtat fjalë për Mihail Shollohovin. Sidoqoftë, vështroni *Donin e qetë*, është një roman i vërtetë, dhe jo një manual propagande. Një roman, veç këtyre, shumë pak i angazhuar...

— *Veç të tjerash, është ajo që ia përmend Brecht-i, i cili vë në dukje se Shollohovi mëkaton nëpërmjet një mungese realizmi.*

— Ah! Ky mendim flet në dobi të *Donit të qetë*.

— *Pa dyshim... Në vija të trasha, Brecht-i, që ka bërë realizëm — një realizëm që e cilëson si “kritik” — me estetikën e tij, akuzon Shollohovin madje për mospërmendjen e pagës së fshatarëve që ai vë në skenë.*

— E megjithatë, më thoni pak në ç’roman tjetër më mirë se te *Doni i qetë* mund të njohësh revolucionin, luftën civile, lindjen e Bashkimit Sovjetik? Dhe, për të shkuar më tej, asnjë manual historie nuk jep llogari për atë periudhë aq saktësisht.

— *Mos vallë Solzhenicini?*

— Ecuria e Solzhenicinit është në të kundërt me atë të Shollohovit. Veç kësaj, ai ka qenë një nga armiqtë për vdekje të tij, por, me libër në dorë, kush mund të pohojë që *Rrota e kuqe* është një tablo më besnike se ajo e *Donit të qetë*? Po them më besnike, por do mund të thosha po ashtu më stilistike, më e mrekullueshme apo, fare thjesht, më e çliruar.

Besoj se *Doni i qetë* është më i çliruar dhe shí për këtë romani i Shollohovit e jep më mirë epokën revolucionare.

Solzhenicini është, pa dyshim, një disident i madh, një vigan i lirisë por, nga pikëpamja artistike, paradoksalisht është vepra e Shollohovit që shfaqet si më e çliruar. Po ju habis?

— *Mjaft, po, po, e pohoj...*

— Megjithatë mos kujtoni se jam partizan i Shollohovit. Në jetë, Shollohovi nuk është sprapsur përpara njëfarë ane qesharake. Ai u bashkua me pozita zyrtare, dogmatike, madje shpeshherë staliniste. Nuk më harrohet, meqë ra fjala, letra e tij miratuese për pushtimin e Çekosllovakisë në gusht 1968. Stalini kishte vdekur qysh prej pesëmbëdhjetë vjetësh. S'mund të thuash se frika nga terrori në masë rëndonte mbi të. Por — dhe kjo është një pikë e rëndësishme

— ai kurseu veprën e vet, e bëri këtë në atë mënyrë që e mbrojti nga opinionet e tij...

— *Ju mendoni se arriti ta veçonte nga brutaliteti i bindjeve të veta?*

— Absolutisht. Mund të mos e ketë bërë me dashje, dhe pa dyshim as që e përfytyronte t'u nënshtrohej kanoneve estetike në modë asaj kohe... Kush e di? Më tepër mendoj se Shollohovi ka qenë një shkrimtar naiv, fshatar, domethënë i thjeshtë, dhe ishin natyra e tij si shkrimtar, stili i tij i madh që e shpëtuan, pavarësisht tij...

— *S'keni gjë tjetër për të shtuar?*

— Po! Letërsia sovjetike s'ka lindur *ex nihilo* (nga hiçi). Gjejmë shenja pararendëse të dogmatizmit të saj në letërsinë ruse, dhe si të mos shqetësohesh nga fakti që Leon Tolstoi vlerëson, në mbrëmjen e jetës së tij, që vepra letrare më thelbësore është abetarja për fshatarët...

— *Për ju, ky mendim buron nga demagogjia?*

— Nga demagogjia? Jo, nuk e besoj... Nga moskuptimi, pa dyshim, sidomos po ta ballafaqojmë me sulmet e udhëhequra nga kritikët social-demokratë të shekullit XIX — Bjelinski dhe

shokët e tij — kundër librave të Pushkinit, Dostojevskit dhe Gogolit. Për këta njerëz, shkrintari frëng më i rëndësishëm ishte Eugène Sue, të cilit nuk ia shpërfillim vlerësimin që Marksi dhe Engelsi i kanë rezervuar në *Familjen e Shenjtë*.

— *Me ç'shoh unë ju nuk ngurroni të ktheni të njëjtat armë kundër tyre...*

— Tamam për këtë është fjala. Ç'mendoni për ata kritikë që u mungon finesa e që madje s'ishin as të përciptë në atë që themelonte, në parim, kulturën e tyre? Kuptohet se më mirë do t'u referoheshin atyre nën sistemin stalinian sesa paraardhësve të tyre që, përpos këtyre, nuk e shijonin prestigjin "rus".

— *Duke i dëgjuar, Marksi dhe Engelsi dukeshin gjenialë në gjithçka?*

— Kjo kuptohet vetvetiu, por, në fushën e kritikës letrare, ata hodhën një vel përsipër gjeniut të tyre të mëtuar.

— *Po kujtohem se përsa i përket realizmit socialist, ne nuk folëm për shpikësin e tij: Maksim Gorkin.*

— Kjo është e vërtetë, dhe kemi plot gjëra për të thënë për të. Le të marrim, për shembull, librin *Nëna*, vetë modelin e kësaj letërsie të angazhuar.

Ndërkaq, *Nëna*, dhe kjo harrohet shpesh, nuk u shkrua nën kanosjen e regjimit komunist, dhe autori as që përfitoi çfarëdo qoftë privilegji nga shteti bolshevik. Jo, asgjë nga e gjithë kjo. Në kohën kur Gorki hartonte romanin e tij, pushteti sovjetik nuk ekzistonte. Denis Fernandez-Récatala, a e dini në ç'rrethana u shkrua *Nëna*?

— *E pohoj që nuk e di.*

— Epo mirë! Romani i famshëm i Gorkit u shkrua në 1905-n në New York. Po ju habit?

— *Jo më pak.*

— E gjithë kjo për t'ju thënë se shteti sovjetik s'ka bërë ndonjë gjë të madhe në këtë krijim.

Duke iu referuar këtyre shkrimtarëve të ndryshëm — Fadajevit, Shollohovit, Gorkit, etj. — doja të theksoja se stalinizmi, me estetikën e tij të detyrueshme, nuk e ka shtypur letërsinë: ai ka bindur shkrimtarët ta zvetënojnë *ata vetë*, me duart e tyre. Shí me këtë ka të bëjë gjeniu i tij demoniak.

BISEDA E SHTATË

(prill 1997)

Dekori është i pandryshuar, sikundër ora e takimeve: apartamenti i Ismail Kadaresë, dritaret e të cilit bien nga kopshti i Luksemburgut, në një fund pasditeje.

Ne ecim sipas ritualit tonë. Fjalë të këmbyera mbi kolltuk dhe kanape, përkarshi televizorit të verbër.

Jemi ulur përpara një tryeze të ulët — ku janë stivuar disa libra, si zakonisht. Ndryshojnë veç titujt.

Ismail Kadareja shkon të marrë një shishe ujë pasi më pyeti nëse nuk dëshiroja vërtet gjë tjetër. Më kënaq kjo pije tipike mesdhetare.

Sa kontrollova magnetofonin ia nisëm. Vijuam rreth temës së angazhimit...

*

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Ismail Kadare, nëse, për mendimin tuaj, angazhimi nuk qëndron në letërsi, ai mund të vendoset në jetë në përgjithësi dhe, për shembull, në politikë. Ç'mendoni për zgjedhjet që u zhvilluan kohët e fundit në Shqipëri?*

ISMAIL KADARE: Zhvillimi i tyre, në fakt, të trishton...

— *Vëzhguesit evropianë kërkuar zgjedhje të reja, ju besoj e dini...*

— Kjo është e saktë... U vërejtën parregullsi të cilat e shtynë Parlamentin Evropian t'i drejtojë autoriteteve një kërkesë.

Ç'është nxjerrë përgjatë këtyre zgjedhjeve, të gjykuara drejt si të parregullta? Pa dyshim manipulime...

Problemi konkret me të cilin Shqipëria po përballet sot vjen nga regjimi i vjetër dhe nga një gjendje pasionante. Nga e majta apo e djathta, personeli politik — ajo që me marrëveshje quhet "klasa" politike — vërtetoi caqet e veta; është për të besuar se në këtë rast, urtësia dhe arsyeja iu arratisën shqiptarëve. Pushteti kreu parregullsi dhe

opozita bëri gabime...

— *Ju aludoni për tërheqjen nga listat dy orë para hapjes së kutisë së votimit?*

— Tamam për këtë po aludoja duke folur për gabimet. Dy orë para votimit, ishte e vështirë të parashikoje rezultatet.

Ndershmërisht, mendoj se duhej hequr dorë të paktën njëzet e katër orë përpara. Dua të them se kjo mënyrë ecurie i ngjasonte më shumë një paramendimi sesa një kundërveprimi. Nëse zgjedhjet do të linin vend për dyshime, afërmendsh që ato duheshin denoncuar. Sa për mua, pata përshtypjen e një farse të parapërgatitur...

— *Nga kush, Ismail Kadare?*

— Nga të dyja anët. Kjo situatë dukej se u volitte të gjithëve... Sekush tërhiqte andej një përfitim duke ia hedhur fajin tjetrit.

— *Por cili është qëndrimi juaj karshi kësaj turbullire që e quani të bërë me dashje, Ismail Kadare? Bëhet fjalë për praktika politike...*

— Qëndrimin tim, unë e shpreha një javë më parë. Më e rëndësishmja për mua ishte që populli shqiptar të bënte një provë dinjiteti e pjekurie, të bënte një provë kulture politike, të kontribuonte

për t' i dhënë vendit një imazh të mirë, të një vendi demokratik. Kjo është arsyeja për të cilën votimi duhet të kryhet në mënyrën më të rregullt që mund të jetë. Dhe e bëra këtë shpallje sepse e ndieja që dy partitë po silleshin në mënyrë të urryer. Nga njëra anë, qeveritarët ishin të vendosur të ruanin pushtetin me çdo kusht; nga ana tjetër, opozita uronte ta merrte atë me çdo çmim. Nga të dyja anët kishin përshtatur një qëndrim radikal, sidoqoftë jashtë masës...

— *Opozita është komuniste?*

— Komuniste, në fakt.

— *Përse pranuat të bëni këtë bisedë? Ishte kjo mënyra juaj e angazhimit?*

— Nuk ndjehem i kushtuar ndaj asnjë misioni në veçanti, por nëse zëri im vlen për diçka, do të përfitoj për të formuluar gjëra të ndryshme që janë të rëndësishme për mua.

Së pari: dëshiroja që këto zgjedhje të ishin demokratike, që ato të zhvilloheshin lirisht. Së dyti: unë vlerësoj me një interes mediokër emrin e atij që vendoset në pushtet. E vetmja gjë që më intereson është orientimi i Shqipërisë, ankorimi i saj në Perëndim. Me Lindjen, Shqipëria është gjer në grykë...

Lindja është, për Shqipërinë, më e keqe se për polakët, më e keqe se për çekët, hungarezët, sepse Lindja, për Shqipërinë, është gjithmonë Lindja sovjetike, kineze, Lindja otomane...

E thënë ndryshe, Lindja është një fatkeqësi, një mynxyrë. Gjatë gjithë kohës, kultura shqiptare, aspirata shqiptare rreket t'i këpusë lidhjet me Lindjen.

— *Është kjo një e dhënë historike?*

— Në një farë mënyre... Ju lutem megjithatë të vini re që unë nuk i përdor këto argumente në një perspektivë raciste. Ato janë larg çdo konotacioni ksenofob, por detyrohemi të konstatojmë se Lindja është treguar mizorisht armiqësore ndaj Shqipërisë, e huaj në atë që do mund të quhej dëshira shqiptare.

— *Them se intervista që ju dhatë nuk u kufizua në konsiderata historike, që ju nuk përfituat për të lëshuar opinione rrethanore, madje për të sugjeruar zgjidhje praktike?*

— Nuk mendoj se bëhej fjalë për zgjedhje, por më tepër për një opinion që ka marrë pamjen e një këshille drejtuar komunistëve apo ish-komunistëve. Unë u thashë që marrja e pushtetit ishte e parakohshme.

— *Po pse?*

— Oh! Kjo është e thjeshtë. Komunistët shqiptarë nuk notojnë në të njëjtat ujëra si komunistët çekë, hungarezë apo polakë. “Diktatura klasike autoktone” shqiptare nuk është larguar nga ne veçse prej pesë vjetësh. Nuk ka patur periudhë kalimtare të mjaftueshme midis asaj dhe post-komunizmit, as instancë për ta vulosur zyrtarisht...

— *Sidoqoftë, partia komuniste shqiptare — ose më mirë formacioni politik që e ndjek — nuk kërkon më të kaluarën nga ka lindur...*

— Sigurisht. Dhe është një tingull këmbane që dëgjohej nga pak gjithkund në Lindje, aty ku partitë komuniste pretendojnë se janë reformuar. Nga kjo pikëpamje, partia shqiptare nuk i shpëton rregullit. Sot, komunistët pohojnë se nuk janë komunistë por socialistë. Në fakt, problemi nuk qëndron në ndryshimin e emërimit...

— *Ndryshimet e shpallura nga ish-partitë komuniste ju duken të pamjaftueshme?*

— Sidoqoftë, varet sa të besueshme janë ato... Ish-komunistët nuk vepruan në rrëmujë, në

mënyrë të hallakatur. Ata qëndruan të organizuar në parti, dhe në njërin prej kongreseve të tyre ata vendosën për orientimin e ri të politikës së tyre. Është kjo mënyrë të ecuri që thjesht nuk arriti të mbushte mendjen, dhe me të drejtë: ata nuk e prishën liturgjinë e tyre të zakonit, dhe të gjithë mbërritën në përfundimin se s'kishin të bënin me një rinovim të vërtetë. Ishin vërtet ish-komunistë, ndonëse unë pranoj se duhet zbutur gjykimi i shpallur në lidhje me ta, tablosë së tyre i duhen dhënë ngjyrat karakteristike

— *Ndryshimet që shpallin ish-komunistët do ishin atëherë më të thella?*

— Janë vërtet ish-komunistë me atë që ky term nënkupton si dyvlerësi, dhe s'është më pak e vërtetë që në radhët e tyre numërohen shumë demokratë, njerëz realisht të ndershëm, socialistë të vërtetë, domethënë persona që, shkurt, s'kanë të bëjnë fare me diktaturën staliniste shqiptare...

Por kjo nuk më pengon të gjej veçse një parti drejtuesish që rrjedhin nga aparati i vjetër dhe sillen si aparatçikë. Problemi, meqë ka problem, është që këta drejtues me kthimin e komunistëve në Poloni, në Hungari, në Rumani, në Bullgari e gjetkë bënë një model për Shqipërinë.

— *Pyetja që u vjen në mendje mos është: "Pse*

jo ne?"

— Shkurtimisht, kjo është... Dhe ata as që duan t'ia dinë për dallimin që ekziston mes tyre dhe ish-komunistëve të vendeve të sipërpërmendura... Nuk është nevoja të jesh klerik i madh për të vënë gishtin mbi plagë. Komunistët e vendeve të tjera të Lindjes nuk ishin stalinistë në kuptimin e saktë të fjalës, të paktën, ata s'ishin më të tillë qysh prej tridhjetë vjetësh. Ata, stalinistët e vërtetë, kishin qenë të mënjanuar nga pushteti.

— *Megjithë prishjet me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, komunistët shqiptarë kishin mbetur stalinistë?*

— Nuk mund të thuash të kundërtën. Në të vërtetë, këta ish-komunistë mburreshin me stalinizmin para jo shumë kohësh.

— *Por ata u penduan, i kritikuan veprimet e tyre të kaluara, madje dënuan krimet që kishin kryer...*

— Ja e pranuan, por nuk është kjo që ka rëndësi në sytë e një partie të madhe të popullit shqiptar. Ai që ka rëndësi e që mbetet për momentin i pakapërcyeshëm, është kujtimi i stalinizmit ende të afërt. Janë, gjithashtu, edhe

pasoja njerëzore, kostoja njerëzore e diktaturës së totalitarizmit. Le të marrim për shembull të burgosurit politikë. Në vendet e Lindjes, kishte shumë pak të burgosur politikë ende të gjallë në kohën e rënies së regjimeve komuniste; pjesa më e madhe ishin liruar tridhjetë vjet përpara. Sot, ata janë të moshuar ose të vdekur, ndërsa të burgosurit politikë shqiptarë janë ende të rinj. Nuk është e rrallë të gjesh të burgosur politikë apo të internuar që, deri para pesë vjetësh, pësonin rreptësitë e regjimit në vendet ku ishin. Dhe po të mos ishin veç ata... Mund gati të thuash se ekzistojnë në Shqipëri të burgosur politikë shumë të rinj që kanë vuajtur burgimin e tyre prej një viti, pesë vjetësh, dhjetë a pesëmbëdhjetë vjetësh... Janë me mijëra, dhe shumë më tepër kanë qenë dëshmitarët e asaj periudhe të kobshme; numëroni familjet e tyre... Kujtimi i komunizmit është i vonë, i freskët, i pranishëm në mendjet, dhe tërësia e formuar nga të burgosurit përbën një turmë energjike, të vendosur, të tmerrshme, që nuk e duron dot idenë e një rikthimi të komunistëve në pushtet sot.

— *A mendoni se kjo këshillë e dhënë ish-komunistëve ishte realiste?*

— *Ishte e tillë në atë kuptim që, nëse do ishte respektuar, ajo do të ndihmonte për shtendosjen e*

atmosferës që do të kishte mundur të merrte ngjyrat e luftës civile. Nëse ata do kishin ardhur në pushtet, ish-komunistët s'do kishin mundur të qeverisnin. Vendimet e tyre do të ishin bllokuar në shkallë të ndryshme. Merrni me mend një çast që, për një arsye a për një tjetër, ky pushtet do ishte i detyruar të vraponte në polici, për të shtypur aktet e banditizmit... Epo mirë! Kjo s'do të ishte e mundur sepse ish-të burgosurit politikë s'do ta duronin dot një polici në duart e ish-komunistëve; ata do ta kishin njësuar me atë të regjimit të vjetër. Ndërsa një polici "demokratike" do të durohej ndoshta më shumë...

Këta të burgosur të vjetër përfaqësojnë së fundi një popullatë jo të papërfillshme.

— *Ju do t'i kërkonit ish-komunistëve të vetëvriteshin politikisht...*

— Aspak! Dhe do guxoja të thosha: përkundrazi... Do t'u këshilloja të ishin të duruar, të prisnin të paktën hapësirën e një legjislature, kjo do të ishte për të mjegulluar kujtimin e mbetur tek ata njerëz që pësuan mbi shpinë diktaturën, diktaturën e tyre...

Sado kureshtndjellëse që mund të duket, do të duhej t'u lihej koha këtyre të burgosurve, një kohë e nevojshme për të ndërtuar prapë jetën e tyre për shembull, do të duhej një largësi kohore

me qëllim që të gjykonin gjërat me më pak pasion, t'i kuptonin në u dashtë, dhe kjo kohë e ikur do të kishte shërbyer për ndryshimin e vetë socialistëve, do të kishte ndihmuar për një shndërrim të ngadaltë.

— *A nuk mendoni, Ismail Kadare, se rrethanat u shërbejnë ish-komunistëve? Pa dashur të bëj avokatin e djallit, popullata shqiptare a rron më mirë se më parë?*

— Shumë më mirë se më parë, pa asnjë dyshim...

— *Në përgjithësi?*

— Po pra... Unë po kthehem nga Shqipëria dhe kjo gjë duket sheshit. Më e habitshmja është se janë ata që marrin më shumë të ardhura që qahen. Përse, a mund të ma thoni? Po, për shkak të taksave që, për të cituar veçse tregtarët, nuk duhet të ekzistonin.

— *Nuk trembeni mos ky "anormalitet" është i dëmshëm për Shqipërinë, e për këtë shkak Evropa e mban larg?*

— Ky përjashtim i ri do të ishte fatal për shqiptarët, fatal për dëshirën e tyre të bashkimit

me Evropën, me familjen evropiane. Me këtë nuk duhet luajtur, sepse do të çonte kah një shkurajimi të përgjithshëm.

— *Atëherë, ç'propozoni ju?*

— Se duhet korigjuar Shqipëria, e pranoj, por pa përjashtim. Shqipëria, më duhet ta ndërmend edhe njëherë, ka qenë i vetmi vend i kontinentit i përjashtuar realisht nga Evropa, i braktisur totalisht nga institucionet evropiane...

— *Ju mendoni se Evropa i ka një lloj detyrimi Shqipërisë?*

— Një detyrim, në të vërtetë, që duhet ta udhëheqë me një farë kujdesi kundrejt Shqipërisë, ta tregojë veten ca më shumë tolerante karshi të metave të mëdha të saj.

— *Të meta që janë pasojë e stalinizmit?*

— Pikërisht. Stalinizmi sundoi për shumë kohë në Shqipëri, mizorisht. Kësisoj kundërvëprimi i partisë demokratike, është i kuptueshëm, por jo i pafalshëm.

— *I partisë në pushtet?*

— I ardhur nga e shkuara e afërt e Shqipërisë, pushteti nuk mendonte së paku të kishte të drejtën të tregohej i rreptë me ish-komunistët atëherë kur ishte në gjendje, për të parën herë, të bënte një provë rreptësie në ballafaqimin me ta.

— *Mos qe kjo si çmim i një padrejtësie?*

— Jo, sigurisht, por nuk duhet harruar as që, përgjatë dyzet vjetëve, ish-komunistët kishin qenë xhelatët e popullit shqiptar. Një rast u paraqit dhe kërkuan të përfitonin në favor të fushatës elektorale... U shkua gjer në skaj, është e vërtetë. U tejkaluan caqet. U keqtrajtuan e u rrahën njerëz dhe policia nuk luajti rolin që i takonte. Ndoshta nuk mund të ndodhte ndryshe. Nga pikëpamja psikike, ishte hera e parë që u bë e mundur të sulmoheshin fizikisht komunistët.

— *Megjithatë ka funksionarë të lartë të regjimit të vjetër të burgosur, të përndjekur...*

— Po...

— *Ndëshkimet e tyre a nuk patën qenë aq shembullore sa ç'do të ishte shpresuar?*

— Në njëfarë mënyre. Në fillim, proceset gjyqësore i lanë vend vendimeve të lehta,

qesharake. Disa prej të akuzuarve u dënuan, për prishje të pasurisë publike, me një muaj, gjashtë muaj, tetë muaj burg. Xhelatët, kriminelët e vërtetë, shijonin akoma lirinë e tyre.

— *Për kë bëhej fjalë?*

— Për shefin e sigurimit shqiptar, për kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe prokurorin e përgjithshëm. Tre fëlliqësira që s'i merr dot me mend. Ata formonin një trio të krahasueshme me atë që do të kishin formuar Himmler-i, Bëria dhe Vichinski.

— *Po ata u dënuan?*

— Ata u vunë nën presionin e popullit, si për të korrigjuar lehtësinë e dënimeve të shpallura kundrejt figurantësh të zbehtë. Ajo çka dua të qortoj është ndëshkimi me dënim kapital.

Duhet thënë se shpesh ata bënë provokime të papranueshme, të papeshuara mirë. Ata shëtisnin nëpër rrugë si idiotë, si të paprekshëm apo si njerëz mbi të cilët nuk rëndonte asnjë dyshim.

Mendoj sidomos për shefin e policisë. Në librin tim *Nga një dhjetor në tjetrin*, kam botuar letra të drejtuara presidentit të Republikës (Shqipëria ishte ende komuniste dhe shefi i policisë sekrete që ende në pushtet). Kam dashur

të theksoj sa turp ishte të kishe një torturues e një xhelat si përgjegjës politik. Ky njeri ka qenë vetë pjesëmarrës në tortura... Por, ja që këta tre qelbanikë u ndëshkuan.

— *Ata nuk ishin të vetmit?*

— Të tjerët? Ata që kanë torturuar, ata që kanë shtënë mbi njerëzit që rrekeshin të kalonin kufirin, siç bëhej në Berlin? Nuk ishin të shumtë në numër, besoj. Pjesa më e madhe u arratisën për të mërguar në Bullgari, në Bashkimin Sovjetik. Ju e dini, gjithmonë atje mërgojnë, sado e habitshme që mund të duket. Kjo më çudit akoma, por ma merr mendja se duan të gjejnë aty sivëllezërit e tyre të Lindjes.

— *Le të ndalemi një çast te Rusia. A nuk mendoni se ekzistojnë ngjashmëri midis Shqipërisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik?*

— Në planin e zgjedhjeve?

— *Në ndikimin e rigjetur të komunistëve.*

— Ekziston një ndryshim që është për t'u shënuar. Në Rusi, komunistët janë shumë më mirë të organizuar, kjo ndodh vetiu. Besoj se ju pata thënë tashmë se ajo çka dallon komunistët

shqiptarë është sipërfaqshmëria e tyre. Ata kanë dhënë provën e një mizorie të madhe, por si ta thuash? Kemi të bëjmë me mesdhetarë. Ata janë, për pasojë, më pak të thellë se rusët, më pak hijerëndë, më pak seriozë po doni të flasim kështu.

Përpos të tjerash, komunistët shqiptarë nuk ndryshojnë nga populli shqiptar, që heq dorë lehtësisht. Komunistët rusë janë gati të vdesin komunistë; besoj se te ne nuk është i tillë rasti. Ja pra, përse u bë e mundur të çrrënjoseshin aq lehtësisht, në një kohë kur komunistët rusë rezistojnë. Ata janë të pajisur me rrënjë të forta.

— *Ky është shpjegimi juaj?*

— Ky është një shpjegim. Tjetri do të mbështetej te nostalgjia...

— *Që do të thotë?*

— Bashkimi Sovjetik ishte një fuqi e madhe që kishte forcën të bënte që një kanosje të rëndonte mbi gjithë botën. Komunistët rusë kanë nostalgji për këtë, por më thoni, për çfarë do mund të ishin nostalgjikë shqiptarët? Ata do mund të ishin veçse për izolimin e tyre dhe për përbuzjen e përgjithshme në të cilën vuanin. Më lejoni ta theksoj, por nuk është aspak e njëjta gjë.

— *Kjo situatë nuk ju ngjall dëshirën të shkruani një libër me këtë temë... një roman të pakrahasueshëm...*

— Jo! Ju ndërpres këtu. Dua vërtet të jap intervista në shtypin shqiptar, por jo më. E gjithë kjo më kall krupën. Vetë leximi i gazetave shqiptare ngjall te unë një ndjenjë neverie. Artikujt më trishtojnë menjëherë. Duhet të më kuptoni, s'duroj dot më. Atje flitet veç për politikë. Më vijnë gazetat një herë në javë dhe leximi i tyre më bën nervoz. Nuk e pranoj dot gjuhën e përdorur nga dy partitë kundërshtare. Nuk e honeps radikalizmin e tyre.

— *Ju doni ta moderoni?*

— Jo vetëm e vetëm këtë. Por me të vërtetë, këtë gjuhë të përdorur, e kam marrë zët, ashtu si klasën politike, përveç kësaj. Njerëzit që e përbëjnë atë janë tmerrësisht pasionantë, të papërmbajtur, dhe kjo gjë ma shter durimin.

— *A do të kishte në Shqipëri një rrymë politike të cilën do ta përkrahnit, me të cilën do të bashkëpunonit?*

— Një rrymë politike që do t'i takonin përkrahjet e mia? Jo, s'ma do mendja. Kam frikë

se shumica e shqiptarëve mendojnë si unë, të paktën, kjo është përshtypja ime.

— *Ne kemi folur për angazhimin. Po angazhimi juaj a s'do të ishte më tepër i rangut patriotik, një angazhim në përkrahje të kombit shqiptar?*

— Le të themi se, nëse shfaq një ndjenjë aq të ndershme ndaj kombit shqiptar, kjo nuk është vetëm ngaqë unë bëj pjesë në të, por sidomos për shkak të fatit të tij tragjik. Kombi shqiptar ka qenë i gjymtuar nga historia. Po të ishte fjala për një komb që s'kish qenë aq i prekur, aq i tronditur, pa dyshim unë s'do të isha aq i lidhur...

— *Nga ana tjetër, Shqipëria është e pasur me një veçanti: gjuhën e saj, një gjuhë e veçantë, nëse mund ta themi këtë, që nuk është e papërfillshme, për një shkrimtar...*

— Po, është e vërtetë. Ne kemi patur tashmë rastin të flasim për këtë. Por nuk është dhe aq për shkak të kësaj veçantie që unë ndiej një lidhje aq të spikatur për Shqipërinë; më tepër bëhet fjalë për ndjenjën që unë kam përballë një vendi, një kombi që ka hequr vërtet mbi shpinën e tij një vargan padrejtësish. Në këtë, unë nuk ndryshoj nga pjesa më e madhe e njerëzve që duan vendin

e tyre; dhe vendi im, siç jua thashë, është sakatuar si rrallëkush. Për rrjedhojë, ai kërkon më tepër vëmendje.

— *Doni të flisni për Kosovën?*

— Dua të flas për atë vend të ndarë më dysh, meqenëse gjysma e popullsisë së tij jeton aktualisht jashtë kufijve të Shqipërisë, të shtetit shqiptar. Kush vramendet për të, më thoni? Kush ngre zërin? Heshtja vret, heshtja mbaron duke vrarë, ajo shkakton gjëma...

Me Shqipërinë, duhet ta keni vënë re se unë jam lidhur siç lidhemi me një të gjymtuar. Ai i shmanget normës, normalitetit, ai pra ka nevojë për ju. Mbani vesh, nëse Shqipëria do të kishte qenë një vend normal, unë do të kisha qenë ku e ku më indiferent ndaj saj.

— *Përsa i përket Kosovës, do të mundeshit të saktësonit opinionin tuaj?*

— Situata e krijuar për shqiptarët e Kosovës është një nga absurditetet e mëdhenj që godet Evropën. Një absurditet, sigurisht, dhe një tragjedi. Duhet të jesh i shurdhër ndaj vuajtjes ose shtiran që të mos pranosh atë që po ndodh aty, në një kohë kur çështja është më e qartë se kurrë.

— *Pretendohet se shqiptarët e vendosur në Kosovë e kanë prejardhjen nga ngadhënjimtarë të vjetër...*

— Këto janë dokrra... Shqiptarët janë bashkë me grekët dy popujt më të lashtë të Ballkanit. Prania e tyre ngjitet në kohët e largëta, në mos po qysh në zanafillë. Me pak fjalë, ata janë aty prej një kohe shumë të gjatë (qysh kur s'mbahet mend). Dhe këtë s'e kundërshton asgjë. Ata nuk janë banorë të qiellit! Ata ishin vendosur mbi një tokë dhe kjo tokë ishte Shqipëria dhe Kosova. Përse Kosova?

— *Po e kërkoj nga ju.*

— Po e saktësoj pyetjen: përse Kosova do të kishte mbetur e zbrazët? Mos vallë po priste mbërritjen e sllavëve, të cilëve do t'u kishte ruajtur pasuritë e saj?

— *Kosova ishte e pushtuar nga shqiptarët?*

— Ë si mund të ndodhte ndryshe? Kosova është një fushë pjellore, fqinje e Shqipërisë, dhe është pra e natyrshme që shqiptarët u vendosën aty rreth një mijë vjet përpara mbërritjes së sllavëve.

Grekët nuk e kërkonin Kosovën.

Këmbëngul mbi faktin që të pretendosh për “pushtetin e parë” nuk përbën argument; është krejtësisht e kundërta... Dhe me sinqeritet të plotë, pranoj se nëse serbët do zotëronin në Kosovë në kundërshtim të mëparësisë së shqiptarëve, atëherë Kosova do t’u kthehej serbëve. Por ju e dini...

— *Janë serbët ata që e kërkojnë në emër të Historisë...*

— Ju lutem, kemi të bëjmë me një nga ato mashtrimet à la Goebbels, me një gënjeshtër të stërmadhe kulturore që ka zënë vend falë injorancës së mediave, mungesës së tyre të thellimit, vetëkënaqësisë së tyre ndoshta.

Gjithë historianët seriozë e rishtrojnë çështjen e versionit që shkon në Serbi: shqiptarët ua kaluan serbëve dhe, së dyti, beteja e Kosovës ashtu siç është kallëzuar nga ana e serbëve i përkon një miti idiot, totalisht i pakuptimtë.

Ngulmoj sërish mbi absurditetin dhe pakuptimësinë e një vizioni të tillë të Historisë. Në mënyrë absolute, nuk ekziston tokë serbe, shqiptare, suedeze; t’ua lëmë gjeologëve të merren me çështjet e tokës. Historia ka të bëjë me njerëzit...

— *Është ky një mit që mbart sot...*

— Ky është një mit kriminal, meqenëse

përmes tij kërkohet t'i imponohet një rajoni të botës një fat, nga i cili do mundte të shpëtonte nëse, fare thjesht, do të respektohej Historia, në një kohë kur ende mund të vihet në dyshim fakti i imponimit çfarëdo qoftë ndaj një populli në emër të një ngjarjeje të shkuar.

Sidoqoftë, beteja e Kosovës nuk është ajo që besohet. Ajo u udhëhoq nga një koalicion princash ballkanikë dhe u drejtua kundër Perandorisë osmane. Ajo s'ka qenë e vetmja betejë e serbëve kundër turqve, dhe shí këtu nis mashtrimi — sepse, nëse ju modifikoni pjesëmarrësit e një beteje, atëherë i ndryshoni kuptimin.

— *Shqiptarët luftonin në radhët e koalicionit?*

— Që ç'ke me të! Beteja e Kosovës — dhe nuk dua të përdor këtu fjalë të mëdha të kota — ka qenë beteja e miqësisë së popujve të Ballkanit të bashkuar ballë një pushtuesi, dhe jo një betejë vetëm e serbëve që, me këtë rast, bëjnë si më afër derën se qilarin...

— *Por në këtë mënyrë serbët shpjegojnë dhe justifikojnë praninë e tyre në Kosovë...*

— Ky nuk është një argument po të kemi parasysh të vërtetën. Trajtimi i historisë së Kosovës është akoma më grotesk se ç'ta merr

mendja, dhe faji i bie në pjesë plogështisë shqiptare. Shqiptarëve për një kohë të gjatë u ka munguar zelli për të mbrojtur veten.

Gjatë kohës së shumë të famshmes betejë të Champ des Merles, tek e cila serbët u mbështetën për të shpërhapur mashtrimin nacionalist, asnjë shqiptar nuk gjendej nga ana e turqve, në një kohë kur mijëra serbë, të udhëhequr nga Marko Kraveliçi, shërbenin në ushtrinë otomane. Përfytyroni zhurmën që do bënin ata sot po që se ndonjë shqiptar do kishte luftuar kundër koalicionit shqiptar!

Por ka patur diçka akoma më qesharake, një “qyfyfyr” me të cilin ata nuk mburren dot: beteja e dytë e Kosovës.

— *Kur thoni “qesharake”, mos e hidhni fjalën te Hegeli, sipas të cilit ngjarjet ia behin nga dy herë në Histori: të parën nën një formë tragjike dhe të dytën si një farsë?*

— Këtu, gjashtëdhjetë vjet mbrapa së parës, “farsa” s’ish paraqitur në takim. Historia belbëzonte dhe hera e dytë ishte po aq tragjike sa e para. Turqit ndërmorën sërish një betejë të madhe, fillimisht përballë një aleance hungarezoshqiptare të drejtuar nga Janosh Huniadi. Punët kthyen paksa si në rastin e Vaterlosë për Napoléon-in që priste përforcimet e Grouchy-së. Skënderbeu

dhe shqiptarët mbërritën shumë vonë. Hungarezët luftuan të vetëm dhe u mposhtën. E kuptoni?

— *Jo dhe aq mirë, por ma thotë mendja...*

— Hungarezët nuk kanë mendjemadhësinë e tepruar të kërkojnë Kosovën dhe as të pretendojnë që kjo e fundit është djepi i identitetit kombëtar të tyre, ndonëse ata e patën provuar trimërinë e tyre — në mungesë të serbëve, e theksoj. Këta të fundit, qysh prej shumë kohe, rregulluan një mashtrim, ndërtnuan një ndërtesë të gënjeshtërt, ku çdo pjesë e rrëfyer përforcon një pjesë akoma më mashtruese. Është goxha e vështirë ta shkatërrosh sepse, kur rikthen një pjesë të së vërtetës historike që ka të bëjë me këtë, elementë të tjerë të kësaj mekanike haluçinante mbeten në vend.

— *Ç'zgjidhje propozoni ju për të ndrequr këtë padrejtësi? Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë?*

— Jo, unë nuk them këtë. Do të ishte e vështirë të ecej kështu aty për aty, pa u përgatitur. Do të duhej orientimi drejt një dialogu, përvijimi i një kompromisi duke pasur në mendje që shqiptarët e Kosovës nuk dëshirojnë të jetojnë me serbët. Të zërë fill një proces pavarësie? Fjala “pavarësi” të kall datën? Epo mirë! Pranoj të zëvendësohet, Denis Fernandez-Récatala.

— *Me ç'fjalë?*

— Sovranitet dhe, më mirë akoma: Liri.

Përktheu:
Alket Çani

BISEDA E TETË

(shtator 1998)

Duhej të takoheshim në Rostand, përballë kopshtit të Luksemburgut.

Ismail Kadareja po shkruante para derës aq sa ne as u pamë, as u njohëm. Ai pati përshtypjen se më pa, por unë, pasi hodha një sy të shpejtë nga banaku, dola sërish me ndjesinë e një takimi të dështuar.

Shkova në apartament ku, për rrjedhojë, pastruesja më njoftoi mungesën e tij. Teksa mora të kthehem prapë te kafeneja, u takuam poshtë te ashensori.

Shtyva derën dhe u gjenda ballë për ballë, disi i çuditur që po më shihte, sikur kishte ngjarë ndonjë hata.

Kjo ndodhi, në pamje të parë është e papërfillshme, disi rastësore, që merr kuptim dhe vlerë vetëm nga ç'vjen më pas.

Ndërsa, fare rëndom, po i tërhiqja vëmendjen rreth pasigurisë së një dëshmie — isha i sigurt për mungesën e tij dhe për këtë vija dorën në zjarr — Ismail Kadare vuri buzën në gaz sikur policia s'kishte të bënte fare me të. Përmendi tragjedinë e dashnorëve që, padashur, përvidhen për në takimin e shumëshpresuar, të mezipritur, takim ku i kishin dhënë fjalën shoshoqit.

Sot gruaja e tij ndodhet në një klinikë dhe ai shfaq aty ku është mërzinë dhe shqetësimin e herëpashershëm. I telefonon për të marrë vesh ndonjë lajm, duke e ndërprerë kështu bisedën e nisur.

Më lutet ta fal që banesa është në atë gjendje, ku gjithsesi lysterja ka përfunduar, dyshemetë janë pastruar e rregulluar. Zë ngoje mungesën e energjisë për të përfunduar gjithë rregullimet e nevojshme, qilimat që duhen ndërruar, kolltuqe të reja, edhe pse kolltuqet e sallonit ku qemë ulur nuk dukeshin se vuanin nga përdorimi i tepruar a vjetërimi. Pa dyshim, ai e lidh ndoshta gjendjen e të shoqes me këtë mospërfundim relativ, me atë ëndje rehatimi që do të përkonte saktësisht me dëshirat e saj.

Në mur varet një tablo me stil naiv dhe perspektivë kaotike. Ndihej i detyruar ta pyes për prejardhjen e saj. “Është qyteti im, përgjigjet ai, qyteti ku kam lindur, parë nga një piktor vendas...”

I sosëm bisedat e para, pas të cilave, i

mirësjellur, i dashur, ai jepet me gjithë qejf.

I hymë' temës së ditës: Feja. Ai përqendrohet dhe përkulet drejt meje si për të dhënë (çka është bërë tashmë e udhës) pamjen e një konfidence. Ndryshe nga ç'e kërkon zakoni, rregulli i njohur, ai pyet:

ISMAIL KADARE: A s'më thoni, Denis Fernandez-Récatala, nga do t'ia fillojmë? Tema është e gjerë, e shumanshme.

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Unë do të kisha thjesht si synim t'ia nisnim me Shqipërinë dhe besimet e ndryshme fetare që praktikohen atje.*

— Historia e tyre është sa e thjeshtë aq edhe e koklavitur, ke parë ti?

— *Më parë do të doja të më flisnit për veten, për bindjet tuaja. Mos ju bezdis gjë kjo?*

— Aspak. Unë nuk shoh në çfarë mund të më bezdiste kjo gjë. Unë jam ateist si shumë nga kolegët e mi, intelektualë shqiptarë. Mos pandehni se po e predikoj këtë ateizëm, se po e ngre në rangun e një virtyti. Ai i përgjigjet ndjeshëm një tradite, të cilën unë nuk jam në gjendje ta datoj.

— *Mos është një traditë e vonë që lidhet me*

regjimin komunist?

— Kurrresi. Ajo i ka rrënjët më së shumti te një fat historik që i ra për pjesë vendit tim.

— *Fat? I ç'natyre?*

— Fat që përkon me një mori konfliktesh ku ka qenë zhytur Shqipëria, për të cilat Shqipëria, nëse mund të shprehem, ka qenë teatër dhe lakmi. Pa përmendur kalendat, dihet që grekët e lashtë kanë përcaktuar aty më shumë se një nga viset e tyre të legjendave, çka i ka dhënë vendit një karakter të veçantë, mitologjik. Nga një anë tjetër, Bizanti dhe Roma kanë ushtruar në të ndikim të pamohueshëm, mandej Perandoria romake para ndarjes së kishës katolike, e për t'i rënë shkurt, turqit e Perandorisë osmane, që e sulmuan qysh në shekullin XV. Rezultati nuk u ndje: shumë fe a prirje fetare kanë zënë vend dhe bashkëjetojnë.

— *Ju thoni që ato bashkëjetojnë: domethënë pa veprim praktik?*

— Unë nuk them që Shqipëria e, për rrjedhojë shqiptarët, nuk kanë vuajtur nga luftëra a intriga. Mirëpo, bie fjala — dhe kjo mund të habisë, të befasojë — konvertimi për të cilën otomanët i nxisnin, pa e shtyrë më tej, nuk shkaktoi eksese siç mund të pritej, së paku për kohën...

— *“Për kohën”, si për të rimarrë shprehjen tuaj, do të thotë në ditët tona, në epokën tonë?*

— Në një periudhë më të rëndësishme se ç’ e përfytyrojmë, që merr, sigurisht, hov në shekullin XX, me një rrymë e cila, ka të ngjarë, që rrjedh nga Niçja dhe iluministët, një rrymë shkencore, nëse mund ta quanim kështu.

— *Por kjo periudhë që përmendni ju, a nuk ka njohur edhe ajo dobësi, “pendesë”, “kthim”? Në Evropën Perëndimore, në fillim të shekullit, u ravijëzua një lëvizje fetare.*

— Me Enver Hoxhën ngjau më shumë e kundërta. Në kohën e mbretërimit të tij, feja ishte kryekëput plotësisht e ndaluar dhe çdo shfaqje e saj shtypej. Mund të thuhet që kjo prirje ishte më tepër mjerane. Shqiptarët nuk i kushtonin rëndësi të tepruar kultit. Ata qenë mësuar dhe kaq, ndaj ta ndaloje, ta pengojë, shpaloste vetëm marrëzinë për të cilën qe i aftë diktatori. Feja është shpesh pjesë e një kulture, cilado qoftë ajo.

— *“Qenë mësuar”, thoni ju Ismail Kadare? “Të mësuar”, a nuk do të thotë kjo — të bindur?*

— Nëse shqiptarët qenë mësuar me diçka, kjo

gjë që pikërisht toleranca. Përpiquni të kuptoni që një familje mund të ndahej në dy fe pa ngjallur probleme dhe “a fortiori” nuk sjell grindje me një bir katolik e tjetrin mysliman. Secili ndiqte prirjen që i dukej e veta, krejt pa ndëshkim, nëse mund të shprehem kështu.

— *Po me martesat, ç'ndodhte?*

— Merreshin vesh. Vepronin me gjërat më të domosdoshme, pa mbledhur gjithë miqtë nga janë e nga s'janë. Martesat mikse bëheshin, së paku, prej një shekulli. Nga ana tjetër, nuk që gjë e rrallë kur, për të përfituar ndonjë post, ndonjë funksion në administratë, të ndërronin fe sipas rrethanës..

— *Pa i vrarë ndërgjegjja për këtë gjë?*

— Dëgjoni, i vriste a jo ndërgjegjja, atëherë bëhej fjalë për të rregulluar gjithçka lipsej për të fituar një punë dhe kjo as që shtyhej më tej. Tolerancën që përmenda unë, ia ushtronin, së pari vetes, nëse kjo thënie ju vjen për shtat... Në fakt, ju duket se llahtariseni nga jo kushedi çfarë, nga një veçanti pajtuese...

— *Ju deklaroni që Enver Hoxha i kishte shuar shfaqjet fetare. Në njëfarë mënyre a nuk përkonte me prirjen tuaj?*

— Me ç'prije? Me atë të shfarosjes, të cilës unë i isha kundërvënë me të gjitha forcat? Hajt, pra, le të mos përkrahim më paradokse që duken sheshit si vrastarë. Unë nuk po përpiqem të bëj njerëz për vete: ateizmi im lidhet vetëm me mua dhe unë nuk kam nevojë për makinë shteti që të më përputhë me të. As unë, as kurrkush. Enver Hoxha veproi në këtë fushë për t'u dalluar, për t'ia kaluar Stalinit me të cilin bënte garë dhe, falë një lëvizjeje të cilën unë do ta cilësoja perverse, për të ngjallur urrejtjen e Evropës ndaj Shqipërisë, a thua kjo urrejtje e shkaktuar legjitimonte politikën e tij. Prandaj ne fituam të drejtën tonë ta urrenim për dredhitë prej shtrigani, prej tirani të dorës së dytë. Ishte një Don Kishot dritëshkurtër, të më falni paksa, por pa marrëzinë shpëtimtare, çakërdinë kryekëput utopike.

— *Po cilat qenë efektet e kësaj, si te ju ashtu edhe jashtë?*

— Shpresoj që këtë ju nuk e keni të vështirë për ta marrë me mend. Pushteti ndiqte objektiva totalitare, por ky shpjegim, ndoshta, nuk mjafton.

— *Atëherë cilat qenë synimet e tij?*

— Duke futur në dorë shpirtrat, Enver Hoxha

ngulte këmbë në një politikë izolimi që i siguronte prapavijat në emër të patriotizmit dhe të pavarësisë. Ideologjia që predikonte brenda jepte përshtypjen e një origjinaliteti shqiptar të çliruar nga një e shkuar bezdisëse.

— *E një të shkuare, së cilës ai i merrte përsipër gjithsesi bëmat?*

— E një të shkuare të ngritur aty për aty, i prirur kah qëllimi që i kishte vënë vetes dhe ku feja, bie fjala, në emër të shkencës stalino-leniniste, të materializmit historik sipas formulës në fuqi — fqinjëronte me bestytinë.

— *Ju aluduat për efektet e jashtme.*

— Ata bashkohen e ndjekin në një plan tjetër pasojat që kërkonte Hoxha. Cili qe qëllimi i tij? Cili ishte efekti i shpresuar? Të izolohej Shqipëria. Me anë të çështjeve fetare ai i trefishoi frytet e tyre. Po shprehem përmbledhtas:

1. U largua nga e djathta botërore, nga vendet liberale që shihnin te ndarja me BRSS një mjet kooperimi.

2. U veçua nga e majta e përfaqësuar nga një BRSS më liberale, çka i lejoi në planin e brendshëm të denonconte komunistët me prirje renegatësh, revizionizmi, po të përdorim zhar-

gonin e asaj kohe.

3. Me dëshirën për të rënë në sy si ruajtës besnik i doktrinës, ai humbi mbështetjen e fundit, në këtë rast maoistët.

— *Po këto vendime janë marrë në mënyrë të mirëmenduar?*

— Ja ku do doja të dilja. Te ky veçim që e pati fenë si pretekst të fundit. Hoxha, ndryshe nga diktatorët e sërës së vet, ishte i bindur që veçimi çonte ujë në mullirin e tij, se ai ndihmonte përforcimin, fuqizimin e mbretërisë së tij

Madje nuk duhet fshehur që edhe sot e kësaj dite loja vazhdon, si për inerci dhe a thua se mediat, pjesërisht, nuk kanë pranuar të luajnë rol paditës.

— *Nëse ju kuptoj mirë, armiqësia e kërkuar nga Hoxha e favorizonte?*

— Ajo i verbonte kundërshtarët e tij që e përdornin për ta dënuar, duke nënvleftësuar faktin që po ia kalonin në dëshira. Ata kryenin, si të thuash, një gafë dhe kënaqeshin. Shqipëria e Hoxhës qe e pandreqshme, si Hygo-i i Zhan Pol Sartrit në *Duart e pista*, por për shkaqe të kundërta.

I veçuar, Hoxha ishte jashtë rrezikut dhe për arsye politike dritëshkurtra, kjo u shkonte për shtat

si Lindjes, si Perëndimit, që shikonin te Shqipëria një vend të asnjësuar: Vendi i shqiponjave nuk qe më i fajkonjve, as i pëllumbave, asgjë më shumë se një lloj lufbridi pa flatra. Ju po shihni, Denis Fernandez-Récatala: pamjen e një oborri shpendësh të çuditshëm e kërcënues...

— *Ismail Kadare, situata që përshkruani nuk ju pengoi të mbrunit Ura me tre harqe, që ka për protagonist një murg katolik. Ky roman është botuar.*

— Botuar me vështirësitë që shkaktonin rregullat e asaj kohe. Libri për pak sa nuk u ndalua, ju e merrni, pa dyshim, me mend. Përfytyroni që bëhet fjalë për një lloj dorëshkrimi të shkruar në vetën e parë njëjës nga një murg: “Unë, aty”.

Cila do të qe ënda ime e asokohe, veçse fakti që të shkruaja një tregim të një lloji disi të veçantë për mua? Theksimi i dallimit të rrafshit, të themi ideologjik. Vendosija e shkallëzimeve në vlera pak a shumë pozitive. Duke shqiptuar dëshmitë e këtij murgu, duke e ngritur në rang hero i një hero që ka për veçori, po e theksoj në kllapa, prirjen për të shkruar, mua më mbetej që t’i jepja përparësi me anë të fesë disa të dhënave pas të cilave jam dhe mbetem i dhënë.

Katolicizmi, fjala vjen, që e ka selinë në Vatikan — dhe ky saktësim, sado që t’u duket i

tepruar, nuk është i pavend — përbën për ne derën e hapur kah Perëndimi, ndërkohë që ortodoksia, për disa arsye që ju nuk mund të mos i dini, sikur i largohet disi. Sa për islamizmin, edhe pse përbën një rrezik të papërfillshëm te ne, ai nuk simbolizon në asnjë rast Evropën.

Me plot kthjelltësi, unë ja ku po ju theksoj se sot, në kohët që kanë ardhur, ai e bën fare pak për vete rininë.

Për më tepër duhet pranuar pa ngurrim që, në përgjithësi, ndjenja fetare është vakur, nuk ka më ndikim real...

— *Po, jam në një mendje, Ismail Kadare, por përse të vendosen këto dallime, të krijohet një hierarki?*

— Ka shumë përgjigje edhe pse ato varen nga njëra-tjetra dhe paçka se disa pleksen me të tjerat e rrjedhin prej tyre.

Një murg flet, dëshmon për çka heshtet, ndalohet. Ai flet në emër të një populli gojëkyçur, i kthyer në memec nëse ua ka ënda...

— *Po ato arsyet e tjera?*

— Do t'u kthehem edhe atyre, Denis Fernandez-Récatala. Edhe te ato do të dal... Sepse për çfarë flet duke vepruar asisoj me aq adhurim?

— *Pak a shumë për këtë po ju pyes, Ismail Kadare.*

— Ai flet për ardhmërinë e Shqipërisë. Me pretekstin e katolicizmit, me një sajësë që ju do ta gjykoni të këtillë pa dyshim ai mëton të flasë për ardhmërinë e Shqipërisë, të shqiptarëve. A ju habit kjo tani që ju njihni bindjet e mia?

— *Ma thotë mendja se bëhet fjalë për ndonjë trillim...*

— Për një trillim po, por me kumbime të njëmendta, sepse katolicizmi i shfaqur nga ky murg bën thirrje — aq sa çuditem se si nuk e kemi pikasur — për të drejtat e njeriut për utopinë ungjillore — për t'u kthyer te ajo që, me ç' dukej, e kishit fort për zemër.

Për më tepër, ky murg nuk flet në shkretëtirë, dua të them shkretëtirë poetike, fetare, por në mes të një Shqipërie konkrete, reale, ku gjysma e banorëve janë myslimanë — të paktën (dhe kjo i kundërvihet së vërtetës), këtë gjë e pohonin komunistët duke pazarepsur shifrat, pazar ku ata e mbanin veten për mjeshtra, cilado qoftë lënda a fusha përkatëse.

— *Po ky manipulim, me ç' dëshirë përkonte,*

me ç'ëndje?

— Edhe për këtë lypsen një mori përgjigjesh dhe, pa rënë në përsëritje, do të thoja se këmbëngulja për izolim është shkaku parësor i kësaj. Komunistët nuk u sprapsën asnjë grimë për të vendosur dhe përjetësuar pushtetin e tyre, edhe pse strategjia e izolimit, e izolacionizmit e zhyti vendin në një situatë nga më të zymtat.

Me qëllim që të theksohej një e ashtuquajtura veçori — ajo e një shumice myslimane — ata përdorën gjer në teprim fatin që u rezervuan shqiptarëve të Kosovës serbët, ata serbë që nuk qenë më të mirë se Enver Hoxha me shokë dhe, natyrisht, në logjikën e tyre i lanë pasdore boshnjakët, me të cilët mund të mbanin lidhje për hir të gjendjes reale të Shqipërisë, ku bashkëjtonin shumë besime.

— A janë plot gjallëri fetë në Shqipëri?

— Plot gjallëri është ca si shumë për të cilësuar besimet dhe veprimtaritë e tyre. Por, ua theksoj përsëri, zelli i madh është fashitur dhe, përfundimisht, nëse feja mbijeton, kjo ngjet kryesisht për motive etike.

— Pra, integrimi islamik qenka i panjohur?

— Me sa di unë, po. E përsëris, askush nuk

shqetësohet për fe dhe madje, besoj, është gjëja e fundit për të cilën të shkon mendja. Më së shumti bëhet çmos për t'u informuar. Ka një shembull midis shumë të tjerësh: zgjedhja e një emri nuk merr rëndësi dhe edukimi nuk pengohet nga këto çështje.

— *As në Kosovë?*

— Unë po ju flas për një Shqipëri “të brendshme”, për një shtet, një vend, një popullsi. Nuk po jepem pas asnjë besimi. Sa për Kosovën, mbetem me bindjen që mësimi i gjuhës amtare duhet të jetë parësor. Mua nuk më kanë zënë kurrë veshët kërkesa lidhur me shkolla kuranore. Serbëve do t'u shkonte mjaft për shtat po qe se kosovarët do të qenë shprehur në këtë drejtim...

— *Si për të përmbledhur mendimet tuaja, feja nuk ndikoka në qëndrimet shqiptare?*

— Unë nuk do të thosha pikërisht këtë gjë dhe ca më pak, me fjalë kaq pohuese. Ajo bën pjesë në jetën e përditshme, domethënë ajo shprehet në doke, në zakone, në shumicën e të cilëve njerëzit nuk binden se duhet hequr dorë. Për ta kjo është thjesht një fakt, një e dhënë midis të tjerash...

Madje, për t'ju bindur se gjer në ç'pikë ky

aspekt merr rëndësi krejt relative, po përmend një shembull shumë të njohur te ne: atë të Faik Konicës, ambasador i Shqipërisë në kohën e Mbretit Zog. Po pra! Ky njeri e ndërroi fenë katër herë dhe e gjithë kjo u pa si diçka krejt normale. Ai nuk pësoi asnjë ndëshkim e ndoshta dhe për oportunitizmin e vet, në mos për mendjempreh-tësinë. Këmbëngulja e tij — në pat qenë këmbëngulës — as që ia vlente.

— *Henri IV thoshte që Parisi ia vlen për një meshë...*

— Po, por pas një Shën Bartolomeu, kurse te ne, në Shqipëri, feja nuk është e nuk ka qenë e mbarsur me ndonjë intrigë të mynxyrshme.

Ne jemi përballur me katër fe: katolicizmin, ortodoksinë, islamizmin dhe bektashizmin, një prirje e islamit liberal, i shkëputur nga ndarja iraniane, bie fjala.

*

E kisha ende në mendje bisedën tonë për fenë kur, për koinçidencë a rastësi objektive, në bulevardin Sent-Mishel, lart në Sorbonë, disa njerëz kishin zënë trotuarin me pankarta të vendosura në trajtë V-je të përmbysur në të cilat qenë ngjitur fotografi mizore.

Ata mblidhnin firma për një petition që dënonte integrimin iranian. Shkronja të mëdha shtypi spikatnin poshtë pamjeve me të torturuar: këtu vriten fëmijë, masakrohen...

Ekstremizmi fetar që patëm përmendur po na zinte rrugën.

BISEDA E NËNTË

(tetor 1998)

Pikë së pari duhej folur për telefonatën dhe zërin e trishtë, për punë takimesh dhe së fundi për ngjarjet që tronditën Shqipërinë.

Ne po prisnim saktësisht e si të thuash, ecurinë e mëtejshme dhe përfundimin e ngjarjeve me qëllim që të vazhdonim dhe të përmbyllnim bisedat tona që po zgjatnin thuajse prej dy vjetësh.

Saint-Claude i bulevardit Saint-Germain, ku po bisedonim me pamje të përhumbur dhe të frymëzuar nga statuja e Diderot, i mbylli përfundimisht dyert dhe ia la vendin një dyqani veshjesh sportive: Shkaba, thuajse titulli i një tregimi të Ismail Kadaresë. Vendi nuk oshëtin më nga fjalët që kumbonin dhe dergjej në një atmosferë kotëse e gjithësesi mirëpritëse, teksa ngrihej zëri për t'u dëgjuar nga tjetri pa cënuar ndërkaq intimitetin e ushtruar të fqinjëve.

Tani të flasim seriozisht: lufta kishte marrë fund (përkohësisht) në ish-Jugosllavi, integrimi mysliman u rrit dhe madje u shndërrua në një luftë terroriste në disa vende. Diku një puhizë ka sjellë freski dhe gjetiu një fllad vere e ka vakur klimën politike.

Këtu në Francë, orientimi bëhej sipas ndryshimeve për mirë a për keq në varësi nga vlerësimet. Përmendeshin premtime të tradhtuara.

Evropa çapitej këmbadoras dhe aty-këtu përshpejtohej vajtja e trupave paqeruajtëse në Shqipëri.

Atje në jug të Tiranës, po hidhte rrënjë frika. Gomonet për lanin pareshtur pará nga të dëshpëruarit që i priste largimi për në kampe të përkohshme ose në fund të detit.

Në televizor jepeshin turma të armatosura, fëmijë që përkuleshin nën peshën e gjerdanëve me fishekë duke vringëllirë në qiell armë zjarri.

Shihej zemërimi i qytetarëve të mbetur sa hap e mbyll sytë pa kokërr kursimi përpara bankave të fshehura.

Kuptohej pa marrë vesh gjë, domethënë pa rrokur thelbin e një çështjeje tek e fundit fatkeqësisht ekzotike, e largët, me përjashtim, sigurisht për Ismail Kadarenë që vëzhgonte një pushtet që kalamendej nga goditjet e fuqishme thuajse të verbëta të bandave pak a shumë të organizuara.

Po, ishte telefoni dhe ky takim ku ne e gjykonim të parakohshëm çdo regjistrim.

Bisedonim dhe korrigjonim fjalët e ritranskriptuara, të rënda, thuajse pa gjallëri, gjithsesi të kënaqur që nuk po e humbnim kohën, ndërsa atje, në brigjet e Adriatikut, po zinte fill një dramë.

Sa për mua, nëse duhet që të dal këtu në skenë, unë po sillja ndërmend thëniet e Ismail Kadaresë lidhur me karakterin e përciptë, sipërfaqësor të një mendësie mesdhetare ku përpjekja shteron para se të ndërmerret.

Do të dëshiroja të theksoja në këto radhë heshtjet, tonin dhe nuancat e stërlodhura nga pritja e një zgjidhjeje me synime të paqarta. Për rrjedhojë, kjo bisedë u shty shumë herë, ditë pas dite.

Më në fund, ajo u zhvillua në një klimë kthjellimi, madje dhe atëherë kur unë nuk isha i bindur lidhur me përshtatshmërinë e saj për motive që lidhen me botimin, motive funksionale pra, si dhe të tjera shkaktuar nga një lloj sedre. Në tërësi, unë nuk e kuptoja rëndësinë e saj, sepse — dhe ecuria është e mugët, torturuese — kisha ndjesinë se nuk na përkiste dhe aq, e sidomos se e bezdiste Ismail Kadarenë.

E vura në dijeni për këtë me çiltëri, duke dhënë argumenta mbi padobinë e saj të mundshme dhe, kësisoj, besoja se do t'ia bëja më të lehtë.

Qe pikërisht ai që këmbënguli të më jepte

opinionin dhe mendimet e veta rreth këtij aktualiteti që unë e vlerësoja, pa dyshim gabimisht, si diçka që ishte jashtë teme, sepse ishte shumë e mpleksur me ngjarjen, për të mos thënë me vetë rrëfimin e saj, me sporadiken.

Si zakonisht, para se t'ia nisnim bisedës, këmbuem pikëpamje të përgjithshme a të veçanta, si për të ardhur në formë dhe për t'i kushtuar kështu një vëmendje më të madhe njëri-tjetrit, duke vendosur pika të përbashkëta për të përfutur një qasje të përgatitur së bashku... Ishim ulur përballë njëri-tjetrit, me mangnetofonin në mes dhe ec e merre vesh përse atë ditë, aparati nuk bëri fare vickla...

*

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: *Do t'ia nisim thjesht me ngjarjet më të fundit në Shqipëri, që kanë tronditur mbarë botën. Askush, pothuajse, nuk i priste shpërthimet e dhunës që çuan bie fjala, në zgjedhje të reja. A mund të na thoni se si e përjetoni këtë gjë?*

ISMAIL KADARE: *Përjetimi im i parë, për njëfarë kohe, është që në Shqipëri ka ndodhur diçka e cila, hë për hë mbetet mister. Ndoshta, bëhet fjalë për një dukuri anësore, për një ngjarje pa pasoja të përfillshme. Mbase është fjala vetëm për aspektin*

e shkaktuar nga debati politik. Megjithatë, unë kam përshtypjen se pikë së pari ka ngjarë diçka e pashpjegueshme.

— *Më falni, por në ç'gjë mbetet e pashpjegueshme kjo dukuri?*

— Së paku, për dy arsye: Shqipëria ka qenë vendi që e përjetoi thellë komunizmin, u ndikua prej tij, nëse mund të shprehem kështu, dhe njëherësh, i bëri qëndresë. Së dyti, nga gjithë vendet ish-komuniste, ishte pikërisht ai që u afrua më shpejt me Perëndimin.

Dhe këtë, e kemi përmendur: Shqipëria, edhe pse staliniste, ishte shtet i ndarë nga kampi socialist. Kjo situatë përbën ende paradoks. Duhet kuptuar mirë që, për udhëheqësit shqiptarë, armiku për vdekje kishte fytyrë të dyfishtë, njëra vinte nga Lindja dhe tjetra nga Perëndimi.

Kur u kthye nga Perëndimi, Shqipëria ishte tashmë në gjendje ta braktiste komunizmin, sepse pjesëmarrja e saj ishte kryesisht e rrafshit sentimental dhe lidhej shumë më pak me politikën, me shtetin. Ajo nuk kishte madje as përfaqësim diplomatik në shumicën e vendeve që përbënin kampin socialist.

— *Sipas jush, a ishte Shqipëria e pjekur aq sa të përfshihej përkrah Perëndimit?*

— Ky ishte vullneti i saj. Për këtë ishte e vendosur. Për më tepër, më lejoni t'ju përmend që, në vend, ky orientim i ri dha rezultate të mira, si nga pikëpamja politike dhe nga pikëpamja ekonomike. Gjithçka u shndërrua menjëherë, ja përse ju thashë që ndodhi diçka e mistershme...

— *Çfarë pra?*

— Këtu qëndron gjithë vështirësia... Po hedh për këtë një hipotezë: a thua sikur diku, të kishin menduar se ia vlente më së shumti që Shqipëria të mbetej komuniste.

— *Ju po më habisni. Kush mund të uronte që Shqipëria t'i kthehej sërish komunizmit? Vetë shqiptarët apo presidenti?*

— Kur ju them “diku”, unë nuk e kam fjalën për Shqipërinë. Mendja më shkon te interesi i këtij kthimi “diku në botë”.

— *Nuk jua fsheh që po më çudisni.*

— Ndoshta, e gjithë kjo është një fantazi shkrimtari, por kam përshtypjen se “diku” shfaqet një lloj “pendimi” që i jep shkas ndonjë dredhie a intrige.

— *Ku ju shkon mendja, në këtë rast?*

— Shikoni, unë e di se sa e vagullt është e gjithë kjo, por kam përnjimend përshtypjen se është pazarepsur një Jaltë e dytë.

— *Megjithë dëshirën e shprehur nga shqiptarët.*

— Po, po, në kundërshtim me dëshirën e tyre. Po jua përsëris dhe këmbëngul. Shqipëria në kundërshtim nga Jugosllavia, qe shkëputur realisht nga Lindja. Sa për Jugosllavinë, ajo ka qenë ndërmarrja më e mirë e më e madhe e largimit të mendjes nga bota komuniste, me prirje kah Perëndimi.

Është pikërisht Jugosllavia që, në një çast të caktuar, i nxori gështenjat nga zjarri me duart e komunizmit. Ajo u pranua nga Perëndimi, tërhoqi botën e tretë, strukturoi lëvizjet e ashtuquajtura paqësore, etj. Ajo luajti, pra, rolin e një kali Troje, kurse ndarja e Shqipërisë nga bota komuniste qe e prekshme, konkrete dhe me pasoja tragjike për shqiptarët.

— *Ju jeni të mendimit që ka patur moskuptim?*

— Kjo qëndron në një konstatim: duket se

diku dhe për rrjedhojë, unë nuk e di se ku dhe duke mos e ditur se ku, unë nuk i di as arsyet e vërteta të kësaj gjëje — hyrja e Shqipërisë në Evropë shihet jo me sy të mirë.

— *Prandaj e përmendni ju një Jaltë të dytë?*

— E si të të mos shkojë mendja kur vërej një prirje antishqiptare, të qëllimshme, tek disa drejtues politikë evropianë a perëndimorë?

Kështu, ka veç pak ditë që ngjau një përplasje midis shqiptarëve dhe policëve në Maqedoni. Për pasojë, një mori u vranë, qindra u plagosën dhe u kryen nja një mijë arrestime. A jeni në dijeni për këtë? Shtypi botëror, edhe nëse foli, këtë gjë e bëri me doza homeopatike.

— *Ju dilni gjithmonë te pabarazia e trajtimit që nuk i përkrah shqiptarët...*

— Tek e fundit, kjo ngjarje, ndodhi jo larg Parisit, thuajse në kufirin francez, në Evropë! Dhe u vranë njerëz për çështje flamuri. Në Maqedoni, më shumë se një e treta e popullsisë është shqiptare. U tha se bëhej fjalë për një keqkuptim, por keqkuptimi që mbyllet me shtypje në masë është akt i kulluar e thjesht politik. Kush e krijoi acarimin, cili e lejoi të zgjerohej, kush mohoi një të drejtë?

Dhe, si përgjigje për këtë dhunë të ushtruar karshi një pakice të këtillë, i kundërvihet heshtja, një heshtje pak a shumë nga halli.

Prandaj unë dyshoj gjithmonë e më tepër lidhur me dëshirën për ta pranuar Shqipërinë në gjirin e Evropës, dhe i besoj përherë e më shumë asaj prirjes anti-shqiptare që të bën të mendosh se “diku”, është marrë vendim që Shqipëria duhet të mbetet e dobët duke e izoluar.

— *Mos hamendësohet, vallë, se çështja shqiptare përbën rrezik për Ballkanin?*

— Kjo është kryekëput gabim. Unë ngrihem kundër thënieve të këtilla dhe ne e dimë se nga vijnë të tilla pohime: nga Rusia, nga sllavët, nga mbeturinat e propagandës sovjetike që predikojnë një antishqiptarizëm parak në emër të shovinizmit pansllav, si njëri nga më të këqinjët në botë, për besë.

— *Askush nuk e nënvlerëson ëndjen perandorike ruse...*

— Nuk dua ta teproj, por pansllavizmi ka të bëjë me hitlerizmin. Dëshira ose simptoma: fati i kriminelëve të luftës në Bosnjë. Forca ndërkombëtare arrestoi një të këtillë dhe vrau një tjetër prej tyre. I vetmi vend që protestoi që Rusia. Verbëri

me brirë! Kjo aleate e re e Perëndimit merr në mbrojtje kriminelë lufte, njësoj sikur të mbrojtë nazistë, kurse Bashkimi i shkrimtarëve të Rusisë së sotme pranon Karaxhiçin të cilit i jep çmim poezie? Poezie, ë... Këto nuk janë ëndërritje, por makthe!

— *Ata nuk përkrahin mbrojtjen as marrjen në mbrojtje të kriminelëve.*

— Ata përkrahin ata që mbështesin kriminelët. Rusia protestoi zyrtarisht. Ajo nuk pranon gjykimin e kriminelëve serbë të luftës sepse ata janë “sllavë” dhe sepse ata i kanë kryer krimet e tyre ndaj popujve që nuk janë të këtillë. Si rrjedhojë, për ta kjo gjë falet.

Për mua, këta kriminelë janë një me nazistët. Duhet patur guxim për ta thënë, madje dhe për ta shpallur me zë të lartë. Kemi të bëjmë me një shovinizëm racial, të tipit nazist. Dhe bota po e pranon.

— *Ju jeni të mendimit që populli shqiptar është në shënjestrën e shovinizmit sllav?*

— Pikërisht. Vetë faktet e dëshmojnë. Shqiptarët kanë nevojë për mbrojtjen e Evropës dhe qëndrimi i saj ndaj tyre është i mefshtë. Kjo braktisje e heqje dorë për ligjet me gjithfarë

gënjeshtërash. Ne po përballemi me një përllodgaritje cinike. Është fjala për destabilizimin e vazhdueshëm të këtij populli po aq të moçëm sa grekët. Askush nuk po i jep ndihmën e shumëshpresuar. Shqipëria është pa familje. Atë e kanë kthyer në popull jetim. Kam përshtypjen e qartë që, hë për hë, kjo hapësirë u është besuar rusëve dhe që nga ky çast, fuqitë e tjera pandehin që Shqipëria është nën protektorat. Ja përse e hedh poshtë mësimin e moralit që na shesin disa gazetarë.

Jef — *Këtë gjë, ju e keni përmendur tashmë.*

— Dëgjoni, unë e kam aq përvojë sa ta kuptoj që ata janë, në pjesën dërrmuese, përgjegjës të krimeve. Këta gazetarë — jo të gjithë — kanë marrë pjesë në mungesë, duke heshtur teksa vënë re një heshtje që unë do ta cilësoja të turpshme.

— *Mos kemi të bëjmë këtu, më shumë me të kundërtën? Në Shqipëri, ngjarjet kanë qenë mbuluar nga mediat...*

— Po ju ndërpres. Ne nuk na është treguar Shqipëria. U fokusuan vjedhjet. U la në harresë konteksti, dhe për javë me radhë, një kanal evropian u bë televizioni zyrtar i banditëve, i kriminelëve me të drejtë të përbashkët. Kamerat

regjistruan deklarime antropofage, kanibale dhe, në Shqipëri këta zëra shpërndarë nga një kanal evropian, u quajtën si zëri i vetë Evropës, dhe ky zë nuk iu kundërvu terrorit, përkundrazi, u kthye në thirrje për terror, thirrje për të vrarë e prerë kundërshtarët politikë në tërësi.

— *Ju lutem të më falni, unë nuk vë në dyshim as çiltërinë, as ndershmërinë tuaj, por përnjëmend e keni patur këtë përshtypje të thirrjes për vrasje të përgjithshme teksa shihnit ato pamje?*

— Nuk gabohe: pashë e dëgjova vetë. Shqisat ende nuk më kanë lënë. Kqyra se si një kanal televiziv i lejoi vetes t'i drejtonte këto thirrje vrastare një pjese të popullsisë për ta ndërsyer kundër tjetrës. Unë pashë dhe dëgjova se si u jepej përparësi provokatorëve, si mbështeteshin qëndrimet dhe deklaratat e tyre, se si iu bashkangjitën krimit.

— *Unë mund t'ju kundërshtoj duke thënë që kjo kryengritje është paraqitur këtu si me karakter popullor...*

— Popullor? Atëherë, le të më thonë në këtë rast se ç' nuk na qënka e këtillë! As më shumë e as më pak, është fjala për mashtrim. Kjo kryengritje e ka zanafillën tek mafia, por as që

pretendoj, larg nga unë ky mendim, se nuk ka patur pakënaqësi popullore. Kishte mjaft motive për ta nxitur.

— *Doni të thoni nga rënia e firmave piramidale dhe bankare?*

— Po, me siguri. U përndez ëndrra për pasurim në rrugë të lehtë pranë një popullsie përafërsisht pa një kacidhe. Dhe u premtua se do të përtërihej kjo ëndërr. Qe mëndjelehtësi kur iu tha këtyre njerëzve të mashtruar e duarthatë: “Ejani me ne, se do ta rifitojmë sërish paranë e humbur e avulluar”. Mirëpo në të vërtetë, ishte fjala për një mashtrim në përmasa të mëdha.

Dhe le të flasim midis nesh, nga buron kjo para? Shqipëria është vend i varfër...

— *Ju mendoni që situata e krijuar nuk mjafton për ta shpjeguar këtë kryengritje?*

— Sinqerisht, jo. Sepse, me ç’kut mund të maten fakte aq të papranueshme sa grabitja e bibliotekave, shkatërrimi i arkivave, gjymtimi i bashkive? Plaçkitja e të gjitha institucioneve të shtetit, me një urrejtje që nuk ka të bëjë aspak me një lëvizje popullore të organizuar, ta themi përmbysëse.

— *Ju pikasni në të duhmë bolshevike. Komunistët kanë ngritur shtet sundues.*

— Gjithsesi, ata kanë nisur ta përmbysin shtetin me puç.

— *Për mua, ky është një nga paradokset e komunizmit që mbahej si shuarje e shtetit: me të marrë pushtetin, ai e fuqizoi shtetin në mënyrë të llahtarshme.*

— Gaboheni. Janë pikërisht dobësia, vobektësia ato që e karakterizojnë shtetin komunist. Në një regjim komunist, forca vjen nga diktatura që ushtrohet dhe, në gjirin e kësaj diktature, strukturat e shtetit janë dytësore. Nuk duhet ngatërruar partia dhe shteti. Po të merrni shembullin e policisë, ky ndryshim bie në sy nga spikatja e saj. Në vendet komuniste, policia zyrtare ishte policia më qesharake që mund të bëhet, më qesharakja e policive që mund të përfytyrohen. Në të kundërt, policia sekrete zotëronte pushtete të pakufizuara.

— *Partia kishte zëvendësuar shtetin...*

— Në fakt, gjërat mund të shihen edhe në këtë këndvështrim. Ca më pak, shteti, ky institucion publik që kuptimërisht i mangët. Në diktaturë,

askush nuk trembej nga policia ligjore dhe të gjithë ia kishin frikën policisë politike, aq më tepër i druhashin kur ajo shfaqej e maskuar.

Do t'ju tregoj një anekdotë që me siguri do t'ju befasojë. Në 1990, kur pashë për herë të parë policinë të merrej me protestat në rrugë, kjo shtypje e hapur m'u duk shenja e parë e liberalizimit të vendit tonë. Policia po vepronte haptas. Për sa më përket mua (dhe këtu flas në emër të gjithë shqiptarëve), nuk kisha parë kurrë në regjimin e mëparshëm polic që të godiste dikë në mes të rrugës.

— *Egërsia policore do të bënte, pra, pjesë në demokraci?*

— Në rastin e mësipërm, po. Po ju them dhe e pranoj që kjo shenjë është nga më të zymtat, por ju lutem që të mos e shkëputni nga konteksti i vet.

Nën regjimin e Enver Hoxhës, policia e zakonshme dallohej nga mosekzistenca e roli i saj i padëmshëm, ndërkohë që policia sekrete kryente krime pa u cënuar aspak. Po, unë e pranoj, ky shembull është kontradiktor, të mërzit. Si të parapëlqesh një polici...

— *Kjo gjë është vërtet shqetësuese, Ismail Kadare.*

— Dhe unë po ju sjell një përgjigje befasuese për vetë ju: në atë rrethanë, të fundit të një diktature, të armatosje policinë zyrtare, ta pajisje me shkopinj gome, dëshmonte që roli i policisë së fshehtë po zbehej, ishte në zhdukje e sipër. Shteti po zinte vend. Unë nuk po them që ai vepronte si në ditën e tij më të mirë, por papritur, me anë të demonstrimit të forcës publike, ai po u binte në sy të gjithëve fare pranë.

— *Për ju, pra, demokracia po niste nën patronazhin e policisë?*

— Mos bëni ironi me fjalët e mia. Ne nuk na kishte marrë malli për policinë. Ne aspironim për shtet demokratik, për ligjshmëri, ligj për shtet ligjor që i kishte munguar tmerrësisht vendeve komuniste. Unë mund t'u flisja po kaq mirë edhe për Parlamentin, institucionet juridike, të lëna pasdore në një regjim totalitar. Unë mund t'u flisja për qeverisjen, për funksionin ministeror, që përkonte plotësisht me atë të një drejtuesi ndërmarrjeje që kryen punën e vet nën mbikqyrjen e një instance që ia imponon direktivat a vullnetin e vet.

— *Partia?*

— Po, partia, udhëheqësit e partisë, komiteti qendror, byroja politike, që e shihnin me zili dhe kufizonin çdo formë autoriteti përveç atij që mburrnin ata. Kjo nuk është gjë e re, por diktatura e partisë e shtypte vetë shtetin. Partia e kishte shndërruar në një lloj molusku për t'ia penguar efektshmërinë. Ajo vepronte me të kundërshtar i gërryer nga lakmia dhe ky rivalitet gjente jehonë në veprimtarinë e policisë.

— *Mos vallë, kjo do të thotë që policia zyrtare i kundërvihet policisë sekrete?*

— Unë kam qenë i pranishëm shpeshherë në ankesa, protesta të formuluar nga oficerë të policisë profesionale që ndiqte kriminelë dhe nga të cilët kërkohej, pikësëpari, që të përdroreshin për survejimin e kundërshtarëve politikë të mundshëm a jo.

Këta policë kishin kontakte me popullatën. Këta ishin pothuajse liberalë dhe indinjoheshin prej shtrëngesave e detyrimeve në të cilat i nënshtronin, shtrëngesa dhe detyrime që nuk përkonin me kompetencat e tyre.

Ja përse, nisur nga ky shembull i skajshëm, unë mund të vërtetoj që diktatura komuniste sjell pas
pashmangshëm shkrehjen e shtetit.

— *Po unë, a mund të jem i prirur të besoj që*

ju i përfshini ngjarjet e ndodhura kohët e fundit në këtë perspektivë të një shteti difektoz?

— Pamja e shtetit ishte e përcmuar, funksionimi i tij i përbuzur. Askush nuk i kushtonte as besimin, as respektin e duhur si institucion qendror, dhe kjo do të mjaftonte, për të shpjeguar dhunimet e këtyre ditëve të fundit si dhe mospërfilljen rrënjësore të institucioneve, të dobësuar jo vetëm nga paaftësia e politikanëve shqiptarë, por sidomos nga një sundim i gjatë komunist.

— *Arsyetimi juaj është më shumë politik se letrar, dhe nëse ka “fantazmagori”, ajo lidhet më së shumti me vëmendjen e mprehur për jetën publike sesa me ndonjë prirje të posaçme për librat. Mënyra se si ju e shpjegoni demokracinë me hyrjen në lojë dhe veprimet e policisë nxjerrin në pah mungesën e shtetit.*

— Unë nuk doja të shkoja më tej në këtë çështje, por ishte edhe rasti i policisë sovjetike, milicisë, në lidhje me të cilën të gjithë bënë shaka, ndërsa secili llahtarisej nga tmerrri i ngjallur prej KGB. Gjithandej në kampin socialist, qe e njëjta gjë. Një rast tipik — dhe nuk jua them prej ndjesisë së papërmbajtur të paradoksit: në televizor dhe kinema, shiheshin agjentë të policisë perëndimore

që qëllonin mbi manifestuesit. Nuk dua të shfaq ndonjë prirje për masovizëm, ju e kuptoni, por na dukej sikur demokracia shkonte bashkë me këto brutalitete. Të kuptohemi, bëhet fjalë për demokraci relative, jo të përkryer, por e krahasuar me regjimin tonë të nënshtruar para sekretit, kjo i ngjante progresit, përparimit.

— *Mos vallë demokracia do të niste, pra, me reklamën, tejpamësinë e shtypjes?*

— Që demokracia duhej të shmangte shtypjen, kjo dihet. Por ne nuk e kemi fjalën për absoluten, ne po flasim për një rrethanë historike. Në vendet e Lindjes, policia e dukshme merrej me qarkullimin rrugor. Ajo nuk përleshej drejtpërdrejt me kundërshtarët. Asaj nuk i kishte rënë për pjesë arbitrariteti, nëse marr guximin ta them. Ajo mbahej mënjanë. Fëmijët i quanin policët me uniformë “xhaxhi”. Polici, dhe unë nuk dua ta teproj, konsiderohej si një lloj babagjyshi i vitit të ri, domethënë si njeri zemërmirë e babaxhan.

— *Tani, ç’ardhmëri parashikoni për Shqipërinë? Cilat janë perspektivat e saj?*

— Kjo varet sidomos nga faktorë ndërko-mbëtarë.

— *Ju po prisni një ndërhyrje evropiane më të rëndësishme?*

— Po, kjo do të qe gjë e mirë. E përse t'i lije pas dore shqiptarët në dëm të popujve të tjerë të Ballkanit? Përse ta zvogëloje rëndësinë e tyre? Lipset të vlerësohet relativiteti i tyre dhe, më mirë akoma, të pranohet. Gjithsesi, nuk mund të strukemi pas ekranit të vjegullt prej tymi të dezinformimit. Ne jemi përballur me një tragjedi; që ajo të shtjellohet në mënyrë pak a shumë finoqe, nuk ndryshon shumë gjë në të.

— *Ju shprehni gjithmonë të njëjtën frikë, atë që do të konsistonte në mbytjen e një veçorie kombëtare.*

— Unë mund t'u kundërvihesha duke thirrur në ndihmë monologun e Shilokut, te *Tregtari i Venecias*. A nuk derdhin gjak shqiptarët, a nuk qajnë, a nuk qeshin? Atëherë do të qe me vend t'i mbaje si të barabartë me fqinjët e tyre...

— *Jo të gjithë shqiptarët janë të vetëdijsëm për këtë meqë një pjesë e tyre dëshirojnë të jenë të lidhur pas ndonjë fuqie të huaj perëndimore...*

— Ne jemi një komb dhe këtë s'ka gjë që ta

kundërshtojë. Që disa shqiptarë zhvlerësohen si të këtillë, po, këtë gjë e kam vënë re. Po më tej? Ata bëjnë të tyrin një qëndrim vetëvrasës. Ata marrin pjesë në mohimin e vetes së tyre dhe në këtë gjë, ata vetëm sa pasqyrojnë prirjen e nihilizmit ndërkombëtar. Ata rendin drejt humbjes së vet. Ata kërkojnë verbtazi një ujdë me botën që i flak duke u nisur nga çmimi i identitetit dhe ekzistencës së tyre.

— *A nuk mendoni që mediat ndërhyjnë në një terren të volitshëm dhe se shoqëria shqiptare është tashmë e ndrydhur?*

— Eh! Po të qe kjo, a do t'ia vlente mundimi ta flijoje? Me këtë mënyrë të vepruari, ndërgjegjja e bashkësisë ndërkombëtare po zymtohet çdo ditë e më tepër. Ajo po lejon nënshtrimin e dy milionë shqiptarëve nga serbët, aq sa këta shqiptarë janë kthyer në pengje, një farë monedhe këmbimi dhënë një Serbie të fortë vetëm me tetë milion banorë. Përse i mbyllën sytë para kësaj drame? Në emër të ç'përllogaritjeve egoiste? Përse, fundja, kjo mungesë kurajoje? Ju e dini që mua nuk ma ka fare ënda skandalin dhe, nëse po e denoncoj këtë situatë, këtë gjë e bëj ngaqë më duket thellësisht e padrejtë karshi një populli që meriton më shumë se përçmimi që shfaqet ndaj tij.

— *Sipas jush, cila do të ishte zgjidhja?*

— Zgjidhja për këtë problem? T'u jepej një shpresë atyre që nuk u ka mbetur më asnjë grimë e këtillë, atyre që u janë rrëgjuar perspektivat, t'u kthehet ai dinjitet që u është dhënë si privilegj xhelatëve të tyre, serbëve dhe maqedonasve. Me ç'të drejtë lihet të rëndojë një kërcënim mbi shqiptarët?

— *Por, fjala është për një pjesë të popullsisë që jeton jashtë kufijve të Shqipërisë... Nuk dua të them me këtë se fati i saj mund të lihet pasdore, përkundrazi, por problemi që i shtrohet Shqipërisë aktualisht, a nuk ka të bëjë pikë së pari me territorin e saj?*

— Dëgjoni. Unë mendoj që fatet e këtyre popujve janë të lidhur me trajtimin që u bëhet, në përgjithësi, shqiptarëve, si brenda dhe jashtë. Po luhet me të tashmen dhe me ardhmërinë e tyre. Po i braktisin. Po humbet çdo kthjelltësi, çdo njerëzi ndaj tyre. Më janë neveritur këto mënyra të vepruari, a thua se një arbitrazh qe taksur qysh më parë për dështim. Unë nuk kërkoj luftë. Unë kërkoj drejtësi, ndalimin e masakrave, ndërprerjen përfundimtare të torturës e çfarëdo trajte qoftë.

Unë kërkoj dinjitet. Në këtë çështje, mungon

në veçanti urtia, madje jo urtia, por mirëkuptimi. Le të pyesim rastësisht tre barinj që të jenë me origjinë nga Japonia, Kina, Islanda, Montana e Overnja, përfytyroni pastaj që të ngrihet me ta një juri të cilës t'i nënshtroheshin të dhënat e këtij problemi... Çështja do të qe zgjidhur në më pak kohë se ç'u desh për ta shtruar. Pa pasur nevojë për shumë filozofira. Shqiptarët gëzojnë një të drejtë, pikërisht të drejtën për të jetuar. Gjithsesi, bëhet fjalë për ekuilibrin e një populli gjysma e të cilit jeton në kushte absurde.

— *Mos vallë, shqetësimi juaj ka të bëjë me zhdukjen e një tërësie kombëtare, e një identiteti kombëtar?*

— Pikërisht. As të mos i kërkojmë më larg motivet e indinjatës sime. Një shkrimtar nga Kosova ka deklaruar se nuk duhej që populli shqiptar të qe popull i ndaluar, kurse, një tjetër tha këtu, në Evropë, se nuk duhej ta shihnin si një popull të tepërt.

— *Ju ngriheni, pra, kundër padrejtësisë që po godet shqiptarët. Unë mund t'ju kujtoj se ka dhe gjëra të tjera dhe që, nga kjo pikëpamje, Shqipëria...*

— E shoh qartë se ku doni të dilni. Të këqijat

e Shqipërisë përkojnë me ato të çdo populli tjetër të Ballkanit.

— *Për shembull?*

— Nuk ma ka qejfi t'i vesh Shqipërisë rolin e viktimës së veçantë. Çdo populli të Ballkanit ia ka ënda të qahet, të ekspozojë plagët, vrrajat, etj. Të gjithë kanë gjetur në historinë e tyre një fatkeqësi kombëtare, një katastrofë, mynxyra të pangushëllueshme, ngjarje të tmerrshme, kjo është e vërtetë, dhe pak rëndësi ka në këtë rast shablloni, efekti i klishesë. Kush do t'u kundërvihet këtyre fakteve? Kjo është sëmundje e popujve të vegjël.

Mirëpo, përsa i përket Shqipërisë, unë e kam fjalën për vetminë e saj dhe për mungesën e përkujdesjes që shfaqet ndaj saj. Shqipëria është dy mijë vjeçare. Është më e vogla nga këto vende të vegjël... Si për ironi të historisë, gjatë këtyre dy mijëvjeçarëve, Shtetet Ballkanike janë zgjeruar, me përjashtim të Shqipërisë që në një farë mënyre është tkurrur. Dhe pikërisht Shqipëria përbën problem dhe cilësohet, në këtë rast, ekspansioniste...

— *Në disa mjedise, akuzohet sidomos demografia e saj...*

— Është e vërtetë që shqiptarët kanë një

demografi pozitive. A përbën kjo arsye të mjaftueshme për të ngritur padi ndaj tyre? Askush nuk i bën vetes pyetjen për të mësuar përse Shqipëria është i vetmi vend në rajon me prodhim aq të pakët në raport me fqinjët e saj. Më 1821, kur Greqia fitoi pavarësinë, ajo nuk numëronte as një milion banorë. Sot, ajo ka dhjetë milionë.

Unë për vete, e marr me mend urrejtjen e serbëve që përhapin marrëzi të këtilla, urrejtje për fëmijët shqiptarë. Po përfitoj nga rasti për t'ju thënë se të vetmit fëmijë të Evropës, të pavaksinuar ndaj sëmundjeve foshnjore, janë pikërisht fëmijët kosovarë. Ata janë lënë jashtë sistemit shkollor. Instancat shëndetësore heshtin në këtë pikë e megjithatë...

Është zbuluar që fëmijë të Kosovës i kanë helmuar më 1989 me gaz. Është kryer hetim. Specialistë nga mbarë bota kanë ndërmarrë analiza, por nuk është rënë në një mendje rreth përfundimeve.

— *Në ç'përmasa?*

— Gjysmë për gjysmë. Ky ndryshim vlerësimi ka mjaftuar për ta mbyllur procesin. Qe ngritur një dyshim i ligjshëm. U hoq arbitrarisht.

— *Po ju, Ismail Kadare, ç'mësim nxirrni nga kjo?*

— Unë shoh në të një shkallëzim makabër: helmim masiv, përzënie nga shkolla, mungesë vaksinimi, por e gjitha kjo na çon te internimet dhe shkurt, te masakrat.

— *Ju, pra, kërkoni për Shqipërinë një vëmendje shtesë deri diku shpërblyese?*

— Unë nuk po kërkoj asgjë të jashtëzakonshme. Kur Rusia s'pranon të lërë dy kilometër katror nga territori i saj, kjo gjë nuk skandalizon askënd. E megjithatë kjo Rusi është gjiganteske, e përbindshme...

Ndërsa, kur është fjala për Shqipërinë, atëherë prit!! Pretendimet e saj për të rifituar integritetin e vet cilësohen si të rrezikshme. Por, ta themi midis nesh, cilat do të qenë pasojat?

Shqipëria do të kishte shtatin e Sllovakisë dhe mos vallë, do të përbënte rrezik? Për kë dhe ndaj kujt? Juve po ju pyes! Flitet për Rusinë “e madhe” si për një dukuri të natyrshme dhe duket normale që ajo të mos lëshojë asnjë pëllëmbë truall.

— *Gjithsesi, ajo e bëri këtë gjë.*

— Në mënyrë krejtësisht mashtruese. Kush e tepron me këto lëshime? Naivët apo cinikët që mbajnë veshur petkun e padjallëzisë? Ballkani ka

nevojë për një arbitrim ushtarak, historik, ekonomik dhe po e përsëris, para së gjithash moral.

— *Ismail Kadare, po jua bëj sërish pyetjen: A ka të ardhme pozitive për Shqipërinë?*

— Evropa duhet të përkushtohet në një shkallë më të lartë e sidomos në gjithë Ballkanin. Për mua, kjo është masa parësore e domosdoshme nëse dëshirojmë t'i çdramatizojmë të gjitha këto mite etnike. Për mendimin tim, nuk mund t'i mbajmë në mbikqyrje serbët pa u përkujdesur për shqiptarët. Nuk mund të tolerohet e patolerueshmja: mbyllja e shkollave shqiptare në Kosovë duhet të kishte çuar jo vetëm në mospëlqim, por edhe në ndërhyrje zyrtare. Kjo të shtyn të besosh që për Shqipërinë nuk ia vlen të ngresh as gishtin e vogël.

A nuk kanë evropianët shkolla në gjuhën e tyre? Unë nuk kam asgjë kundër alfabetit cirilik, por alfabeti latin është pikërisht ai, me të cilin ne shkruajmë gjuhën tonë. Nuk e kam fjalën këtu për epërsinë e tij, thjesht po jap një fakt konkret të rrafshit kulturor dhe për pasojë identitor. Bëhet fjalë për kujtesën tonë. Në emër të ç'gjëje do të mund të dëmtohej, të cungohej? A u kërkohet irlandezëve që ta këmbejnë alfabetin e tyre me ku e di unë se ç'ideograma? Evropa që përpiqet të mbrojë vlerat e qytetërimit perëndimor, përse e

lejon një agresion të këtillë, i cili prek themelet e një populli? Përse të lejohet që një pjesë e shqiptarëve të kthehen në majmunë diturakë, të cilët do ta përqeshnin historinë e vet me një shkrim të huajtur dhe, për më tepër, të imponuar?

Ju duhet të më kuptoni. Në vendin nga rridhni ju, Denis Fernandez-Récatala, ekzistojnë media që shprehen në gjuhët vendase edhe pse janë me prejardhje latine, me përjashtim të gjuhës baske. Bukur, pra, shqiptarët kudo ku gjenden, nuk kërkojnë më tepër. Ata thjesht dëshirojnë që t'u vihet veshi e jo t'i marrin përdore.

— Përsa i përket Spanjës, Ismail Kadare, respektimi i gjuhëve të ndryshme, nuk ka ndodhur pa hasur një mori problemesh. Shteti qendror është mbrojtur për një kohë të gjatë...

— U mbrojt apo jo, megjithatë ia doli mbanë, në fazën e tij demokratike, të njëjtte ekzistencën dhe të përkrahte përdorimin e gjuhëve të ndryshme nga gjuha mbartëse, ajo që quhej dikur gjuha perandorake. Të gjitha gjuhët perandorake dobësohen. Sa më shumë fuqizohet perandoria, aq më shumë gjuha e saj kthehet në ligjërim administrativ dhe, për pasojë, aq më tepër shpërftyrohet. Vetë, gjenialiteti i Dantes e rroku këtë gjë. Ai qëmtoi gjuhën “e rëndomtë” sepse nuk u kënaq me një gjuhë të ngrirë që po venitej,

paçka se ajo nuk reshtëte së nxituri farfuri, por një farfuri që, po ta kqyrim hollë-hollë, është e vjetëruar, me palëzimet e ngrira në angrrat e saj.

— *A e kishte humbur latinishtja rrjedhshmërinë e saj?*

— Ajo pat humbur një pjesë të kuptimit, po të vërejmë që, në parim, ajo ishte taksur për numrin më të madh. Shteti andej kish kaluar. Ai ia nënshtronte gjuhën disa formulimeve elementare. Dhe italishtja ia vlen si shembull. Prandaj, unë ~~këmbëngul në faktin që t'i heqësh një populli përdorimin e gjuhës së vet, është një lloj si t'i cungosh jo vetëm trashëgiminë, historinë, kulturën e tanishme, por edhe t'i gjymtosh aftësitë shpikëse, një kahje të prirur kah ardhmëria...~~ Ky është krim kundër intelektit, domethënë kundër njerëzimit. A nuk shprehej pikërisht Lautréamont-i që: “Gjithë ujët e detit nuk do të mjaftonte për të fshirë një njollë gjaku intelektual”?

— *Shumë e saktë Ismail Kadare, ne shkoqitëm kështu një mori çështjesh, disa të lehta a të rënda, disa të tjera më shqetësuese. Si ia dilni ju mbanë, sot, për të duruar këto teprime, këto çakërdira?*

— Unë po përjetoj një dukuri të çuditshme: Bën vaki që unë të mos kem qenë kurrë kaq i lidhur

me popullin tim, sa këto vitet e fundit. Jam shndërruar në bashkëfajtor, domethënë që, pa dyshim, nuk kam përjetuar asnjëherë kaq bashkëfajësi me të. Unë kam një mjedis. Pres miq, të njohur e megjithatë ndihem i vetmuar. Mos pandehni se kjo është thjesht ndonjë koketëri nga ana ime. Jo, kjo gjë është e vërtetë. Unë njësohem me vetminë, me vetminë e shkrimtarit të pushtuar nga një lloj “çsolidarizimi”.

— *Me kë a me çfarë?*

— Me veten time, ndoshta, i pushtuar nga dyshime dhe i rrëmbyer nga ankthi ndaj reales, me të cilën kacafytem, gjithsesi. Në mos qoftë pesha e kujtesës që të më shtypë e të më përzërë nga vetja, ku ta dish? Unë jam këtu, midis të tjerëve dhe sikur s’jam. Çfarëdo qoftë, mbetet vetëm kjo ndjenjë vetmie e pacak dhe e pashpjegueshme, sikur të mos kisha më bashkëbisedues për t’iu drejtuar. Të qenurit i lidhur me një popull, çon tek kjo kureshtje, te një dyvlerësi: jo me të dhe, njëherësh, i flakur në një hapësirë shkretane. Çuditërisht, kjo vetmi përcillet tek të tjerë, të cilëve u duket e natyrshme:

“Shkrimtari është fillikat...”

— *A nuk është vetmia një prirje për shkrimtarin?*

— Pa dyshim. Do t'ju tregoj një anekdotë. Vajza ime është gjeneticiene. Aty pari mori pjesë në një kongres gjenetike. Gjatë ballos në mbyllje të kongresit kërcente me njërin prej kolegëve të saj brazilian. Ky e pyeti se me ç'prejardhje qe. Ajo iu përgjigj që ishte shqiptare. Braziliiani, si shumë njerëz të tjerë, as që dinte gjë, thujse fare për Shqipërinë. Mandej, se ç'i shkrepri, dhe klithi: “Shqipëria? Ah! Di diç për të... Di emrin e diktatorit të saj: Ismail Kadare”. “Ky është im atë, u përgjigj ime bijë, është shkrimtar”. Kjo ndodhi imtësore më duket domethënëse. Një i panjohur ka bërë të bashkëjetojnë e mira dhe e keqja tek një shkrimtar. Nën petkun e famës e të gabimit, ai pohoi një të vërtetë që të kall tmerrin, apo jo?

BISEDA E DHJETË

(5 maj 1999)

Takohemi në apartamentin që më është bërë tashmë i njohur. Ismail Kadareja më pret si zakonisht. Si përshkojmë korridorin ndalemi para zyrës së tij. Tryeza është e mbushur me faqe sprovash në korrigjim e sipër. "Jam vonë. Nuk di nëse do t'ia dal mbanë në kohë". Ton keqardhës që shpreh shqetësim. Ismail Kadareja më tregon në fakt një pjesë nga vepra e tij e plotë në shqip. Janë radhitur fletët, disa stivë. Ngutja nuk do të thotë çrregullsi.

Përsa i përket librit tonë të bisedave, jemi në të njëjtën pikë. E përfunduam dhe rilexuar me imtësi, jo pa mëdyshje, ndërkohë që po shpërthenin operacionet e spastrimit etnik në Kosovë.

Në secilin nga takimet tona, seancat ndërpriteshin përpikmërisht nga emisionet televizive të lajmeve, me një farë pikëllimi që na trondiste dhe ishte fjala për diçka krejt të ndryshme nga

shfaqja e një dhembshurie a keqardhjeje e padallueshme, fillestare që mund ta mbartnin brenda vetes për ligjën e vet. Dua të them që ne nuk qemë përfshirë nga një ndjesi kënaqësie, sajësë e asaj filantropie në modë që pikaset me ndodhinë më të vogël për të shpalosur ndyrësinë e vet, por më së shumti nga një revoltë e ftohtë, e heshtur, pothuajse e dëshpëruar nga e cila brofnin ngulçe, pasthirrma dhe psherëtima.

Vështrimet tona mbeteshin të ngulitura në ekran, nuk guxoj të them të mbërthyera, e megjithatë... Kur na qëllonte të flisnim, në më të shumtën e herës, e bënim këtë gjë pa u larguar nga pamjet e një popullsie që shpërngulej, endej dhe grumbullohej nëpër pikëkalimet kufitare të vendeve fqinje, para se të vendosej nëpër kampet e sajuara që mbusheshin përplot në çast, çka dukej sikur ilustronte atë fjalë të përmendur nga Ismail Kadare: “Shqiptarët janë popull i tepërt...”

Dëgjonim dëshmitë e hidhërimit shkaktuar nga ~~merri~~ Unë për vete, isha i befasuar prej këtij eksodi me zetorë e rimorkio që mbartnin familje e ndonjë grumbull plaçkash. Përveç qytetarëve, ndër ta kishte sidomos blegtorë, barinj e bujq që largoheshin sikur të kishin për armë vetëm mjetet e tyre të transportit...

Nuk ka përse të teprohet përshtypja që ngjallnin këto pamje të një pafajësie të persekutuar. Edhe patosi do t'i përgjigjej vetëm të

vërtetës...

Po shtoj që përfytyrimi — pamja, në këtë rast, është një fjalë tepër klinike — i grupeve të grave, fëmijëve e pleqve të dërrmuar nga lodhja dhe duke ikur nëpër borë prej xhelatëve, më sillte ndër mend kujtime mallëngjyese: kapërcimin e Pirenejve, në shkurt të 1939, prej një ushtrie të shpartalluar shoqëruar nga një eksod qytetar i republikanëve spanjollë. Libri ynë i përpiluar në një lloj kohe të humbur, përkonte tejet saktësisht me krimin që po kryhej pothuajse para syve tanë.

Herë-herë, ne habiteshim nga fjalët e thëna prej ish-disidentësh të komunizmit, të cilët, befas, për shkaqe që nuk përfillnin as arsyen, as moralin, shpreheshin në përkrahje të Millosheviçit dhe të një Serbie me veprime që mund të faleshin, meqë ajo pat qenë aleate e Francës dhe se ishte sllave dhe e krishterë. Spastrimi etnik, thjesht dhe qartë qe gëlltitur ose qe nënvleftësuar.

Ismail Kadareja zemërohej, shfrynte herë-herë, fytyra i zymtësohej... Zonja Kadare na afrohej: lemëria na linte pa mend dhe na pushtonte mërzia.

Kjo bisedë e fundit u zhvillua gjatë rileximit të radhitjes në dorë të parë. Ismail Kadareja saktësonte në çast mendimin pa e mohuar asnjëherë: ai qe skalitur në kohën e ligjëritimit dhe atij as që do t'i shkonte në mendje t'ia ndryshonte brendinë me qëllim që t'i thjeshtonte ndërlikimin,

t'i ngrinte, me këtë rast, rrjedhshmërinë, një lehtësi të cilën e patëm synuar kasten pa dashur ndërkaq t'ia cënojmë thellësinë. Ne nuk na i ka patur kurrë qejfi ta rindërtojmë një libër. I kemi qëndruar përpikmërisht të vërtetës së atyre fundpasditeve.

Synimi ynë ishte të pasqyronim një mendim në ecje, ashtu siç nuk ngurruam të ndër marrim një dialogim të mbramë duke përtërirë një gjendje, goftë dhe të përkohshme, lidhur me pikpamjet e Ismail Kadaresë për çështjen e Kosovës...

*

DENIS FERNANDEZ-RÉCATALA: Ne jemi më 5 maj 1999. Në parim e kemi përfunduar librin... Korrigjimet përmbyllëse u bënë gjatë këtyre javëve të fundit, ndërsa represioni serb në Kosovë është rritur. Qindra mijëra refugjatë kosovarë strehohen nëpër çadrat e ngritura për ta në vendet fqinje. Të tjerë, edhe më të pafat, iu larguan masakrave dhe enden nëpër pyje. Avionët e NATO-s po e bombardojnë Jugosllavinë qysh prej tashmë pesë javësh pa rezultat ushtarak bindës. Aspekti pozitiv ka të bëjë më së shumti me vendosmërinë e saj për të penguar kryerjen e një spastrimi të ri etnik dhe për të mbështetur kthimin e kosovarëve në vatrat e tyre. Diplomacia po bën në vend numëra. Evropa s'di ku është... Ne kemi vënë re

*që kjo përmbledhje bisedash është përmbushur
nëpër vite luftime. Cili është përjetimi juaj sot?*

ISMAIL KADARE: Shqetësimi im në lidhje me kosovarët i tejkalon, për së largu, këto vitet e fundit plot zhurmë, marrëzi e krime. Këtu e shtatë vjet më parë, po në të njëjtën ditë, u kam nisur katër letra, më datë 10 dhe 12 shtator 1991, përkatësisht Xhorxh Bushit, Fransua Miteranit, Vaclav Havelit dhe Papa Gjon Pali II. I shkrova këto letra me synim shmangien e një masakre në Kosovë.

— Por, masakrat në Kosovë nuk ishin ende në rend të ditës, nëse mund të shprehem kështu?

— E keni gabim: serbët i kishin ndërmend, madje e kishin tashmë gati projektin. Dua të them që nuk u shkrepri rastësisht në kokë: shteti kriminel serb i kishte programuar dhe unë vazhdoj të jem i bindur se shërbimet e fshehta perëndimore qenë në dijeni.

— Millosheviçi e kishte marrë ndërkaq pushtetin...

— Pikërisht, dhe përgjegjësia e tij është e hatashme. Ai çoi gjer në skaj një plan që ekzistonte tashmë.

— *Ai ia acaroi efektet?*

— Që ç'ke me të... Në një farë mënyre, ai ia dhjetëfishoi përçudnimin, Ilahtarinë e papërfytyrueshme. Dhe, marr guximin ta pohoj, se është turp për Serbinë, për një të ashtuquajtur qytetërim serb që t'i hyjë barbarisë, që të mburrë ide të zymta...

— Obskurantiste...

— Pikërisht... Këto mendime kriminale, më diaboliket që mund të përfytyrohen, kanë ekzistuar prej vitësh në këtë vend; mendime që nazistët i nxitnin karshi çifutëve, madje nuk e teproj për hir të kësaj situatë, por bëhet fjalë për shfarosjen e një populli nga faqja e dheut.

— *Por këtu e dhjetë vjet para luftës së Bosnjës, kush e dinte?*

— Ju doni të thoni: kush nuk e dinte? Dhjetëra intelektualë perëndimorë e dinin, po kështu dhe dhjetëra gazetarë. Secili prej tyre ishte në gjendje të pikaste ëndjen "galduese" të serbëve që shfaqnin haptas dëshirën për të asgjësuar shqiptarët.

— *Mos vallë ngaqë mendojnë se shqiptarët e Kosovës përfaqësojnë një kryeurë myslimane në*

Evropë?

— Pikërisht kështu ua ka ënda t'i paraqesin kosovarët, por t'i kufizosh shqiptarët e Kosovës, në këtë karakteristikë fetare bie ndesh me të vërtetën. Ç'ngjet, atëherë, me pjesën e tyre katolike? Jo! Fjala është për tjetër gjë, për diçka më të thellë, thjesht për urrejtjen ndaj shqiptarit dhe jam i bindur se urrejtja ndaj shqiptarëve katolikë është edhe më e thellë se ajo e shprehur ndaj myslimanëve. Këtë gjë dëshmuar serbët dhe unë mund të sjell prova.

— *Në Pejë, bie fjala?*

— Sigurisht që në Pejë. Peja është qytet katolik. Ajo që ndër të parat që u braktis e s'akateps. Ua lanë në dorë shkumbuesve. Duhej me çdo kusht, sipas logjikës serbe, të vërtetohej që në Kosovë, nuk kishte katolikë. Duke manovruar kësisoj serbët sajonin një gënjeshtër që Perëndimi ishte gati ta besonte.

— *A ka qenë Shqipëria fuqi katolike?*

— Fuqi, nuk di ta them, por që ka qenë e ndikuar thellësisht prej katolicizmit, këtë po. Po përmend si dëshmi kalanë mijëvjeçare të Beratit që përmban "intra muros" njëzet e tetë kisha.

— *Kjo ngjan si krejt e paditur...*

— Dhe arsyeja: në atë epokë me brufulli pamjesh, asnjë reportazh nuk u bë atje. Kjo është e pabesueshme. Shabllonet janë të paepur. Dhe asnjë nuk i bëri vetes pyetjen, lidhur me faktin që shqiptarët kanë zgjedhur si hero kombëtar, si hero absolut, të pakundërshtueshëm, Gjergj Kastriotin, të quajtur Skënderbe, një princ katolik i Mesjetës, emërtimi zyrtar i të cilit ishte “zot i Shqipërisë, mbrojtës i Krishtit”. Asnjë nuk e ka pikasur këtë veçanti.

— *Mund t’ju kundërviheshin që tanimë kjo veçanti ngatërrohet më së shumti me një traditë sesa përkon me ndonjë bindje.*

— Çfarë doni të thoni? Që tradita qenka pa pasoja, pa domethënie ngaqë i ka rrënjët në kohë të largëta? Atëherë, thomëni përse heshtet që kryetari i shtetit të krijuar në fillim të shekullit XX, kryetari i shtetit shqiptar më të dashur, më i ndrituri, Fan Noli, përkthyes i Shekspirit e Servantesit, ishte një arqipeshkëv ortodoks? Përse fshihet që krishtërimi është i dëshmuar në Shqipëri? E për t’i dhënë fund kësaj çështjeje, nuk po përmend këtu figurën e përsëpirtshme e aq të shquar të Nënë Terezës, fetarja katolike me mision në lagjet me baraka të Indisë dhe simbol i parapëlqyer i shqiptarëve, të çdo feje qofshin... A

nuk japin këto fakte, përgjigjen më të mirë pyetjeve tuaja?

— *Ismail Kadare! Me se e lidhni ju këtë spastrim etnik? Me dëshirën serbe për ekspansion a me ndonjë lajthitje të politikës së ndjekur nga Millosheviçi?*

— Unë do të doja të nënvizoja naivitetin tuaj në këtë rast, por le ta zëmë se naiviteti juaj më nxit të saktësoj pozicionin tim. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një mpleksje të të dyjave. Ndoshta njëra nuk bën dot pa tjetrën. Ju e keni vërejtur shpesh në Histori, ka popuj që funksionojnë çift, domethënë me një popull rival. Ballkani nuk i shpëton dot këtij rregulli. Për serbët, janë rivalë kroatët e sidomos shqiptarët.

— *Ju bëni fjalë për këtë gjë te Kamarja e Turpit...*

— Po, dhe në tekste të tjera, në shkrime ku përvijoj historinë e këtij rivaliteti. Duhet t'i hysh kërkimit të rrënjëve të thella të pashërueshme nga urrejtje të këtilla. Ballkani është një zgafellë plot me urrejtje, xhelozzi absurde dhe dëshira revanshiste. Për fatin e keq të Shqipërisë së sotme, është fakt që Perandoria osmane ka qenë e detyruar t'u japë funksione të rëndësishme shqiptarëve, bie

fjala, ofiqin e vezirit të madh, i cili nuk mbulonte vetëm drejtimin qeverisës, por edhe detyra në drejtimin e ushtrive dhe këto funksione janë ushtruar në mënyrë dinastike, për një shekull.

— *Kjo flet mjaft për vendin që zinte Shqipëria.*

— Ta pret mendja, sepse me detyrën e kryeministrit, lidhej një administratë e tërë ku përfshiheshin me qindra pjesëtarë. Shqiptarët kishin në dorë emërimin e gjeneralëve, ministrave, qeveritarëve. Shkurt, po jua kujtoj edhe një herë, shqiptarët ishin të fuqishëm në Perandori, aq sa një ditë prej ditësh, e si krejt rastësisht ata themeluan dinastinë mbretërore egjiptiane, Mehmet Ali, etj. Për shekuj me radhë këto aftësi ushqyen mërinë serbe, xhelozinë e tyre ndaj shqiptarëve.

— *Ju mendoni se serbëve u është përndezur ndonjë prirje revanshi?*

— Në fakt, atë mendim kam. Kjo frymë revanshi ka ndjekur udhë torturose. Nuk ka qenë dhe aq e sigurt. Ndryshe si të shpjegohet situata aktuale... Në atë epokë, shqiptarët konsideroheshin në mënyrë të rreme nga popuj të nënshtruar si zotër të Ballkanit, ndërkohë që serbët ishin vetëm shërbëtorë.

— *Mos doni të thoni që ata do të kompensojnë një poshtërim?*

— Ata gjendeshin në situatë të poshtëruarish e të fyerish. Ata ishin nënshtruar. Asnjë popull nuk e meriton një kusht të këtillë dhe ky kusht i ka çuar gjer në atë pikë sa emri i tyre të rrjedhë nga “serf” (bujkrob, shënim i përkthyesit), ashtu siç “sllav” rrjedh nga “skllav”. Ata kanë grumbulluar një mllef dhe trashëguar mërira që shprehen sot. Nuk po shkoj deri atje sa të përmend Frojdin dhe traumatizimet e pësuar gjatë fëminisë, por megjithatë, gjithçka duket pak a shumë kështu dhe madje disa gjëra që, gjatë do të ngjasonin qesharake marrin në Ballkan, kumbim tragjik. Kështu ngjet edhe me emërtimin e popujve. Unë sapo përmenda fjalën “serbe”, “serf” (bujkrob, shërbëtor); për të cilën shqiptarët nuk janë përgjegjës. Ky emërtim, kontraston me cilësimin që i bashkëngjitet Shqipërisë: “vendi i shqiponjave”.

— *Mos po bëni psikologji publiku?*

— Përse jo? Kjo më lejon të jap një shpjegim të cilit nuk i mungon forca bindëse, apo jo? Serbët janë keqtrajtuar dikur dhe, tani që e pandehin veten sundues, kërkojnë të ushtrojnë pushtetin e tyre mbi

një popull të pakësuar në numër. Ata po riprodhojnë egërsitë, viktima të të cilave kanë qenë dikur vetë. Ata përmbysin rolet dhe hiqen tanimë si zotër. Ja pra disa motive të mjaftueshme për masakra.

— *Por këto masakra e kapërcejnë kuadrin e një nënshtrimi të thjeshtë. Ato synojnë një spastrim etnik...*

— Kjo gjë është e vërtetë, serbët po shkojnë më larg. Marrëzitë e tyre, me fjalë më të buta, ia kalojnë veprimeve të nazistëve në gadishullin ballkanik. Në dhunën e tyre, ka diçka të papërfytyrueshme sot. Ata përdhunojnë gra, vrasin fëmijë, masakrojnë djem të rinj. Vendosmëria e tyre është e lemerishme. Të bën të besosh që ata dëshirojnë të zhdukin çdo mundësi mbijetese, madje çdo fije jete. Atyre nuk u mjafton përzënia e një populli, shpërngulja e tij nga trojet e veta...

— *Ju nuk mund të mos e dini që, për shumë njerëz, krahasimi me nazizmin duket i papërshtatshëm, për të përdorur një fjalë në modë.*

— I papërshtatshëm për kë? Për pulat e lagura? E ç'dinë nga ajo që po ngjet në Kosovë? Kur të mund të shfaqen provat, Përndimi do të tmerrohet prej tyre. Nazistët e industrializuan

tmerrin, kjo është e pamohueshme, kurse serbët e çuan akoma më tej. Nuk është fjala vetëm për mbretërimin e cinizmit, por të një egërsie pa fre, një shtazëri kanibale. Theren njerëz në sy të familjes së tyre, gjymtohen fëmijë, po e përsëris, dhunohen gra, u çajnë barkun kur janë shtatzëna dhe vriten burra pranë nënave dhe baballarëve të tyre. Unë nuk i përjashtoj nazistët nga krimet që kanë kryer: ata janë të pashoq e të pashkyeshëm, por krimet serbe, sado artizanale të na duken (thika, sëpata, etj.) nuk mbeten pas dhe duke thënë këtë, nuk dëshiroj të paraqes ndonjë konkurrencë midis viktimave të serbëve dhe nazistëve. Unë uroj të shpërfaq veçantinë e një krimi në gjithë mizorinë e tij...

— *Megjithatë, Ismail Kadare, këtij mijë-vjeçari, sidomos këtij shekulli nuk i kanë munguar tmerret...*

— Është e vërtetë, dhe pikërisht kjo egërsi është e papranueshme, si në Afrikë ashtu edhe në Evropë, e ndoshta në Evropë ca më shumë, po të shohim të kaluarën. Po ju pyes juve: kujt mund t'ia priste mendja që Evropa do të ishte ende teatër i mizorive të ngjashme, i barbarizmave të këtilla të bëra nga një popull që e quan veten mik të Perëndimit, që mburr krishtërinë e tij, që shpalos kulturën e vet me festivale kinematografike,

pikturë, muzikë, etj. Po përdoren argumenta të dyshimta, por ruandezët bie fjala, nuk struken pas ndonjë morali! Ata nuk ishin të prirur pas hipokrizisë dhe nuk shtereshin për ndonjë humanizëm. Vepronin si kriminelë pa ndjesi shpirtërore. Madje dhe serbët, veçse duke u paraqitur me petkun e të keqtrajtuarve të mundshëm prej Historisë, sikur Historia po ia falte të gjitha paudhësitë. Traktati i Versajës ka qenë i padrejtë për gjermanët. A i përlligj dot kjo padrejtësi kampet e përqendrimit? Dhe, sigurisht, unë nuk i krahasoj serbët me nazistët në planin e organizimit. Unë veç po mbetem, nëse mund ta them, te egërsia, te ajo shtazëri që do ta cilësoja si të drejtpërdrejtë... Nga një pikëpamje, serbët e kanë dendësuar krimin në këtë fundshekulli.

— *Unë nuk do të doja të polemizoja (kjo gjë nuk ka dhe aq lidhje); por Shah-u mbetet unik...*

— Me siguri, dhe mund të jem shpjeguar keq po që se keni kuptuar sikur unë e njehësoj masakrimin e kosovarëve me genocidin çifut. E kisha fjalën për një egërsi të paparë në kontinentin tonë.

— *Si kështu?*

— Po thërras në ndihmë mitologjinë me

qëllim që të merremi vesh më mirë. A ju kujtohet dyluftimi i Akilit me Hektorin te *Iliada*? Kur Akili po bëhej gati ta vriste Hektorin, ky i fundit i lutet të mos ia gjymtojë fytyrën pas vdekjes. Përse? Për të mos shkaktuar ndarje mes njeriut të gjallë që është ende dhe të vdekurit, siç do të jetë më pas. Në Antikitete, jetohej me të vdekurit. U duhej ruajtur trupi, duheshin respektuar për të mos e këputur zinxhirin e komunikimit me ta. Kjo është temë e një mori baladave ballkanike: “Mos më gjymtoni pas vdekjes...”

— *Më duket, po e kuptoj. Ju jeni të mendimit se dhunimi që u bëhet kosovarëve, gjymtimet që pësojnë ata në trup, i çojnë dora-dorës kah ajo prirje që quhet shfarosje?*

— Kjo është. Të vrasësh e të gjymtosh kosovarët, përbën një shfarosje të rënduar. Të shpërftytyrosh të vdekurit, do të thotë për më tepër t’u heqësh identitetin. Duke u prishur tiparet, xhelatët fshijnë gjurmët e viktimave të tyre aq sa zor se mund t’i njohin qoftë dhe të afërmit, prindërit a miqtë e vet. Vrasja nuk mjafton. Përtej vdekjes, u hiqet dhe ajo pjesë e ekzistencës e ruajtur nga ana pamore. Pikërisht në këtë kuptim, e kam fjalën kur ju them barbari e paparë, sepse edhe kodi i drejtësisë kanunore shqiptare, i cilësuar si barbar duke u nisur nga arsyet (sipas

meje, ai është më së shumti primitiv, i ftohtë e tragjik), është më pak mizor sesa krimet e bëra në shekullin XX.

— *Cilët lloj krimesh keni parasysh?*

— Së pari, e kam fjalën për krimet e përbashkëta, krimet masive, por edhe për krimet individuale. Unë po flas për to pareshtur këto ditë... Shqiptarët e kishin kodifikuar hakmarrjen. Kjo ju befason sepse ky aspekt i kodit ju duket arkaik, dhe ai është i këtillë pa pikë dyshimi. Nuk ma ka ënda të diskutoj për këtë. Por neni kryesor i këtij kanuni emërtohet "Gjaku", e thënë ndryshe, vrasja. Ky kod parashihte një gjakmarrje, në rast hësmërie midis dy palësh por kur kjo ligjërohej. Një gjakmarrje së cilës mund t'i përgjigjej një tjetër gjakmarrje. Në rast gjysmë-gjaku (plagosje, etj.) kodi parashikonte, si shpagim, gjysmë-gjakmarrje. Dhe kjo gjakmarrje, e qëruar, e ligjëruar, duhej të kryhej në largësi. Ishte e ndaluar të prekej kufoma e hasmit a e kundërshtarit, si para, ashtu edhe pas vdekjes.

M.M. Ver

— *Mos doni të theksoni që kodi shqiptar bënte pjesë në rrjedhën e kulturës ballkanase, të ilustruar kryesisht prej Greqisë?...*

— Dua të theksoj sidomos që ky popull, sot i

persekutuar, domethënë njëherësh i përndjekur e i shtypur, i përzënë, i shfrytëzuar, se ky popull e ka rregulluar hakmarrjen për t'u mbrojtur nga masakrat, ndërkohë që shekulli XX e ngriti masakrën në kulm... Pikërisht, kështu duhen kuptuar fjalët e mia në lidhje me serbët; aktualisht ata po e vulgarizojnë masakrën dhe mizoria e tyre po arrin në zenit...)

— *Ju po thoni serb-“ët”...*

— Them serb-“ët”, sepse urrejtja që ata shpalosin dhe dhuna që ushtrojnë është mbarë-popullore, e përgjithshme. Kurrë nuk është parë një etje e tillë për gjak. E marr me mend sesa zemra të ndjeshme po prek duke thënë që përgjegjësia e serbëve është kolektive, por si mund të pohoja të kundërtën a ta tjetërsoja mendimin tim kur ky mendim përkon me të vërtetën? Në Beograd, qysh prej dhjetë vjetësh, serbët shpërthejnë shampanja kur marrin vesh mizoritë e shkaktuara nga trupat e tyre, policia a skuadriljet e vdekjes, këto milici famëkeqe paraushtarake, ndaj shqiptarëve. Mos mendon që ky qëndrim shtazarak, a ngadhënjim kafshëror të më sjellë ndonjë justifikim, ndonjë argument të veçantë kundër serbëve? Ai më ligështon dhe më bën të dyshoj, herë-herë, për njerëzimin...

— *Ju druani se mos kjo llahtari shtrihet më tej?*

— Për mua, nëse nuk është ndërmarrë asgjë për të penguar këto akte dhe pasojat e tyre, krimin e spërkatur me shampanjë, kjo do të thotë se botës po i kanoset fundi. Përbindëshi, për të cilin flet Gjoni në “Apokalipsin” e vet ka ngadhënjyer shumë. Prandaj është urgjente t’u jepet fund këtyre vuajtjeve...

— *Pa vendosur në të njëjtën shkallë barazie martirin e popullit kosovar dhe fatin e popullatës civile serbe, ç’mendim keni ju për viktimat e bombardimeve të NATO-s?*

— Unë ju falenderoj që nuk bëni paralelizma midis të parëve dhe të dytëve sepse, ne jemi në një mendje se nuk ekziston masë e njëjtë midis asaj çka pësojnë kosovarët dhe asaj çka “meritojnë” serbët...

Dëgjoni, nuk kam për të bërë hipokrizi... Unë nuk i kuptoj njerëzit që vendosin në një shkallë barazie bombardimet dhe masakrat në Kosovë. Me sa di unë, në historinë e njerëzimit nuk ka ekzistuar kurrë, ndonjë masakër e dobishme, “pozitive”. Ndërsa bombardime të nevojshme, po. Bombardimet kanë qenë të dobishme për të shtypur makinën hitleriane të luftës gjatë Luftës së Dytë

Botërore. Po vërej se ekziston një solidaritet serb thuajse sëmurës, një solidaritet që mpiks — e qëllimisht po përdor këtë folje — gjithë një bashkësi kombëtare, çfarëdo që të bëhet në emrin e saj.

Gjatë këtyre viteve të fundit e më saktësisht, gjatë këtyre javëve të fundit nuk më kanë dëgjuar veshët që serbë të protestojnë ndaj asaj që po ngjet në Kosovë, ca më pak të pikëllohen për fatin e kosovarëve. Unë e kam zgjedhur kampin tim, atë të të dobtëve dhe nuk kam përse të provoj dhembshuri të rreme për vrasësit e bashkëfajtorët e tyre të hapur a të hamendësuar. Këta të fundit për të cilët do t'ia kënda shumëkujt që unë të derdhja ndonjë lot krokodili nuk i fshikullojnë udhëheqësit e tyre në këtë pikë, edhe nëse u kundërvihen. Ata nuk i dënojnë vrasjet, as shprehin qoftë dhe keqardhje për to.

— *Për ju, a nuk kanë të gjitha vdekjet të njëjtën rëndësi?*

— Përse po më flisni? Për të pafajshmit?

— *Për shembull...*

— Mirë, pra! Në fakt, të gjitha vdekjet nuk janë të barazvlefshme. Nuk mund të krahasohet një masakër fëmijësh, një masakër e paramenduar,

me pasoja aksidentesh, sado të dhimbshme qofshin. Nga kjo pikëpamje, simetria nuk është e udhës dhe ata që e bëjnë këtë gjë kryejnë një gabim të rëndë kapërthyerjeje... Vdekja e komanduar me një synim shfarosjeje nuk është e barazvlefshme me vdekjen rastësore. Në njërin rast vetëdija cënohet, morali vihet në dyshim, një moral që do ta marrë veten me shumë vështirësi. Në rastin tjetër, vetëm rastësia është fajtorë. Këto dy fatkeqësi nuk kanë të njëjtën peshë. Nuk duhen ngatërruar piknikët dhe luftërat...

Stalini internoi popuj të tërë — dhe ky nuk është një rast të cilit do të doja t'i referohesha, por ky internim nuk u shoqërua me masakra. Për më tepër, bëhej çmos, qoftë edhe nën sundimin despotik të Stalinit të gjendeshin motivet e këtyre krimeve: arsye shtetërore për gjermanët e Vollgës, arsye politike për kaukazianët, rrena klasore për të tjerët... por çfarë t'u qortosh kosovarëve? Ata nuk janë cytur me askënd. Ata vetëm kërkojnë të jetojnë rehat në shtëpitë e tyre. Ky është një parashtrim minimal, apo jo?

— *Le t'u rikthehemi mësimëve që nxirren nga kjo tragjedi. Çfarë zgjidhje tjetër shihni ju për të ndrequr këtë gjëmë?*

— *Le të mos luajmë, ju lutem, me vendimet që duhen marrë. Unë nuk këmbëngul t'u rikthehem gjynaheve të Evropës, nëse ka gjynahe, por*

si të pretendohet se kthimi i kosovarëve në vatrat e veta, rikthim të cilin e dëshirojnë me gjithë zemër, dhe ju dhe unë, të mund të kryhet me çiltëri të plotë, duke harruar krimet? Për këtë çështje unë jam i vendosur, i bindur dhe ju kam vënë në dijeni këtu e shumë kohë më parë. Nuk kam ndërruar bindje: Kosova duhet marrë në mbrojtje, derisa t'i vijë koha një zgjidhjeje të vërtetë.

— *Domethënë autonominë?*

— Po të pranoni ju, po e trajtojmë problemin nga një tjetër anë. Si ta përfytyrosh që një popull i masakruar nga një tjetër, ta pranojë që ky i fundit ka të drejtë ta qeverisë? Në emër të kujt, administrata serbe mund të gëzojë të drejtën e privilegjeve në Kosovë? Në emër të spastrimit etnik? Nuk mund të kthehem pas...

— *As në autonominë e dhënë nga Titoja?*

— Ja ku po ju them se ajo që vetëm e përkohshme dhe shpreh drojën se mos Perëndimi është gati të bjerë në ndonjë ujdi të ndyrë me vrasësit serbë duke nxjerrë si shkak arsye të turbullta. Morali duhet të ngadhënjë. Ai është shpërdorur rëndshëm nga Serbia dhe asnjë traktat nuk do ta zhbëjë terrorin e ushtruar ndaj kosovarëve.

— *Ju i kundërviheni mbrojtjes së një pranie serbe në Kosovë?*

— Kundërvënie është fjalë e zbehtë. Nuk e pranoj. Kjo prani është e bazuar vetëm në një gënjeshtër historike dhe në një padrejtësi. Nëpër shekuj, Kosova varej nga Shqipëria. Vënia e Kosovës nën varësinë e Serbisë është pasojë e Luftës së Parë Botërore. Diplomatat me përjashtim të amerikanëve, e përgatitën dhe e ratifikuan për të shpague vrasjen e Dukës Ferdinand të Serbisë. Një nostalgji idiote ndaj terroristëve serbë, vrasës të një plaku, çoi në sakrifikimin e një populli. Në një farë mënyre, evropianët deshën të heqin nga vetja ndjenjën e fajësisë duke i rënë me sëpatë një populli...

— *Ju nuk shihni mundësi bashkëjetese si në Bosnjë, bie fjala?*

— Dëshira ime e vetme është që kosovarët të rikthehen në trojet e tyre dhe të gëzojnë lirinë, atë liri që ua kanë mohuar aq gjatë. Masakrat nuk janë ndonjë gjë e re. Ato kanë marrë një shtrirje të pashoqe. Unë nuk shoh se si mund të jetë e mundshme ndonjë bashkëjetese, në mos është si të vesh ujkun të ruajë kopenë.

Ç'domethënie do të kishte një administrim

serb në Kosovë? Falje, shlyerje mëkatesh për vrasarët? As që bëhet fjalë. Çdo pajtim kërkon tanimë dekada të tëra pendesash..

— *Autonomia a pavarësia do të përbënin mësimin tjetër të kësaj shtate...*

— Unë nuk do të këmbëngul t'ju përgjigjem drejtpërdrejt, jo se nuk kam argumenta, por sepse ekziston një kusht paraprak të cilit pak njerëz i kushtojnë vëmendjen që i takon: shumica dërrmuese e popullsisë kosovare është shqiptare. Po të mos qe kështu, shqiptarët e Kosovës nuk do të kishin të drejtë të kërkonin autonominë, pavarësinë, madje bashkimin e tyre. Kjo është një nga të dhënat e problemit: shqiptarët janë shumica në Kosovë dhe ata jetojnë në trojet e tyre tradicionale. Nuk teprohet aspak po të theksohet kjo gjë.

— *A nuk doni të këmbëngulni pikërisht në atë që spastrimi etnik sa vjen e bëhet, pra, më tmerrues?*

— Jo krejtësisht... Fjalën e kam sidomos në një aspekt të veçantë të kësaj shtate që çoi te spastrimi etnik. Nëse serbët do të kishin qenë më të shumtë, epo mirë! Në të vërtetë, nuk ma thotë mendja se do të kishte patur ndonjë krizë të

çfarëdoshme të Kosovës në emër të Historisë. Përparësia nuk është arsye e mjaftueshme për të shpërthyer një dramë aq shkatërrimtare.

— *Ju nuk i dhatë plotësisht përgjigje pyetjes sime: çfarë zgjidhje përfytyroni ju për kosovarët?*

— Nuk e di nëse jeni ju i hutuar a nëse unë shpjegohem keq... Në një mënyrë a në një tjetër, kosovarët duhet të mund ta zgjedhin fatin e tyre. Cili do të jetë ai? Askush nuk u ngrit kundër ribashkimit të Gjermanisë, as edhe Rusia Sovjetike. Ndërsa, në këtë rast, është fjala për krijimin a rikrijimin e një shteti katër a pesë milionësh në zemër të Evropës.

— *Ju e përfytyroni bashkimin e Kosovës me Shqipërinë?*

— Më vonë, përse jo? Mos ju tmerron gjë kjo? Përse ju shkakton ngurrim kjo zgjidhje?

— *Ismail Kadare, mos u bishtnoni përgjigjeve, ju lutem... vazhdoni.*

— ~~Atëherë, ribashkimi nuk është në rend të ditës, por në rend të së ardhmes. Në rendin e “të nesërmeve që këndojnë”, ndoshta, domethënë në një epokë të re, plotësisht të çdramatizuar. Është~~

pikërisht një mundësi e besueshme që do t'ua përkiste vetëm gjashtë milion banorëve. Sipas meje, kjo do të qe veç drejtësi... U përket kosovarëve, të vendosin për të, apo jo? Vetvendosja është një parim të cilit Franca goliiste i nënshtrorëj. E drejta e popujve për të qenë zot të vetes është e gdhundur në kulturën tonë...

— *Kjo duket qartas, por ama, do të thotë që serbët janë të sunduar nga Millosheviçi.*

— Të sunduar, ndoshta... Hë për hë, ata janë sidomos bashkëfajtorë me të.

— *Kjo njësi e popullit shqiptar figuron në programin e UÇK-së me ideologjinë e së cilës ju nuk pajtoheni...*

— Nuk po lihet gjë pa thënë për UÇK-në: asaj i vishen ide marksiste-leniniste, idetë e maoistëve të vonuar. Nga ana tjetër, e në mënyrë kontraktore, pretendohet që lëvizja udhëhiqet nga islamistët, sikur feja të mund të shkonte shumë me ateizmin e shpallur. Sigurohet se ajo strehon veç terroristë, ngandonjëherë dhe fashistë të vjetër. Në të vërtetë, bëhet çmos me të gjitha mënyrat për ta hequr qafe dhe propaganda serbe nuk është pa gjë. Për mua, si për shumë shqiptarë, UÇK-ja është një lëvizje për çlirim kombëtar. Ajo mbledh

ushtarë në të gjitha mjediset, në të gjitha vendet ku ekzistojnë fije të diasporës shqiptare, në Evropë, Shtetet e Bashkuara, etj. Ç'të kërkosh më shumë, në mos një mbështetje aktive dhe materiale nga demokracitë perëndimore? Ka pak më shumë se gjashtëdhjetë vjet që opinioni publik kërkonte avionë për Spanjën republikane. Unë nuk dua të krijoj paralelizma të rreme, por UÇK-ja duhet armatosur. Duhet që kosovarët të jenë në gjendje që të vetëmbrohen...

Ma do mendja se pozicioni im nuk ju çudit.

— *Jo përnjëmend. Po qe se do duhej të çuditështa, kjo, mbase, më së shumti, nga mbështetja juaj për UÇK-në.*

— Epo mirë! Do t'ju tregoj një ndodhi të panjohur nga bisedimet e Parisit, nga negociatat e fundit që u zhvilluan për t'i dhënë fund persekutimit të kosovarëve. Në zhargonin gazetaresk, kjo quhet skup. Delegacioni i UÇK-së gjendej në dilemë. A duhej nënshkruar apo jo një marrëveshje që mund të kërcënonte një pavarësi të ardhshme të Kosovës, e cila figuron në programin e tyre dhe për të cilën po luftojnë partizanët e UÇK-së...

— *Kjo marrëveshje, Ismail Kadare, u nënshkrua...*

— Në fakt, po, në çastin e fundit, ditën e fundit, pak para orës së caktuar nga fati: mesnatës. Prandaj, gjithë diaspora shqiptare ishte e pagjumë, sikur pagjumësia të kishte qenë ngjitëse... Për UÇK-në, alternativa ishte serioze, e rëndë. Delegatët e saj parizianë ishin objekt i presioneve të ndryshme. Nga njëra anë NATO dhe Shtetet e Bashkuara, domethënë, në këtë rast Havier Solana dhe Madlain Ollbright i mëshonin me sa mundnin për të arritur një përfundim; nga ana tjetër, udhëheqësit e UÇK-së në terren druanin se mos pranohej një marrëveshje që t'i kundërvihej ndonjë aspekti thelbësor të kërkesës së tyre.

— *Cili qe pozicioni juaj?*

— Do t'jua them. Atë natë të famshme, thuajse në mesnatë prita në shtëpinë time kryetarin e delegacionit të UÇK-së. Ai dëshironte të më parashtronte të dhënat e problemit. Ne diskutuam dhe unë e nxita dukshëm ta nënshkruante marrëveshjen e paraqitur.

— *Ju e bindët UÇK-në që të nënshkruante? Cilat qenë argumentet tuaja?*

— Pa hyrë në imtësi, unë isha i mendimit që kjo ishte mënyra më e mirë për të nxjerrë në pah mosbesimin serb. Në rast dështimi të bisedimeve,

fajet nuk do të ndaheshin midis viktimave dhe xhelatëve të tyre. Duke vepruar siç vepruan përfaqësuesit e UÇK-së, i zunë në beft serbët që shpresonin të rrëmuja, mosmarrëveshjet. Për pasojë, e këshillova kryetarin e UÇK-së që të firmoste. Firma e tij nuk do ta vinte në rrezik të ardhmen e Kosovës dhe unë mora zotim ta mbështetja hapur në publik.

Po ju rrëfej që fakti i marrjes së mendimit të një shkrimtari "në çastin e fundit", pas gjithë gjeneralëve, ministrave me tituj mbresëlënës, përfaqësues institucionesh të mëdha, për të mbështetur mendimin e vet, më shtyti të marr vendimin për t'i besuar, për të pasur besim në lëvizjen që ai përfaqësonte. Ai do të donte të merrte mendimin tim për këtë çështje, çështje tejet delikate. Te kjo gjë pikasa një shenjë qytetërimi.

— *Mirësjelljeje?*

— Mos luani me fjalët. Nuk është koha. E thashë qartë: qytetërimi.

— *Po për pozicionimin e rusëve, çfarë mendimi keni?*

— Për kërkimin e një zgjidhjeje kryekëput diplomatike nga ana e tyre? Dëgjo! Unë nuk e dalloj dhe aq mirë se si mund ta ndajnë ata pjesën

ushtarake nga elementi i kulluar politik. Klauzeviçi, po qe se nuk e teproj, i përket sferës së tyre kulturore. Atëherë, vetvetiu, për ta, a nuk do të jetë më lufta vazhdimi i politikës me mënyra të tjera? Lufta nuk është darkë ceremoniale. Ajo ka dobinë e vet në një mekanizëm kompleks. Kjo është e gjitha... Marksistët a marksistët e moçëm e kuptojnë nevojën e vendosjes së një raporti forcash në favor të të dobtëve, në rastin konkret... Le pastaj, që Rusia luan në Kosovë rolin e saj si fuqi kontinentale, por ajo e luan këtë rol në një atmosferë tragji-komike. Këtu e kam fjalën për shkatërrimin e pushtetit shtetëror, të Jelcinit, Kremlinit, të intrigave tejet të alkoolizuara...

— *Ju po e lini pas dore shoqërinë civile ruse...*

— Më falni, si thatë? Shoqëria civile ruse? Është e vërtetë se, si shumica e vëzhguesve të saj, edhe unë e humbas disi. Por ta themi mes nesh, ç'mund të flitet për të? Mbretëron rrëmuja. Komunistët janë antisemistë, domethënë, ata kanë harruar që doktrina e tyre ka qenë e themeluar nga Marksi. Ata janë bërë shovinistë supremë, ndërkohë që nuk kanë qenë kurrë të këtillë ata që predikonin internacionalizmin. Ata janë gati të bashkohen me fashistë të tipit Zhirinovski. “Demokratët” përhumbën nëpër mjegullnaja dhe askush nuk e dënon politikën e zbatuar nga

Milloseviçi, të cilit gjithsesi i gjenden rrethana lehtësuese. Askush...

— *As inteligjencia?*

— Ja një tjetër mësim, përfundimi i të cilit nuk më befason. Inteligjencia ruse, me Solzhenicinin në krye, ka dënuar krimet staliniane kur ata cënonin rusët, fshatarësinë ruse. Kur këto krime kishin të bënin me popuj të tjerë, mund të thuhej se këta njerëz i mbyllnin sytë. Rusia trashëgimtare e Bashkimit Sovjetik, nuk ka shprehur asnjë pendesë karshi këtyre popujve të tjerë.

— *Në më të shumtën e herës, viktimat janë rehabilituar...*

— Ju keni pjesërisht të drejtë. Vë re që fajtorët nuk janë gjykuar, prandaj as dhe dënuar. A e njihni masakrën e Katinit, që Stalini ua veshi nazistëve? Në fund të regjimit komunist, Gorbaçovi e pranoi. Ky pranim nuk solli asnjë përndjekje. Askush nuk u thirr në interpelancë, as iu ra më qafë kurrkujt, njësoj sikur kjo kasaphanë oficerësh polakë të hynte në rendin e zakonshëm të gjërave.

— *Krejtësisht, falë Gorbaçovit u mundësua...*

— ... hapja e hetimit? Sigurisht. Mirëpo kjo

çështje e Katinit ka diçka simptomatike. Ajo ngjason me një hakmarrje të ndyrë fshatarësh, kokëgdhenjsh, me Stalinin në krye, ndaj elitës polake. Nuk bëhet fjalë vetëm për qërim hesapesh politiko-ushtarake. Kjo gjë shkon madje më tej se një vrasje shoqërore, klasë kundër klasës, çka merr ngjyresë gati mitologjike, thelbësore për gjininë njerëzore... Por shkojmë më tej: qysh prej Alfred Jarry-t dhe Xha Ubusë, gjithkush e di që Polonia është vendi i “askund”-it.

— *Ju sugjeroni që inteligjencia ruse nuk ka protestuar kundër kësaj kërdie sepse ajo njehësoi, diku, “rusërinë” me fshatarësinë dhe polakët si fisnikë?*

— E si ta shpjegosh, atëherë, “heshtjen” e intelektualëve disidentë kur janë kryer krime ndaj “të tjerëve”, jo-rusëve, jo-vegjëlisë, etj? Ata nuk ndalen te internimi i popujve nga Stalini, as te lufta e bolshevikëve të Leninit në Kaukaz. Dhe, siç jua përmenda tashmë, ata as që bëjnë më kujdes për të fshehur antisemitizmin e tyre. Ata nuk preken prej asaj që u ngjet të tjerëve. Atyre as që u bëhet vonë fare.

— *Nga kjo pikëpamje, ata nuk qenkan shkëputur nga tradita e tyre populiste?*

— Pak a shumë kështu është... A e dini ju cili është romani i fundit i Tolstoit?

— *Sigurisht, jo.*

— Ai titullohet *Haxhi Murat*. Është i vetmi që nuk u botua sa që gjallë autori. U ndalua në kohën e carizmit, komunizmit, pas-komunizmit dhe ka mbetur sot e kësaj dite, i zhytur në mugëtirë. Përse? Sepse bën fjalë për konfliktin midis Rusisë dhe çeçenëve. Në plan të parë, shkrimtari i madh dëshironte të ngushëllonte ndërgjegjen e vet “për krimet e ardhshme”. Ai e parandjente se çështja çeçene do të zvarritej shumë. Si rrjedhim, ai mbajti një pozicion moral, jo të drejtpërdrejtë, dhe kishte arsye, por nëpërmjet artit. Kësisoj, morali ka gjetur një themel që e përjetëson dhe e rrit. Përfundimi? Ai ua kalon kështu të gjithë intelektualëve rusë të sotshëm, disidentë ose jo. Kjo është me sa duket arsyeja për të cilën ky roman ngjall njëfarë frike në Rusi, në çastin kur po bisedojmë. Në rastin më të mirë, ai nxit turpërimin e ndërgjegjeve fatkeqe.

— *Mos vallë, qëndrueshmëria e sjelljes rusomadhe nuk ka se si t’ua ngrohë zemrën?* —

— Për Kosovën, çështja nuk mund të shtrohet me këto fjalë. Pozicioni rus paraqet një pengesë tradicionale, ciladoqoftë dëshira e Moskës për të

ndrequr një konflikt me qëllim që të ruajë epërsinë e saj në rajon. Me thënë të vërtetën, ia kam frikën një fundi shekspirian...

— Çfarë doni të thoni?

— Të gjitha tragjeditë e mëdha të Shekspirit përfundojnë me luftra, me pushtime të huaja.

— Ju shpresoni në një ndërhyrje ushtarake tokësore?

— Unë nuk e var shpresën time tek lufta. Për fat të mirë, unë ushqej të tjera shpresa, por uroj me gjithë qenien time kthimin e kosovarëve të përzënë. Nuk është me dobi t'i hapësh punë vetes: pesimizmi është bërë parimi im i njëmendët. Unë e mendoj luftën të pashmangshme për të përfutur një zgjidhje "njerëzore". Dhe kjo zgjidhje, u pëlqen apo jo shumë mendjeve çiltërisht engjëllore, do të pranojë ndarjen e gjatë mes shqiptarëve dhe serbëve. Unë nuk do të doja aspak ta përsërisja shpesh e më shpesh, por harresa e dhunimeve e fyerjeve, e përndjekjeve të çdo lloji, nuk figuron ende në kalendar.

— Ju kërkoni ndjekje penale ndaj Millosheviçit?

— Ta pret mendja! Ndaj tij dhe bandës së vet. Ai e ka hak nxjerrjen para gjyqit të Historisë. Ballkani ka nevojë për një Nyremberg të ri. Në këtë rast, kompromiset me Millosheviçin do të ishin kompromentime me një sindikatë krimi. Do të qe e udhës që popujt e vegjël, ata që kanë qenë të poshtëruar për shekuj me radhë, ata që do të vuanin për pasojë nga një kompleks inferioriteti, të heqin dorë nga ideja e shpagimit, për t'u shëruar kështu nga ky kompleks e për të mos hedhur shtat në sajë të krimit. Sa më sipër, serbët përbëjnë një shembull mjeran. Ky regjim është një murtajë, murtajë që duhet hequr qafe me çdo kusht. Hë për hë, murtaja po hedh rrënjë në rrethinat e Evropës, por ajo mund t'i molepsë asaj edhe zemrën, po nuk u tregua kujdes. Millosheviçi nuk është aq i izoluar sa ç'e pandehim. Ai ka idhtarë disi gjithandej, dhe shtëpisë Evropë po i kanoset vdekja që mban maskë të kuqe.

— A mos e keni gjë fjalën për rrëfenjën e Edgar Allen Poe-së?

— Po, si edhe për Rrokullima e shtëpisë Usher...

Përktheu:
Luan Canaj